

Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim

Çështje Europiane dhe të sigurisë - 23

ÇËSHËTJE EUROPIANE DHE TË SIGURISË

EUROPEAN AND SECURITY AFFAIRS

Revistë katërmujore mbi sigurinë

Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim

Bordi shkencor:

Prof. dr. Rexhep Meidani (kryetar)

Prof. asoc. dr. Kristaq Xharo (anëtar)

Prof. asoc. dr. Arshi Çela (anëtar)

Dr. Eranda Gjomema (anëtare)

Elona Dhëmbo, kandidate për Dr. (anëtare)

Redaktor përgjegjës:

Elira Hroni - MA

Ndihmuan në përgatitje:

Egest Gjokutaj

Romina Banka

Besjana Kuçi

Erla Gjinishi

Ky numër reviste botohet me mbështetjen financiare
të **Divizionit të Diplomacisë Publike të NATO-s**
dhe **Fondacioni Shoqëria e Hapur OSI Think tank Fund**

PËRMBAJTJA

Tamara Radovanovik

Nga “ballkanizmi” në “europianizimin” e shteteve të Ballkanit Perëndimor	9
---	---

Jacques Rupnik

Ballkani si çështje europiane	25
-------------------------------------	----

Agon Demjaha, PhD

Roli i Integritimit Euroatlantik në lidhje me të ardhmen e marrëdhënieve mes Maqedonisë dhe Kosovës	44
--	----

Doktorante Elvana Çiçolli

Ndihma e ndërsjellë juridike, urdhri europian i arrestit	61
--	----

Gentjan Skara

BE, si nxitës i sigurisë dhe i paqes në periferi të saj: rasti i Ballkanit Perëndimor	73
--	----

Tatjana Slijepèeviaë

Perspektiva e re për Ballkanin Perëndimor brenda Strategjisë së Rajonit të Danubit	85
---	----

Blerjana Bino, kandidat për PhD

Siguria njerëzore, e drejta për të komunikuar dhe privatësia në kontekstin e informacionit dhe të një shoqërie që udhëhiqet nga dija	99
--	----

Abstracts	115
------------------------	-----

PARATHËNIA

Në përpjekje për të kontribuar në informimin e publikut mbi çështjet kryesore të politikave mbi reformat dhe funksionimin e sektorit të sigurisë në përgjithësi, trendet europiane dhe globale të sigurisë, debatin aktual dhe të ardhshëm mbi fushat prioritare të NATO-s, sfidat e Shqipërisë për reformimin e institucioneve dhe qeverisjes në sektorin e sigurisë, çështjet debatuese dhe partneritetet e NATO-s me BE-në dhe organizatat e tjera botërore. Ky numër i revistës për “Çështjet europiane dhe të sigurisë”, vjen më një tematikë të veçantë mbi: *Perspektivat e reformave në sektorin e sigurisë në Shqipëri: reforma dhe sfida të strukturave rregullatore, ligjore dhe kushtetuese.*

Kjo fushë studimi, duke u përqendruar te sfidat dhe problemet e reformave ligjore në sektorin e sigurisë në vend, sjell njëkohësisht një panoramë më të gjerë të perspektivës europiane në qeverisjen e sektorit të sigurisë apo të aktorëve të tjerë që kanë një ndikim domethënës mbi këtë sektor.

Tamara Radovanovik¹

NGA “BALLKANIZMI” NË “EUROPIANIZIMIN” E SHTETEVE TË BALLKANIT PERËNDIMOR

Abstrakt

Prej viteve '90 e në vazhdim, rajoni ka kaluar përmes një sërë procesesh transformuese të rëndësishme, nga paradigma e “ballkanizimit” drejt asaj të “europeanizimit”. Ky shkrim do të përqendrohet në proceset kryesore, duke u përpjekur të bëj dallimet në mënyrë analitike midis tyre. Megjithëse pranohet se transformimet ndonjëherë kanë ndodhur paralelisht dhe nuk është e qartë se kur përfundon një proces dhe kur fillon tjetri, për arsye analitike unë do të propozoj tri faza kryesore të dallueshme për të analizuar Ballkanin Perëndimor: ajo e kombit dhe e ndërtimit të shtetit (ballkanizmi i fundit), tranzicioni (i vonë) dhe procesi i paraeuropeanizimit, duke i konceptuar transformimet e shumta dhe komplekse në rajon si faza të shumëfishta. Ajo ç’ka argumentohet në këtë shkrim është se Ballkani Perëndimor mund të europeanizohet. Problemet me europeanizimin e Ballkanit Perëndimor nuk lidhen vetëm me pajtimin formal me kërkesat e BE-së. Sfidat e tyre më të madhe do të jetë që të braktisin praktikatat e së kaluarës, në mënyrë që të europeanizohen. Suksesi i Ballkanit është i lidhur me integrimin e të gjitha shteteve të rajonit në strukturat e BE-së dhe NATO-s. Shpërbërja në të kaluarën duhet të zëvendësohet me integrimin në Europë, bazuar në vlerat dhe interesat e përbashkëta.

Fjalët kyçe: europeanizimi, Ballkani Perëndimor, integrimi, demokracia, reformat.

¹ MSC, asistente pedagoge e Universitetit Ndërkombëtar të Ballkanit, Shkup, Republika e Maqedonisë.

1. Hyrje

1.1. Ballkani sot - europianizimi dhe papajtueshmëria me ballkanizimin

Rajoni i Ballkanit përbën sot një pjesë të pandashme në hapësirën e “re” europiane. Megjithatë, përfshirja e tij në arkitekturën e re europiane ka rezultuar, veçanërisht, problematike, me pasoja negative për të gjithë hapësirën europiane dhe evoluimin e integritit europian. Në fakt, Ballkani, dhe më konkretisht ajo ç’ka BE-ja e quan “Ballkani Perëndimor”, ka mbetur rajoni më pak i integruar dhe më i paqëndrueshëm i kontinentit. Gjatë periudhës së Luftës së Ftohtë, Gadishulli i Ballkanit përbënte vijën ndarëse *par excellence*. Me rënien e regjimeve komuniste në Europën Lindore dhe më gjerë, në kuadër të euforisë së bashkimit që pasoi Traktatin e Mاستrihtit, dukej e mundshme perspektiva e një të ardhmeje të përbashkët të Ballkanit në një Europë demokratike dhe të lulëzuar². Megjithatë, gjendja anarkike që dominoi skenën politike shqiptare, dhe veçanërisht shpërbërja e dhunshme e Jugosllavisë, tregoi se tranzicioni dhe integrimi do të ishin më shumë të kushtueshëm dhe do të kërkonin më shumë angazhim në pjesën e Europës Juglindore. Nuk ka dyshim që dy dekadat e kaluara kanë qenë jashtëzakonisht të vështira për vendet e Ballkanit. Armiqësitë e vazhdueshme rrënjosën ndjenjën e indinjatës dhe çuan në shfaqjen e një mozaiku të polarizuar kombe-shtete. Në shumicën e vendeve, lufta, mungesa e konsensusit për reformat, përvoja e kufizuar demokratike dhe institucionet e dobëta penguan progresin politik-ekonomik; programi i reformave të vonuara dhe të pazbatuara i zhvendosën vendet nga rruga e ekonomisë së tregut, plotësisht funksionale, drejt shfaqjes së ulët ekonomike, standardet e jetesës në rënie, rritjen e papunësisë dhe rritjen e varfërisë. Në këtë shkrim, argumentohet se Ballkani mund të europianizohet. Europianizimi analizohet si një proces me qendër BE-në, që varet drejtpërdrejt nga mekanizmat specifikë dhe kushtet e kufizuara të ndërhyrjes.

Në kontekstin e këtyre vendeve, p.sh. të vendeve kandidate në tranzicion që aspirojnë të anëtarësohen, europianizimi mund të kuptohet si korniza konceptuale që lidh integrimin dhe tranzicionin³. Kështu, ajo merr një kuptim më specifik, si

² Demetropoulou Leeda, *Europe and the Balkans: Membership Aspiration, EU Involvement and Europeanization Capacity in South Eastern Europe, Southeast European Politics*, vëll. III, nr. 2-3, nëntor 2002.

³ Agh, Attila, 1998, *The Politics of Central Europe*, Sage.

një proces i transformimit sistematik dhe akomodimit strukturor bazuar në një grup kërkesash të veçanta për anëtarësimin e plotë në BE. Shtetet që nuk qeverisen duke u bazuar në ligje dhe në demokracitë liberale të orientuara drejt tregut, nuk mund t'u akordohet anëtarësimi i plotë. Në këtë mënyrë, BE-ja funksionon si një model referimi për modernizimin e sistemeve politike, ekonomike dhe sociale të vendeve kandidatë në tranzicion që aspirojnë të anëtarësohen dhe europeanizimi kthehet në një seri operacionesh që çon në konvergencë sistematike përmes proceseve të demokratizimit, ekonomisë së tregut, stabilitetit dhe përfshirjes institucionale. Duke mos injoruar faktin se një sërë ndryshimesh të ndryshme ndikojnë në rezultatin e europeanizimit, dy prej tyre konsiderohen si të rëndësishme, veçanërisht në rastin e Ballkanit:

a) mekanizmat e europeanizimit, dhe b) kushtet kufizuese brenda rajonit dhe brenda secilit shtet të Ballkanit.

Mekanizmat e europeanizimit: ekziston një supozim themelor mes qasjeve të europeanizimit se mekanizmat e ndryshëm kanë një ndikim të ndryshëm mbi fusha të ndryshme të shtetit në fjalë (procedurat e politikëbërjes, identitetet, institucionet, strukturat etj.) që çojnë në përshtatje të ndryshme (ose mospërshtatje). Duke iu referuar vendeve kandidatë aspirante postkomuniste, këta mekanizma të europeanizimit mund të dallohen duke huazuar terminologjinë⁴ e teorive të demokracisë dhe duke kombinuar me tipologjitë e qasjes së europeanizimit⁵. Që nga rënia e komunizmit në vitet '90, Ballkani Perëndimor ka pësuar transformime themelore dhe të shumta, që janë komplekse për nga natyra e tyre dhe jo të thjeshta për t'u shpjeguar nga një paradigmë ose model i vetëm. Një transformim i tillë kompleks, ku demokratizimi dhe tranzicioni zhvillohen njëherazi me kombin dhe ndërtimin e shtetit dhe integrimin europian, zakonisht shoqërohet me një pamje të prerë të rajonit. Fokusi është zhvendosur drejt integritit të Ballkanit Perëndimor në BE, duke vënë në punë literaturën që lidhet me zgjerimin.

⁴ Schmitter, Philippe, 1996, "The influence of the international context upon the choice of national institutions and policies in neo-democracies" in *The International Dimensions of Democratization-Europe and the Americas*, ed. Whitehead Laurence (Oxford: Oxford University Press).

⁵ Radaelli, Claudio, 10-13 April 2000, "Whither Europeanisation? Concept stretching and substantive change", *Political Studies Association Annual Conference*, London.

2. Ballkanizmi i fundit

Pas rënies së komunizmit, të gjitha vendeve të Europës Lindore iu duhej t'i nënshtroheshin një transformimi të dyfishtë, ku sfidat më të rëndësishme për t'u përballur ishin transformimi ekonomik dhe demokratizimi politik i saj. Përveç këtyre transformimeve, problematika të tjera i dhanë rëndësi situatës në Ballkanin Perëndimor. Në atë periudhë, shqetësimi kryesor i rajonit lidhej kryesisht me “ndërtimin e shtetit”, në kuptimin e drejtpërdrejtë të fjalës, megjithëse me profile të ndryshme të rasteve të veçanta, duke filluar nga një shtet i dobët me një shtetndërtim të papërfunduar në Shqipëri - në ndërtimin e shtetit dhe kombit në Jugosllavi⁶. Në rendin e ditës të politikanëve të Ballkanit Perëndimor, iu kushtua më pak rëndësi vlerave demokratike dhe reformave ekonomike, përderisa e gjithë vëmendja u përqendrua në procesin e ndërtimit të kombit dhe shtetit. Risjellja në vëmendje e çështjes së kombit-shtet do të rezultojë në trazira për të gjithë rajonin, ku shpërbërja e shteteve të Ballkanit Perëndimor përbën problemin më akut për t'u përballur.

Gjatë dekadës së parë, shpërbërja e Jugosllavisë u shoqërua me konflikte të dhunshme duke shkaktuar shumë viktima njerëzore, trauma dhe zhvendosjen e civilëve, për të mos përmendur këtu shpenzimet e mëdha ekonomike që i solli rajonit. Procesi i shpërbërjes në ish-Jugosllavi nuk lidhet vetëm me periudhën e menjëhershme pas rënies së komunizmit.

Kjo ishte një çështje e papërfunduar, gjë që u tregua kohët e fundit nga Shpallja e Pavarësisë së Malit të Zi dhe Kosovës. Përveç shpërbërjes së Jugosllavisë, shteti shqiptar kaloi kohë të vështira trazirash. Në pranverën e vitit 1997, shteti shqiptar ishte në kolaps, “duke përfaqësuar rastin klasik të dështimit të shtetit ku strukturat që duhet të garantonin shtetin ligjor, dështuan plotësisht”⁷.

Këto zhvillime në rajon shpesh referohen si procesi i ballkanizimit me qëllim për të përshkruar situatën e shteteve të Ballkanit Perëndimor në vitet '90 që iu nënshtuan procesit të tyre të fundit të shpërbërjes - ndarja e Jugosllavisë dhe dështimi i shtetit në Shqipëri.

⁶ Balkan Forum, 17-18 June, 2004, *Rethinking the Balkans: Incongruities of State and Nation Building, Regional Stabilisation and European Integration*, Discussion paper final version, p. 3, Bertelsmann Foundation and Center for Applied Policy Research, Berlin.

⁷ Centre for Policy Studies, 2003, *In Search of Responsive Government, State Building and Economic Growth in the Balkans*, p. 36, Centre for Policy Studies, CEU (Central European University), Budapest.

Në vija të përgjithshme, shpërbërja e dhunshme e Jugosllavisë u cilësua si produkt i natyrës jodemokratike e sistemit të vjetër politik dhe, në veçanti, si pjesë e një strategjie të zgjuar të hartuar nga elitat ish-komuniste të interesuara për të ruajtur pushtetin e tyre⁸. Periudha anarkike shqiptare e vitit 1997 dhe, thuajse destabilizimi në vitin 1998, ishin gjithashtu rezultat i kulturës politike konfliktuale, e demonstruar nga palët të cilat treguan se ishin të “infektuara” njësoj si paraardhësit e tyre komunistë që i konsideronin armiq kundërshtarët politikë. Këto argumente zakonisht nxjerrin në pah se kjo trashëgimi pengoi demokratizimin e plotë dhe zhvillimet e mëtejshme.

3. Tranzicioni i vonë

Tranzicioni, në kuptimin e përgjithshëm të fjalës, nënkupton “intervalin midis shpërbërjes së regjimit të vjetër dhe vendosjes së një regjimi të ri”⁹. Në literaturën postkomuniste është konceptuar shpesh si transformimi drejt një demokracie pluraliste dhe ekonomisë së tregut. Këto transformime kërkuan, në radhë të parë, krijimin e institucioneve të reja për të garantuar ndarjen e shtetit nga kontrolli i partisë, si dhe kalimin në ekonominë e tregut, duke braktisur kështu planifikimin ekonomik shtetëror. Gjithashtu duheshin ndërmarrë reforma të tjera themelore dhe praktika të reja ligjore dhe administrative, në mënyrë që të linin pas trashëgiminë institucionale të komunizmit. Në Ballkanin Perëndimor, pasi shpërbërja kishte mbaruar (pothuajse) dhe sundimi autoritar po dobësohej gjithnjë e më shumë, procesi i tranzicionit (ndërtimi i një demokracie liberale dhe orientimi drejt ekonomisë së tregut), u rikthye sërish në qendër të vëmendjes, këtë herë si çështja kryesore e ditës. Megjithëse një shkallë e demokracisë dhe disa reforma ekonomike filluan që nga fillimi i viteve '90, mund të thuhet se Ballkani Perëndimor e përjetoi tranzicionin më vonë, të paktën në krahasim me disa prej vendeve të EQL-së.

3.1. Sfidat e reja dhe paaftësia e qeverisjes për menaxhimin e tyre

Procesi i tranzicionit, përveç rimëkëmbjes nga konfliktet dhe destabilitetit, solli edhe sfida të reja për rajonin. Në sferën politike,

⁸ I. Krastev, 2002, “The Balkans: Democracy Without Choices”, p. 43, Journal of Democracy, p. 13.

⁹ “Donnell & Schmitter 1986”, reference from P. Kopecky & C. Mudde, “What has Eastern Europe...”, *op.cit.*, 2000, p. 519.

sfida kryesore ka qenë vendosja e një demokracie liberale, duke qenë se shumica e vendeve të rajonit ishin “pjesërisht” demokratike¹⁰. Një sfidë e dytë e rëndësishme ka qenë krijimi i një identifikimi pozitiv me shtetin nga qytetarët. Në fushën sociale është vërejtur një kapacitet organizativ i dobët i aktorëve shoqërorë dhe një shoqëri civile e pazhvilluar. Një sfidë kryesore për ekonominë e Ballkanit Perëndimor që kanë arritur një nivel stabilizimi, ka qenë krijimi i kushteve solidë për “rritje ekonomike të vetëqëndrueshme”¹¹.

Krahas këtyre sfidave thelbësore në sferën politike, ekonomike dhe shoqërore, dalin në pah edhe probleme të tjera, ku më sfiduesit kanë qenë: korrupsioni dhe krimi i organizuar. Këto sfida të reja dhe paaftësia për adresimin e tyre tregojnë edhe njëherë dobësitë strukturore të shteteve të Ballkanit Perëndimor, të cilave iu mungojnë kapacitetet e duhura qeverisëse për të ndërmarrë reformat e nevojshme. Ata kanë treguar se janë shtete joefikasë, të paaftë për të përmbushur funksionet e tyre bazë dhe për të adresuar problemet e reja që lindin. Mungesa e institucioneve shtetërore, të cilat do të mund të çonin përpara reformat e tranzicionit të kombinuar njëkohësisht me sfidat e reja, ka qenë një nga çështjet kryesore të Ballkanit Perëndimor postkonfliktual.

Megjithatë, kapaciteti për ndërtim institucional është kufizuar për shkak të kufijve të vendosur nga tensionet e mëparshme si edhe për shkak të mungesës së vullnetit politik. Sërish, “edhe kur ka pasur vullnet politik, autoriteteve shpesh iu mungojnë kapacitetet financiare dhe administrative për të zbatuar reformat dhe politikat”¹² për përmirësimin e kushteve politike dhe ekonomike. Për sa iu përket aspekteve ekonomike të rajonit,

¹⁰ Për shembull, sipas anketës së *Freedom House* për vitin '97, Serbia dhe Mali i Zi (në atë kohë Jugosllavia) klasifikoheshin si vende “jo të lira”, deri në vitin 1999 (me përjashtim të periudhës '90-'91 dhe '91-'92, ku klasifikoheshin si “pjesërisht të lira”). Pas vitit 1999, këto vende u perceptuan si “pjesërisht të lira” deri në vitin 2000 dhe që nga viti 2002 e më tej ato u klasifikuan si “të lira”. Bosnjë Hercegovina gjithashtu u konsiderua si “jo e lirë” deri në vitin 1996 dhe më pas si “pjesërisht e lirë”. Kroacia konsiderohej si “pjesërisht e lirë” dhe vetëm në vitet 2000-2001, pas ndryshimeve politike, u vlerësua si “e lirë”. Maqedonia dhe Shqipëria u klasifikuan si “pjesërisht të lira” dhe ende mbeten në këtë status. Shqipëria, për shembull, ka dështuar disa herë për mbajtjen e zgjedhjeve të lira dhe kjo është reflektuar edhe në marrëdhëniet me BE-në, duke qenë se zgjedhjet e lira qenë një faktor kryesor për fillimin e negociatave dhe firmosjen e MSA-së.

¹¹ Gligorov, 1999, et. al., “Balkan Reconstruction...”, *op. cit.*, p. 18, see also: M. Uvalic, 2003, “Economic Transition in Southeast Europe”, p. 63, in *Southeast European and Black Sea Studies*, 3 (1).

¹² D. Bechev & S. Andreev, 2005, “Top-Down vs. Bottom-Up...”, *op. cit.*, p. 7.

pasojat e strategjive të tranzicionit kanë qenë në një nivel deindustrializimi, ku prodhueshmëria e ulët e sektorit të ri privat ka qenë e pamjaftueshme për të kompensuar rënien e sektorit shtetëror. Progresi “socio-ekonomik, sipas kriterëve të tregut, është e vetmja mundësi nëse duam një shtet efikas për përmbushjen e funksioneve të tij bazë”¹³.

4. “Paraeuropianizimi”

Pavarësisht turbullirave të dekadës së fundit dhe sfidave të reja të tranzicionit, me të cilat janë përballur vendet e Ballkani Perëndimor, duhen njohur edhe arritjet e tyre. “Sot shumica e problemeve dhe faktorëve që karakterizojnë Ballkanin duket se kanë përfunduar... dhe ajo që është më e rëndësishmja, vendet e Ballkanit Perëndimor kanë arritur zhvillime pozitive gjatë dy viteve të fundit.”¹⁴ Ndryshimet politike në Kroaci dhe më pas në Serbi ndryshuan rreziqet rajonale dhe e kthyen rajonin drejt integritimit evropian¹⁵. Zhvillimi ekonomik në Ballkanin Perëndimor ka qenë inkurajues dhe perspektiva është pozitive.

Ballkani Perëndimor mundet, kështu, të lërë pas epokën e “ballkanizmit” dhe të çojë përpara tranzicionin. Ajo që ka shumë rëndësi në këtë fazë është se tranzicioni drejt demokracive pluraliste dhe ekonomisë së tregut po ndodh paralelisht me perspektivën në zhvillim të integritimit në BE. Në vitin 2000, në Samitin e Këshillit Evropian në Feira, perspektiva e anëtarësimit në BE u zgjerua edhe drejt vendeve të Ballkanit Perëndimor, ku kryetarët e shteteve dhe qeverive të vendeve të BE-së konfirmuan perspektivën e vendeve të Ballkanit si kandidatë potencialë për anëtarësim në BE¹⁶. Objektivi për marrjen e statusit të anëtarësimit ka përshpejtuar progresin dhe ka dhënë shtysa

¹³ World Bank, 1997, “The State in a Changing World”, *The World Development Report*, Washington.

¹⁴ S. Panebianco & R. Rossi, October 2004, *EU Attempts to Export Norms of Good Governance to the Mediterranean and Western Balkan Countries*, p. 15-20; Jean Monnet, *Working Papers in Comparative and International Politics* (JMWP), n° 53, Jean Monnet Centre EuroMed - Department of Political Studies University of Catania, Catania.

¹⁵ WIIW - Vienna Institute for International Economic Studies, March 2006, *The Western Balkans: Economic Development since Thessaloniki 2003*, p. 1, Vienna.

¹⁶ “Objektivi i BE-së mbetet integritimi sa më i plotë i vendeve të rajonit në rrjedhat politike dhe ekonomike të Europës... Të gjithë vendet përkatëse janë kandidatë potencialë për anëtarësim në BE”, Council of the European Union, Presidency Conclusions, Santa Maria da Feira, 19 June, paragrafi 67.

të reja sidomos pas anëtarësimit të dhjetë vendeve nga Europa Lindore, çka bën që Ballkani Perëndimor (me gjithë Turqinë) të jenë pasuesit në radhën e pritjes. Për t'u pranuar, vendet aspirante duhet të përmbushin në mënyrë strikte kriteret politike dhe ekonomike të BE-së, si dhe kërkesat ligjore (të ashtuquajturat Kriteret e Kopenhagës)¹⁷. Një marrëdhënie e tillë (kushtëzueshmëria e BE-së - bashkëpunimi i Ballkanit Perëndimor) do të thotë se BE-ja ka ndikim mbi Ballkanin Perëndimor. Ky proces, në përgjithësi, ku integrimi europian ka ndikim mbi vendet aspirante për anëtarësim dhe është quajtur "europianizimi sipas stilit lindor".

Për Ballkanin Perëndimor, europianizim do të thotë përshtatje me modelet e avancuar perëndimore si dhe siguria dhe prosperiteti për të ardhmen¹⁸. Në fazën aktuale të Ballkanit Perëndimor, mund të flasim për një proces paraeuropianizimi, duke qenë se transformimet aktuale janë pasojë e përgatitjes për aderim. Europianizimi në këtë kontekst është, së pari, një proces ndërtimi i vendeve anëtare, ku shtetet e Ballkanit Perëndimor duhet të rigjallërojnë shumicën e legjislacionit të tyre, të përshtatin institucionet ekzistuese, ose të ndërtojnë të reja sipas legjislacionit, politikave dhe standardeve të BE-së. Si rrjedhojë e këtij procesi të ndërtimit të vendeve anëtare, shtetet e Ballkanit Perëndimor do të kalojnë nëpërmjet transformimesh thelbësore (më i drejtpërdrejtë prej të cilëve është struktura e administratës publike, përshtatja shoqërore dhe ekonomike me standardet e BE-së, ndryshimi në thelb dhe proceset e qeverisjes demokratike).

4.1. A mund të europianizohet Ballkani Perëndimor?

Pavarësisht të gjitha pasigurive dhe vështirësive, lidhur me të ardhmen e proceseve të integritimit në BE, ajo që është,

¹⁷ Kriteret e Kopenhagës kërkojnë që vendet kandidatë të kenë arritur "stabilitet të institucioneve që garantojnë demokracinë, shtetin e së drejtës, të drejtat e njeriut dhe respektin për minoritetet, ekzistencën e një ekonomie tregu funksionale, si dhe kapacitetin për t'u përballur me presionet konkurruese dhe forcat e tregut brenda BE-së, aftësinë për të marrë përsipër detyrimet që burojnë nga anëtarësimi, duke përfshirë përputhshmërinë me qëllimet e bashkimit politik, ekonomik dhe monetar. Shih: *The Copenhagen Criteria*, DG Enlargement - marrë nga <http://ec.europa.eu/enlargement/enlargement_process/accession_process/criteria/index_en.htm>.

¹⁸ O. Anastasakis, 2005, "The Europeanization of the Balkans", p. 80, *The Brown Journal of World Affairs*, XII (1).

ndoshta më e rëndësishmja për t'u parë këtu, lidhet me faktin se këto procese janë të pakthyeshme edhe në një vend si Serbia, ku ndryshimet politike, ka gjasa të ndikojnë vetëm në shpejtësinë dhe drejtimin e përgjithshëm¹⁹. Studimet e fundit kanë treguar se, “në fund të fundit, është Europa (me normat dhe vlerat e saj) e cila qëndron si një përcaktues i përbashkët rreth të cilit ka filluar të kristalizohet identiteti kolektiv i Ballkanit”. Kjo do të thotë se anëtarësimi në BE tashmë qëndron si vizioni i vetëm afatgjatë për Ballkanin Perëndimor. Aktualisht, logjika dhe hapi i integritimit europian kanë bërë përfshirjen e shteteve të Ballkanit Perëndimor një konkluzion të hershëm dhe një paevitueshmëri strategjike²⁰. Përtej kësaj panorame optimiste, ku “elitat dhe regjimet në rajon gjithnjë e më shumë ndajnë një orientim europian”²¹, duhen ndërmarrë masa konkrete prej elitave politike, duke qenë se përgjegjësia për përmbushjen e standardeve të BE-së dhe paraqitja e hapjes së procesit qëndron mbi shpatullat e tyre. Së fundmi, vullneti politik dhe këmbëngulja e udhëheqësve rajonalë përcakton suksesin ose dështimin e paketës evropiane, “e cila konsiston në një proces bilateral para anëtarësimit: bashkëpunim rajonal dhe menaxhim proaktiv të krizave”.

Ajo që argumentohet në këtë punim është se “Ballkani Perëndimor mund të europeanizohet”²², siç përfundon edhe studimi i Demetropoulousit. Kjo nuk do të thotë se nuk ka mbetur ende shumë për të bërë. Në të kundërt, problemet me europeanizimin e Ballkanit Perëndimor nuk zgjidhen vetëm nëpërmjet bashkëpunimit formal me kriteret e BE-së. Sfida e tyre më e madhe do të jetë braktisja e praktikave të së shkuarës për t'u bërë kësisoj të “europeanizuar në sjellje”.

Mekanizmat që përfshijnë ndryshimet e preeuropeanizimit

Retorika e vetme e orientimit europian nuk ka shumë rëndësi nëse nuk kthehet në veprime konkrete, që do të thotë: reforma politike dhe ekonomike. BE-ja, nga ana e saj, ka

¹⁹ M. Uvalic, 2003, “Economic Transition...”, *op. cit.*, p. 79, less emphasis.

²⁰ Balkan Forum, July 2002, *Integrating the Balkans: Regional Ownership and European Responsibilities Discussion paper*, p. 6, Bertelsmann Foundation and Center for Applied Policy Research and Policy Planning Staff, German Federal Ministry of Foreign Affairs, Berlin.

²¹ Balkan Forum, 2004, “Rethinking the Balkans...”, *op. cit.*, p. 5.

²² L. Demetropoulou, 2002, “Europe and the Balkans: Membership Aspiration, EU Involvement and Europeanization Capacity in South Eastern Europe”, p. 88, *Southeast European Politics*, III (2-3).

përdorur si “shpërblimin” edhe “nxitësit ndëshkues”, për të bërë që vendet që duan të anëtarësohen të bashkëpunojnë me kriteret për anëtarësim. Mekanizma të tillë të kushtëzueshmërisë negative ose pozitive kanë qenë mjeti më i rëndësishëm i BE-së për të përfshirë sfidat e paraeuropeanizimit në vendet candidate. Deri tani, BE-ja ushtron kushtëzueshmëri pozitive dhe negative mbi vendet e Ballkanit Perëndimor. Qasjet e mëparshme të BE-së janë karakterizuar nga një numër kushtëzueshmërisht negative. Përjashtimi është firmosja e MSA-së me Maqedoninë si një shpërblim për përfundimin e konfliktit. Anastasakis dhe Bechev-i, duke analizuar kushtëzueshmërinë e qasjes së BE-së kundrejt vendeve të Ballkanit Perëndimor, bëjnë thirrje për nevojën për të ecur “drejt një kushtëzueshmërie pozitive”²³. Një kushtëzueshmëri e tillë jo vetëm që do të kërkonte ofrimin e perspektivës së anëtarësimit të plotë për të gjithë rajonin, por gjithashtu edhe një plan më të detajuar se kur do të anëtarësohej secili nga vendet.

Marrëveshja e Stabilizim-Asocimit (MSA) është një hap i mëtejshëm dhe reflekton një ecje përpara drejt qasjes së BE-së. “Në të njëjtën kohë, aspektet ndëshkuese të kushtëzueshmërisë vazhdojnë të luajnë një rol të rëndësishëm dhe janë një pjesë e integruar e secilës - MSA”²⁴. Pra mund të sugjerohet se, në këtë pikë, një qasje e tillë “karotë dhe shkop” do të vazhdojë ende të jetë “strategjia më e mirë për ta sjellë Ballkanin Perëndimor aktualisht ose në të ardhmen e afërt, brenda BE-së, ose, së paku, më afër saj”.

Një çështje e argumentuar nuk është edhe aq kushtëzueshmëria, sesa se cili tip dhe sa të suksesshme do të jenë nxitës të tillë për europeanizimin e vendeve të Ballkanit Perëndimor. Anastasakis dhe Bechev-i theksojnë se zbatimi i kushtëzueshmërisë në rajon është problematik²⁵. BE-ja po gjendet në një pozicion ngërçi, duke qenë se në një anë ajo po vendos kushte të rënda mbi vendet e Ballkanit Perëndimor dhe, nga ana tjetër, ajo nuk mund të ofrojë më shumë për rajonin, duke qenë se ajo vetë po përballet me sfidat e konsolidimit.

²³ O. Anastasakis & D. Bechev, 2003, “EU Conditionality in South-East Europe: Bringing Commitment to the Process”, p. 3-4, *European Balkan Observer* 1 (2).

²⁴ Pippan, 2004, “The Rocky Road to Europe: The EU’s Stabilisation and Association Process for the Western Balkans and the Principle of Conditionality”, p. 235, *European Foreign Affairs Review*, 9 (2).

²⁵ O. Anastasakis & D. Bechev, 2003, “EU Conditionality...”, *op. cit.*, p. 3.

Megjithatë, siç theksojnë edhe studiuesit, kushtëzueshmëria e BE-së mund të jetë efikase vetëm për atë kohë sa perspektiva e anëtarësimit në BE konsiderohet si realiste²⁶. Kjo është nisma më e mirë për rajonin. Roli i BE-së për europianizimin e Ballkanit Perëndimor dhe akoma më shumë “karota e saj e anëtarësimit”, është kryesore për përshpejtimin e reformave, duke qenë se “Europa (BE) ka qenë si magnet dhe burim inspirimi për përpjekjet e tyre për ndërtimin e shteteve moderne dhe shoqërive moderne”²⁷. “Përforcimi me anë të shpërblimit” duket se është i vetmi model që do të europianizojë vendet e Ballkanit Perëndimor. Në të kundërt, ngrirja ose çdo shtyrje e zgjerimit të BE-së “do të shkurajonte vendet e Ballkanit Perëndimor, të cilët përdorin perspektivën e anëtarësimit si një motiv për reformat e dhimbshme”.

5. Përfundim: nevoja për zgjerim, paralelisht me europianizimin në një fazë të mëvonshme

Studiuesit që merren me Europën Juglindore janë angazhuar për të shpjeguar periudhën tranzitore në të cilën ka kaluar rajoni pas rënies së “perdes së hekurt”. Shumë paradigma dhe argumente janë hedhur për të na ndihmuar që të kuptojmë transformimet e shumta që po kalon rajoni. Një shqyrtim i kujdesshëm dhe marrja në konsideratë e literaturës tregon që argumentet dhe shpjegimet e shumta nuk janë gjë tjetër veçse pjesëza të një mozaiku kompleks që duhet të merret i gjithi parasysh që të jepet pamja e plotë dhe e vërtetë e rajonit, transformimet e shumta të saj, sfidat dhe shkaqet. Proceset në Ballkanin Perëndimor jo vetëm kanë zgjatur në kohë, por në shumicën e rasteve janë zhvilluar paralelisht me njëri-tjetrin. Megjithëse situata politike në Ballkanin Perëndimor nuk ka arritur ende në një ekuilibër të ri dhe vazhdon të jetë në një periudhë transformimesh, një gjë duket e sigurt: rajoni po e kapërcen paradigmen e vjetër dhe negative të ballkanizimit drejt një paradigme të re më pozitive të europianizimit.

Deri më sot, BE-ja ka promovuar një qasje që ka për qëllim që ta mbajë Ballkanin (veçanërisht Ballkanin Perëndimor) brenda Europës, por jashtë bërthamës institucionale të BE-së. Bashkëpunimi rajonal është promovuar si një alternativë që mund të krijojë kushtet e përgjithshme për demokracinë dhe ekonominë e tregut, të normalizojë marrëdhëniet, të sjellë stabilitet minimal

²⁶ J. Rupnik, 2000, “Eastern Europe...”, *op. cit.*, , p. 126.

²⁷ D. Bechev, 2006, “Constructing South East Europe...”, *op. cit.*, p. 23.

dhe të lehtësojë tregtinë, duke hapur kështu rrugën për zhvillimin ekonomik. Megjithatë, kriza e Kosovës dhe sukcesi i kufizuar i shtetit boshnjak tregoi kufizimet e kësaj qasjeje dhe bëri që BE-ja, në bashkëpunim me aktorë të tjerë europianë dhe ndërkombëtarë të fillonin të merrnin në konsideratë mundësinë e aderimit të Ballkanit dhe të shkonin drejt institucionalizimit të marrëdhënieve. Në këtë kontekst, dhe duke pasur parasysh praktikën aktuale të transformimit përpara aderimit që karakterizon zgjerimin me vendet e Europës Lindore, europianizimi i rajonit, sipas modelit normativ të BE-së, është kthyer automatikisht në një domosdoshmëri.

Nëpërmjet orientimit të BE-së dhe entuziazmit fillestar që i ka zënë vendin zhgënjimit dhe frustrimit, oferta e dyfishtë e institucionalizimit dhe anëtarësimit të mundshëm është kthyer në një nxitje të fortë që mund të mbajë vendet e Ballkanit Perëndimor në sferën e BE-së. Megjithatë, një sërë pyetjesh lindin në lidhje me kapacitetin e europianizimit të shteteve të Ballkani: karakteri demokratik dhe efektiviteti i promovimit të modelit specifik të europianizimit nga ana e BE-së.

a) *Kapaciteti për europianizim i Ballkanit.* Lidhur me kapacitetin e europianizimit të rajonit, vendet e Ballkanit Perëndimor kanë treguar se kur aspirata për anëtarësim bëhet thelbësore dhe retorika europiane përkthehet në veprim, atëherë mund të fillojë faza e akomodimit sistematik dhe strukturor. Megjithatë, duke pasur parasysh numrin e madh të kushteve kufizuese që ekzistojnë në këtë zonë, konvergjenca do të kërkojë një kohë të gjatë, durim dhe këmbëngulje në Ballkan dhe mbështetjen e vazhdueshme dhe të fortë nga ana e BE-së. Vendeve të Ballkanit do t'u duhet që jo vetëm të braktisin praktikën e kaluara, por edhe të sfidojnë interesat e shfrenuar në sektorë të rëndësishëm të ekonomisë, si dhe korrupsionin dhe kriminalitetin. Gjithashtu, shoqëritë e ndara nga urrejtja dhe lufta do të duhet të mësojnë të jetojnë së bashku, duke respektuar ligjin dhe të drejtat e të tjerëve. Nga ana e BE-së, pavarësisht nga madhësia e vogël e ekonomive të Ballkanit, shumica e fondeve të nevojshme do të jetë e konsiderueshme dhe problemi vërtetë do të jetë që BE-ja të jetë në gjendje për të siguruar burimet e nevojshme më afatgjata.

b) *Karakterit demokratik dhe efektiviteti i modeleve të importuara.* Nisur nga pritshmëritë e paplotësuara dhe mbështetjen në rënie, do të dukej jo fort demokratike nëse BE-ja do të impononte një model ekonomik dhe politik specifik.

Do të ishte më demokratike që të mundësohej mbështetja për aktorët përkatës për eliminimin e kushteve kufizuese me anë

të proceseve më të gjera që do të krijonin baza më të mëdha për konvergencë dhe pritje. Nuk është e mundur që të ndërtohet mbi baza të kalbura. Roli i BE-së duhet të jetë mbështetës dhe jo imponues. Brenda kontekstit të përkeqësimit të kushteve dhe destabilitetit të vazhdueshëm, efikasiteti i përfaqimit të modeleve të gatshme është i dyshimtë. Në çdo rast, për të rritur efikasitetin e saj, BE-ja duhet t'i kushtojë më shumë vëmendje mekanizmave të europianizimit. Lidhur me kalimin zinxhir, BE-ja duhet të rrisë efektet demonstrative duke garantuar prosperitetin e popullsisë së saj dhe karakterin e saj demokratik, që do të thotë se BE duhet të ecë përpara shpejt, me reformat e brendshme që i nevojiten. Lidhur me konsensusin, BE-ja duhet të gjenerojë më shumë kontakte me grupet e brendshme të Ballkanit, të lejojë pjesëmarrjen e tyre në një sërë programesh, komitetesh dhe mbledhjesh dhe, me pak fjalë, të krijojë rrjetet që do të lehtësonin mësimet dhe përshtatjet përkatëse. Për sa i përket kontrollit, BE-ja duhet të mbajë një prezencë ndërkombëtare të fortë dhe të krijojë mekanizmat dhe mjetet monitoruese që nevojiten (për shembull raporte të rregullta). Së fundmi, lidhur me kushtëzueshmërinë, BE-ja duhet të vendosë kushte realiste që mund të përmbushen, t'i lidhë këto me përfshirje të dukshme dhe të lejojë vendet që të procedojnë pa u bllokuar prej vonesave të të tjerëve.

c) *Izolimi i horizontit të anëtarësimit dhe periudha e ndërmjetme.* Për t'u larguar nga destabiliteti, nevojitet integrimi. Nëse Ballkani nuk integrohet sipas praktikave aktuale, atëherë ato duhen ndryshuar ose duhen vendosur praktika të reja të cilat lejojnë europianizimin pas anëtarësimit. Nevoja për zgjerim paralel është mjaft e madhe. Ndërkohë bashkëpunimi rajonal duhet të nxitet, por i bazuar te nevojat vendore dhe jo te dëshirat e jashtme dhe interesat ekonomike. Puna për projekte të përbashkëta - për shembull të lehtësojnë integrimin fizik në Europë (si rrugë, hekurudha) - mund t'i sjellë njerëzit më pranë. Megjithatë, bashkëpunimi rajonal duhet të mos ketë një karakter kundër hapësirës dhe kjo kërkon një institucionalizim substancial dhe një perspektivë të dukshme anëtarësimi.

d) *Ballkani në Europë.* Vaclav Havel, gjatë një fjalimi mbajtur në Parlamentin Europian, theksoi: "Ideja se dy Europa mund të ekzistojnë përgjithmonë: njëra demokratike, me stabilitet dhe me prosperitet si dhe e përfshirë në integrim, dhe një tjetër më pak demokratike, më pak qëndrueshme dhe me më pak prosperitet, është [...] plotësisht e gabuar. Ajo i përngjan besimit se gjysma e dhomës mund të ngrohet dhe gjysma tjetër të mbahet e

pangrohur, njëkohësisht. Ka vetëm një Europë, pavarësisht diversitetit dhe çdo panorame tjetër - kudo në këtë fushë do të sillte pasoja dhe probleme për të gjithë kontinentin”²⁸. Çerekshkulli, pas marrëveshjes së Helsinkit, harta e Europës ka ndryshuar në një nivel të paimagjinueshëm. Brenda këtij konteksti të ri askush nuk mohon identitetin gjeografik të Ballkanit. Megjithatë ekzistojnë dinamika fluide rreth kufijve edhe nëse funksionet e tyre tradicionalë (dimensioni territorial) rigjenerohen, funksione të tjera²⁹ do të dalin në pah.

Është shumë e qartë se BE-ja po promovon idenë dhe se kufijtë e Europës lidhen shumë me sisteme specifike politike dhe ekonomike, dhe se europianizimi është më shumë se çdo gjë tjetër një proces transformimesh sistemike. Mbajtja e Ballkanit jashtë kufijve funksionalë të Europës është e rrezikshme sepse, sa më shumë që një vendi i duhet për t’u anëtarësuar në BE, aq më i madh bëhet rreziku që i gjithë projekti të dështojë. Pa një rritje të vullnetit të BE-së, panorama është e varfër për Ballkanin, rrethi vicioz do të ngelet ashtu si edhe kufiri europian në veri të Gadishullit të Ballkanit. Suksesi i Ballkanit lidhet me integrimin e të gjithë shteteve të rajonit në strukturat e NATO-s dhe BE-së. Disintegroimi i të shkuarës duhet zëvendësuar me integrimin në Europë bazuar te vlerat dhe interesat e përbashkët. Për të gjithë vendet në rajon, pavarësisht nivelit të integritit të tyre në BE dhe NATO interesat e përbashkëta duhet të jenë integrimi i plotë në strukturat europiane. Për të gjitha këto, interesi kryesor për zhvillimin është arritja e paqes dhe stabilitetit të qëndrueshëm. Kjo mund të arrihet vetëm në kuadër të integritit europian dhe euroatlantik. Vendet e rajonit duhet të ndalin së qeni problematikë në Europë dhe duhet që në vend të kësaj të merren me zgjidhjen e problemeve europiane. Që të ndodhë kjo, duhet të ketë vullnet politik dhe këmbëngulje ndërmjet gjithë vendeve për të ecur në këtë drejtim.

Ky proces do të përmbushet vetëm nëse do të ketë një lidhshmëri të suksesshëm. Siç ka thënë presidenti Harry Truman: “Njerëzit e bëjnë historinë dhe jo e kundërta. Në periudhat kur nuk ka lidhshmëri shoqëria mbetet në vend. Progresi ndodh kur

²⁸ Havel, Vaclav, 15th June 2000, “Overcoming the division of Europe” (speech given to the European Parliament on 15th June 2000) in *Enlargement and the Finality of European Integration*, Zielonka Jan, Harvard Jean Monnet Working Paper 7/00, Symposium: Responses to Joschka Fischer.

²⁹ Ioakimides, P.C., 2001, “The extent and the borders of the European Space-New realities and challenges” in *The New European Space-Enlargement and the Geography of European Development*, eds. Andrikopoulou E. and Kafkalas Gr. Athens Themelio.

liderë kurajozë të zotë kapin mundësinë për të ndryshuar gjërat për më mirë”.

Referencat

- Agh, Attila, 1998, *The Politics of Central Europe*, Sage.
- Balkan Forum, 17-18 June, 2004, *Rethinking the Balkans: Incongruities of State and Nation Building, Regional Stabilisation and European Integration*, Discussion paper final version, p. 3, Bertelsmann Foundation and Center for Applied Policy Research, Berlin
- Balkan Forum, 2004, “Rethinking the Balkans...”, *op. cit.*, p. 5.
- Balkan Forum, July 2002, *Integrating the Balkans: Regional Ownership and European Responsibilities Discussion paper*, p. 6, Bertelsmann Foundation and Center for Applied Policy Research and Policy Planning Staff, German Federal Ministry of Foreign Affairs, Berlin.
- Centre for Policy Studies, 2003, *In Search of Responsive Government. State Building and Economic Growth in the Balkans*, p. 36, Centre for Policy Studies, CEU (Central European University), Budapest.
- D. Bechev & S. Andreev, 2005, “Top-Down vs. Bottom-Up...”, *op. cit.*, p. 7.
- D. Bechev, 2006, “Constructing South East Europe...” *op. cit.*, p. 23.
- Demetropoulou Leeda, November 2002, *Europe and the Balkans: Membership Aspiration, EU Involvement and Europeanization Capacity in South Eastern Europe*, Southeast European Politics, vol. III, no. 2-3.
- Gligorov, 1999, *et. al.*, “Balkan Reconstruction...”, *op. cit.*, p. 18, See also: M. Uvalic, 2003, “Economic Transition in Southeast Europe”, p. 63, in *Southeast European and Black Sea Studies*, 3 (1).
- Gligorov, 1999, *et. al.*, “Balkan Reconstruction...”, *op. cit.*, p. 17.
- H. Grabbe, June 2001, *Profiting from EU enlargement*, p. 60, Centre for European Reform (CER), London. Havel, Vaclav, 15th June 2000, “Overcoming the division of Europe” (speech given to the European Parliament on 15th June 2000) in *Enlargement and the Finality of European Integration*, Zielonka Jan, Harvard Jean Monnet Working Paper 7/00, Symposium: Responses to Joschka Fischer.
- I. Krastev, 2002, “The Balkans: Democracy Without Choices”, p.

- 43, *Journal of Democracy*, 13, Ioakimides, P.C., 2001, "The extent and the border's of the European Space-New realities and challenges" in *The New European Space-Enlargement and the Geography of European Development*, eds. Andrikopoulou, E. and Kafkalas, Gr., Athens: Themelio.
- J. Rupnik, 2000, "Eastern Europe...", *op. cit.*, p. 126.
- L. Demetropoulou, 2002, "Europe and the Balkans: Membership Aspiration, EU Involvement and Europeanization Capacity in South Eastern Europe", p. 88, *Southeast European Politics*, III (2-3).
- M. Uvalic, 2003, "Economic Transition...", *op. cit.*, p. 79, less emphasis, O. Anastasakis & D. Bechev, 2003, "EU Conditionality...", *op. cit.*, p. 3.
- O. Anastasakis & D. Bechev, 2003, "EU Conditionality in South-East Europe: Bringing Commitment to the Process", p. 3-4, *European Balkan Observer* 1 (2).
- O. Anastasakis, 2005, "The Europeanization of the Balkans", p. 80, *The Brown Journal of World Affairs*, XII (1).
- O'Donnell & Schmitter 1986, reference from P. Kopecky & C. Mudde, "What has Eastern Europe...", *op.cit.*, 2000, p. 519.
- Pippan, 2004, "The Rocky Road to Europe: The EU Stabilisation and Association Process for the Western Balkans and the Principle of Conditionality", p. 235, *European Foreign Affairs Review*, 9 (2).
- Radaelli, Claudio, 10-13 April 2000, "Whither Europeanisation? Concept stretching and substantive change", *Political Studies Association Annual Conference*, London.
- S. Panebianco & R. Rossi, October 2004, *EU Attempts to Export Norms of Good Governance to the Mediterranean and Western Balkan Countries*, p. 15 & 20, Jean Monnet Working Papers in Comparative and International Politics (JMWP) n° 53, Jean Monnet Centre EuroMed - Department of Political Studies - University of Catania, Catania.
- Schmitter, Philippe, 1996, "The influence of the international context upon the choice of national institutions and policies in neo-democracies" in *The International Dimensions of Democratization-Europe and the Americas*, ed. Whitehead Laurence, (Oxford: Oxford University Press).
- WIIW-Vienna Institute for International Economic Studies, March 2006, *The Western Balkans: Economic Development since Thessaloniki 2003*, p. 1., Vienna, World Bank, 1997, *The State in a Changing World*, The World Development Report, Washington.

Jacques Rupnik¹

BALLKANI SI ÇËSHTEJE EUROPIANE

Menjëherë pas përfundimit të Luftës së Parë Botërore që filloi në Ballkan, Arnold J. Toynbee argumentoi se ajo që deri më atëherë njihesh me emrin “Çështja Lindore” ishte në fakt një “çështje Perëndimore”². Sot, thuhet një dekadë pas përfundimit të luftërave të shpërbërjes së ish-Jugosllavisë, “çështja e Ballkanit” mbetet më shumë se kurrë “çështje europiane”. Në vitet 1990, rasti i Bosnjës u perceptua nga sytë e shumë europianëve si simboli i një dështimi kolektiv i tyre, ndërsa Kosova më vonë u bë katalizatori për fillimin e një politike të përbashkët të mbrojtjes dhe sigurisë. Gjatë dekadës së fundit, me përfundimin e procesit të rivijëzimit të hartës së rajonit, theksi kryesor i politikës së BE-së ndaj Ballkanit është zhvendosur nga një agjendë e dominuar prej çështjeve të sigurisë të lidhura me luftën dhe trashëgiminë e saj, drejt një agjende që përqendrohet te perspektiva e aderimit të shteteve të Ballkanit Perëndimor në Bashkimin Europian (për të cilën të gjithë vendet anëtarë të Bashkimit Europian kanë shprehur zyrtarisht zotimin e tyre politik që prej Samitit të Selanikut në qershor 2003). Kuadri u formua, elitat politike në rajon ishin (të paktën verbalisht) të prira për priorizimin e Europës dhe supozohej se çdokush ishte familjar me mjetet politike falë valëve të mëparshme të zgjerimeve lindore. Me shpërbërjen, të paktën në dukje të çështjeve më kontestuese të rajonit, BE-ja mund të shkonte nga stabiliteti nëpërmjet përmbajtjes drejt integritit në BE. Atëherë,

¹ Jacques Rupnik është Drejtor i Studimeve në *Centre for International Studies and Research (CERI)* në *Fondation Nationale des Sciences Politiques* në Paris dhe profesor në *Colleges of Europe*, në Bryzh. Ai gjithashtu është studiues i asociuar pranë *European Union Institute for Security Studies*. Ai ka qenë profesor me kohë të pjesshme në shumë universitete europiane dhe në Harvard. Gjithashtu Rupnik ka qenë dhe Drejtori Ekzekutiv i *International Commission on the Balkans* dhe hartues i raportit *Unfinished Peace* (Carnegie Endowment for International Peace, 1996).

² Arnold J. Toynbee, *The Western Question in Greece and Turkey* (London: Constable & Co, 1922).

cili është ndryshimi ndërmjet Europës Qendrore dhe Ballkanit? Përgjigja është dhjetë ose pesëmbëdhjetë vjet - dekada e humbur e luftërave ballkanike gjatë viteve 1990.

Përpara se të merret si i mirëqenë një prezantim kaq bindës për Ballkanin Perëndimor, duhen analizuar zhvillimet e favorshme rajonale dhe modat ndërkombëtare si edhe çështjet e diskutueshme dhe pengesat ndaj procesit. Disa prej këtyre lidhen me hapin e pabarabartë të reformave dhe ndryshimeve demokratike në rajon, të tjera me dyshimet rreth ekzistencës së vullnetit të mjaftueshëm dhe hapit të duhur politik brenda BE-së për të mbështetur një proces zgjerimi të rinovuar dhe të qëndrueshëm.

Aktorët ndërkombëtarë: “Ora e Europës”

“Ora e Europës”, fraza e famshme deklaruar prej Jacques Poos-it, Ministër i Punëve të Jashtme të Luksemburgut dhe President i Këshillit të BE-së në korrik të vitit 1991, u perceptua në Ballkan, në fillimet e luftërave atje, si shprehje e pavullnetshme e një humori të zi. Megjithatë, dy dekada më vonë, BE-ja është shfaqur bindshëm si aktori ndërkombëtar kryesor në Ballkan. Tre faktorë kanë përforcuar së fundmi rolin e saj si i aktor ndërkombëtar i rëndësishëm në Ballkan: zhvillimi i roleve përkatës të Shteteve të Bashkuara, Rusisë dhe Turqisë³.

Shtetet e Bashkuara: Përkundër tensioneve transatlantike që karakterizuan dy ndërhyrjet ushtarake të udhëhequra nga SHBA-ja gjatë viteve 1990, së fundmi ka pasur një shkrirje graduale të politikave europiane dhe atyre amerikane. Dekada e fundit karakterizohet nga europianizimi i qëndrueshëm i prezencës ndërkombëtare në Ballkan, ndërsa prioritetet e SHBA-së vazhdojnë të zhvendosen nga Europa që prej 11 shtatorit. Lista aktuale e prioritetëve ndërkombëtarë të Uashingtonit sot përfshin një “G2” me Kinën, mospërhapjen e armëve bërthamore në Iran, luftën në Afganistan si test për NATO-n dhe marrëdhëniet me Pakistanin, konfliktin Izrael-Palestinë si çelësi i paqes për Lindjen e Mesme dhe, së fundmi, implikimet strategjike të “valës së demokratizimit” të vitit 2011 në botën Arabe⁴. Ballkani duket

³ Për të vlerësuar kontrastin me situatën e një dekade më parë, shiko kapitullin përkatës mbi politikën amerikane, ruse dhe turke dhe vlerësimin transatlantik nga Pierre Hassner dhe Dana Allin në Rupnik (ed.) *International Perspectives on the Balkans* (Clemensport, NS: Canadian Peace-keeping Press, 2003).

⁴ Álvaro de Vasconcelos (ed.), “The Arab Democratic wave”, *Report no. 9, European Union Institute for Security Studies*, Paris, Mars 2011.

se është nga fundi i agjendës, një fakt ky që nuk mirëpritet gjithmonë nga aktorët rajonalë. Në shenjë afrimi, vizitat në rajon të zëvendës-presidentit Biden në vitin 2009 dhe të Sekretares së Shtetit, Klinton, në vitin 2010, treguan një angazhim të vazhdueshëm të SHBA-së, i cili vlerësohet si kryesor prej një sërë aktorësh në rajon (boshnjakët, kosovarët, shqiptarët dhe kroatët). Por tendenca e përgjithshme është e qartë dhe nuk mendohet se do të ndryshojë në të ardhmen e afërt. Anne-Marie Slaughter, Shefe e Planifikimit të Politikave në Departamentin e Shtetit, së fundmi prezantoi “Raportin 4-vjeçar të diplomacisë dhe zhvillimit”⁵, i cili liston si tema kryesore: sigurinë njerëzore (po aq sa dhe aspektet ushtarake); zhvillimin (aktualisht aq i rëndësishëm sa çështjet e kontrollit të armëve gjatë Luftës së Ftohtë); parandalimin e konfliktit dhe reagimin ndaj shteteve të dobëta dhe shoqërive të ndara. Ballkani nuk u përmend, edhe pse të tria çështjet lidhen, pa dyshim, drejtpërdrejt me rajonin.

Ekzistojnë qëndrime të ndryshme të herëpashershme transatlantike mbi vlerësimin e stabilitetit të rajonit dhe sidomos për Bosnjën⁶ që kanë ndikime te politikat: A duhet mbajtur Zyra e Përfaqësuesit të Lartë apo jo? A nevojitet një i dërguar i posaçëm i SHBA-së? Gjithashtu ekziston një inkonsistencë e vazhdueshme amerikane për pasjen e një vullneti të qartë europian për hetimin e kriminelëve të luftës nëpërmjet GJNKLLJ-së në Hagë. Së fundmi, ekzistojnë shqetësime rreth implikimeve të mundshme të mospasjes së një mendimi të përbashkët europian mbi njohjen e pavarësisë së Kosovës.

Edhe pse reduktimi i përfshirjes së SHBA-së në Ballkan përputhet me procesin e integritit europian, i cili perceptohet si “e vetmja lojë në qytet”, BE-ja duhet të nxitë vazhdimin e kësaj përfshirjeje. Kjo sidomos, duke pasur parasysh faktin se SHBA-ja gëzon besueshmëri më të madhe sesa europianët, veçanërisht në Kosovë dhe Bosnjë dhe se qëllimi i saj kryesor i theksuar qartë është të asistojë aderimin e rajonit në BE. Më shkurt: integrimi europian që përforcohet prej policës së sigurimeve atlantike.

Rusia nën udhëheqjen e Putinit është përpjekur të rimarrë rol kryesor në Ballkan. Gjatë viteve të fundit ajo ka përfutur

⁵ Anne-Marie Slaughter, leksion mbajtur në CERL, Sciences Po, Paris, 20 janar 2011.

⁶ Richard Holbrooke dhe Paddy Ashdown, “A Bosnian powder keg”, *The Guardian*, 22 tetor 2008, si dhe Patrice McMahon and Jon Western, në “The Death of Dayton”, *Foreign Affairs*, shtator/tetor 2009, e prezantojnë Bosnjën si në prag të shpërbërjes dhe bëjnë thirrje për ndërhyrje ndërkombëtare për të parandaluar një konflikt të ri.

kapacitetin e duhur për të qenë problematike dhe po ndërmerr një lloj rikthimin në rajon, jo më bazuar në retorikën e vagullt për solidaritet me vëllezërit e saj sllavë ortodoksë në rrezik, por duke u përqendruar te çështja e Kosovës dhe furnizimi me energji. Rusia ka fituar një pozicion vendimtar në sektorin energjetik serb dhe vizita e Putinit në Beograd më 23 mars 2011 synonte të çonte përpara projektin e gazsjellësit *South Stream*. Rusët po përpiqen t'ju përcjellin shteteve europiane mesazhin se ata duhet të mirëpresin këtë rival të Nabucco-s si pjesë të diversifikimit të nevojshëm të furnizimit me energji, duke pasur parasysh trazirat aktuale në Lindjen e Mesme. Vektori i dytë paralel i rikthimit të Ruisë në Ballkan ka qenë mbështetja, dhënë pretendimeve të Serbisë mbi Kosovën. Pozicioni i qëndrueshëm i BE-së ndaj vetëvendosjes së Kosovës dhe “konfliktet e ngrira” në Kaukaz janë vënë në pikëpyetje, siç pritej nga Rusia. Të theksosh se këta janë argumente që duken qartë, kjo nuk e ul nevojën për adresimin e tensioneve që ekzistojnë ndërmjet legjitimitetit të pavarësisë së Kosovës dhe kërkesës së saj të vështirë për ligjshmëri dhe njohje ndërkombëtare (65 shtete e kanë njohur deri tani). Nëpërmjet gjykimit të saj në gusht 2010, Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë (GJND) ka ndryshuar dukshëm panoramën. Qeveria aktuale në Beograd perceptohet si më e favorshme ndaj BE-së që prej dy dekadave. Propozimi i përbashkët i një rezolute në OKB dhe qëndrimi i mbajtur nga presidenti Tadiç, i cili tashmë është i gatshëm të përfshihet në bisedime konkrete me Prishtinën, gjithashtu ndikojnë rolin e Ruisë. Fillimisht qasja e Beogradit ishte që të arrinte një marrëveshje me Ruisë duke i dhënë Moskës një pjesë në sektorin e saj të energjisë për të siguruar mbështetjen e saj në Këshillin e Sigurisë të OKB-së për Kosovën. Pas gjykimit të GJND-së dhe pragmatizmit të ri të Beogradit, Rusia vështirë se “do të jetë më serbe se vetë serbët”. Prandaj ka gjasa që kjo të jetë thjesht një ndërhyrje e kufizuar e Ruisë në Ballkan, në formën e një kujtese të rastit se precedenti i Kosovës ka ndikime edhe për enklavat recesioniste të Kaukazit dhe të vendeve të tjera. Me fjalë të tjera, për Moskën çështja e Kosovës mbetet kryesisht një argument për t'u përdorur në negociata në mbështetje të pretendimeve të saj ndaj “vendeve të afërta jashtë saj”.

Politikat e **Turqisë** janë faktori i tretë i favorshëm për rolin e BE-së në Ballkan. Ka pasur një sërë zhvillimesh të dukshme dhe përgjithësisht pozitive në marrëdhëniet ndërmjet Turqisë dhe një sërë vendesh të Ballkanit (Bullgarisë, Greqisë dhe, së fundmi, Serbisë) që sugjerojnë se armiqësitë e vjetra të trashëguara nga lidhja perandorake mund të tejkalohen. Turqia ka hapur

negociatat e zgjerimit me BE-në në tetor 2005, përpara vendeve të Ballkanit. Meqenëse këto të fundit kanë qenë pjesë e Perandorisë Osmane, kjo ishte, sipas perspektivës së tyre, një ndër paradokset e “europianizimit”. Duke pasur parasysh se historikisht identitetet e tyre kombëtare dhe europiane u ndërtuan në kundërshtim me trashëgiminë osmane, është e vetëkuptueshme për këto vende që të kërkojnë shkrijen e procesit të tyre të aderimit me Turqinë⁷. Gjatë rrugës për në Bruksel, kapni vagonin tuaj të “Orient Ekspresit” nga Stambolli. Në vijim të zgjerimit për përfshirjen e vendeve të ish-Perandorisë Habsburgase, a është hapi tjetër një zgjerim “postosman” që përfshin Europën Juglindore?

Nevoja për afërsi gjeografike dhe për politika koherente të BE-së lidhur me fqinjët e saj juglindorë është theksuar dhe do të vazhdojë të theksohet. Megjithatë, pavarësisht meritave, ngurrimi i opinionit publik (sidomos në Gjermani dhe Francë) për anëtarësimin e Turqisë në BE dhe rikonfirmimi i kësaj të fundit si një lojtar ndërkombëtar (vota e saj kundër BE-së dhe OKB-së, duke u vendosur së bashku me Brazilin si ndërmjetëse për negociatat me Iranin) do të sugjeronin se, nëse seriozisht synohet që Ballkani Perëndimor të integrohet në BE, duhet parë mundësia për ndarjen e agjendës nga Turqia. Sidoqoftë, në politikën aktuale turke nuk ekziston asgjë që të dobësojë pozicionin e BE-së në Ballkan si “e vetmja lojë në qytet”.

Dimensionet rajonale të shtetndërtimit dhe integrimi në BE

Mbetet për t’u parë nëse mjedisi ndërkombëtar i favorshëm lehtëson hartimin e një **qasjeje rajonale** koherente nga ana e BE-së. Kjo çështje i ka fillësat te debati i viteve 1990 rreth prioriteteve rajonale të Paktit të Stabilitetit për Ballkanin kundrejt konkurseve individuale të inkurajuara nga Procesi i Stabilizim-Asocimit. Sot BE-së i duhet të pajtojë situatat e ndryshme dhe marrëdhëniet që ka vendosur me vendet individuale të rajonit me nevojat për të adresuar çështjet e shtetndërtimit - si kufijtë dhe minoritetet; si dhe çështjet e tregut të përbashkët - si tregtia dhe komunikimi që kërkojnë qasje rajonale.

Ka dy mënyra për të vlerësuar situatën në rajon. Njëra është nëpërmjet perspektivës së Komisionit European dhe të raporteve

⁷ Për një studim të fundit të zhvillimit të perceptimeve të Turqisë, shih Bozidar Jezernik (ed.), *Imagining ‘The Turk’* (Cambridge: Scholars Publishing, 2010).

të tij të progresit, duke vendosur me një shpirt të vërtetë aventurier, vlerësimin e vendeve të Ballkanit Perëndimor në rrugën e tyre përpara drejt anëtarësimit në BE. Rruga e dytë është: të kombinosh një panoramë rajonale më të gjerë me pikëpamje nga vetë vendet e Ballkanit, çka do të tregonte limitet e qasjeve individuale sipas vendeve për problemet e përbashkëta dhe çështjet e diskutueshme të mbetura pezull si dhe për integrimin në BE.

Raportet vjetore të progresit për vendet e Ballkanit Perëndimor, të publikuara në nëntor 2010, theksojnë se vendet e rajonit shfaqin një trend familjar shenjash inkurajuese progresi dhe një listë të gjatë gjërash për t'u bërë. Pra, gota është gjysmë bosh dhe gjysmë plot. Në rrethana normale kjo mund të kalojë si një rutinë prozaike e procesit të paraaderimit. Por këto nuk janë "rrethana normale" as për BE-në dhe as për Ballkanin. Një shpjegim i shkurtër i ndryshimeve të fundit dhe i pengesave të mbetura mund të ndihmojë për vendosjen e qasjes për rikonsiderimin dhe përsheptimin e procesit të zgjerimit.

Aktualisht, BE-ja po punon me tri kategori vendesh. Kroacia është duke përmbyllur negociatat e saj dhe do të bëhet anëtare e BE-së në vitin 2013; Republika ish-Jugosllave e Maqedonisë (RIJM)⁸ dhe Mali i Zi (të cilëve tashmë do t'u bashkohet edhe Serbia) kanë statusin e kandidat të BE-së; Bosnjë Hercegovina dhe Kosova ende mbeten (për arsye praktike) dy gjysmëprotektorate të europianizuara. Shqipëria duhej të kishte qenë në kategorinë e dytë, por tashmë duket qartë se mbetet një rast i izoluar.

Lidhur me hapin e reformave⁹, as Kroacia që është në krye të listës nuk mund të përgëzohet. Për sa i përket shfaqjes ekonomike, në vitin 2007 ajo mund të ishte bërë anëtare e BE-së së bashku me Rumaninë dhe Bullgarinë me të cilat ajo ndan nevojën për luftën ndaj korrupsionit dhe reformimin e sistemit të drejtësisë, i cili deri tani ka nxjerrë pengesë me rreth dy milionë çështje të lëna pezull. Pa dyshim që vendi ka mungesë eksperience për vendosjen e gjykatësve të pavarur për çështjet me ndjeshmëri politike. Nën presionin e BE-së, ish-kryeministri Ivo Sanader, njeriu që ndihmoi "europianizimin" e HDZ-së së

⁸ Instituti ndjek vendimin e BE-së dhe OKB-së për sa i përket emrit të këtij vendi (FYROM/ARYM, UN resolutions 817 and 845/93). Megjithatë, në këtë volum autorët e asociuar mund të kenë përdorur edhe emërtime të tjera.

⁹ Neil MacDonald, "Pace of reform sets back Croatia's EU hopes", *Financial Times*, 3 mars 2011.

trashëguar nga epoka e Tuxhmanit, është nën mbikëqyrje në Austri që prej dhjetorit të vitit 2010, i akuzuar për pastrim parash dhe korrupsion, ndërsa një sërë anëtarësh të qeverisë gjithashtu po përballen me procese gjyqësore për korrupsion. Vizioni evropian i presidentit Ivo Josipoviæ¹⁰ që kombinon bashkëpunimin rajonal dhe integrimin në BE sigurisht që vlerësohet jashtë, por aktualisht po përballlet me pakënaqësitë shoqërore në rritje dhe euroskepticizmin brenda vendit.

Në fund të listës qëndrojnë Bosnjë Hercegovina dhe Kosova, ku politikat e ndara dhe kuadri institucional që nuk funksionon janë faktorët (të paktën të pjeshëm) për paaftësinë për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar. Një përfaqësues i lartë i BE-së ka theksuar për Bosnjën se raporti i këtij viti mund të quhej “raporti i mosprogresit”. Grupi i mesit përfshin RIJM-në, Malin e Zi dhe Serbinë, të cilët ndajnë shqetësime të përbashkëta për shtetin ligjor dhe mirëqeverisjen dhe që, megjithatë, kanë arritur progres lidhur me reformat ekonomike dhe bashkëpunimin rajonal. Liberalizimi me vonesë i vizave nga BE-ja ka qenë pa dyshim sinjali më pozitiv që iu është përcjellë njerëzve të rajonit. Si mund të besonin ata në të ardhmen e vendit të tyre në Europë për sa kohë që nuk lejoheshin të udhëtonin aty? Vetëm Kosova mbetet e veçuar në një geto. Statusi kandidat i është dhënë RIJM-së dhe Malit të Zi, por është shtyrë për Shqipërinë. Nuk është e pranueshme që një vend - zgjedhjet e qershorit 2009 (që nuk janë njohur nga opozita), të ftohet për status. Polarizimi ekstrem dhe i dhunshëm politik ka ndalur jetën parlamentare dhe vendi po kalon krizën më të keqe që prej skandalit të piramidave financiare të vitit 1997¹¹. Statusi i vendit kandidat do t’i jepet tashmë Serbisë, sepse Beogradi ka qenë ai që ka iniciuar disa nga ndryshimet më inkurajuese dhe më të rëndësishëm të të gjithë rajonit.

Duke u ndarë qartësisht nga tonet dhe substanca e politikave të qeverisë së Koshtunicës në vitin 2010 dhe nën udhëheqjen e

¹⁰ Ivo Josipovic, “Regional cooperation and EU integration: two foundations of the same process”, fjalim i mbajtur në *Kennedy School of Government*, Universiteti i Harvardit, 11 shkurt 2011.

¹¹ “Tre persona u vranë dhe gjashtëdhjetë u plagosën gjatë protestave të opozitës”, Mathew Brunwasser, “Two Men Jostle for Power”, *The New York Times*, 26 janar 2011. Edi Rama, kryetari socialist i Bashkisë së Tiranës ka bërë thirrje për demonstratë kundër “dhunës dhe krimin”, ndërsa kryeministri Berisha denoncoi një tentativë për grusht shteti. Shih gjithashtu “Albania and Kosovo: a bad week”, *The Economist*, 27 janar 2011. Pa konsolidimin e demokracisë do të ketë pak shanse për perspektivën evropiane të Shqipërisë.

Tadiç, Serbia ka zëvendësuar frazat e saj të stokut proeuropian me politikat aktuale proeuropiane. Hapi i parë i domosdoshëm ishte normalizimi i marrëdhënieve me fqinjët. Pas një dekade luftërash të shpërbërjes së Jugosllavisë, e cila u pasua nga një dekadë rimëkëmbjeje dhe ngërçesh, tashmë kemi parë ndërmarrjen e një sërë hapave konkretë drejt njohjes së krimeve të kryera dhe një kthesë 120 gradë për çështjen e Kosovës. Në vijim të marrëdhënieve të tensionuara me Kroacinë dhe akuzave të ndërsjella për gjenocid, që u çuan në GJND në vitin 2009, Presidenti Tadiç gjeti te homologu i tij kroat i sapozgjedhur, Ivo Josipoviç, një partner për një qasje ndryshe¹². Fjalimet e Tadiç gjatë vizitave të tij në Srebrenicë, në Bosnjë, dhe Vukovar, në Kroaci, ishin konceptuar si pjesë e procesit të pajtimit që hapin një fazë të re në marrëdhëniet e Serbisë me fqinjët e saj. Ndoshta e vetmja pengesë e vazhdueshme për të ndryshuar Bosnjë Hercegovinën është Republika Srpska, e cila, nën udhëheqjen e Dodik, sillet si një shtet brenda shtetit. Ndryshimi, megjithatë, është se Beogradi nuk mbështet më separatizmin e theksuar të kësaj njësie (e njëjta gjë vlen edhe për sjelljen e Zagrebit ndaj Bosnjë Hercegovinës). Në 31 mars 2010, Parlamenti serb kaloi me një maxhorancë të ngushtë (127 nga 250 vota), një rezolutë që pranon përgjegjësinë për një krim të madh të kryer nga trupat e gjeneralit Mlladiç në Srebrenicë gjatë vitit 1995¹³. Një komision serbo-kroat është krijuar për t'u marrë me problemet bilaterale më të vështira, një precedent i mirëpritur edhe për marrëdhëniet e Serbisë me Kosovën. Në mënyrë të pavarur nga përpjekjet e qeverisë, një projekt i sponsorizuar nga Instituti për Drejtësi Historike dhe Pajtim sugjeron mënyra se si studiuësit nga Serbia, Kroacia dhe shtete të tjerë pasardhës të ish-Jugosllavisë mund të përpiqen të reduktojnë historinë me bazë mitologjinë nacionaliste dhe të kërkojnë për një narrativë të përbashkët¹⁴.

Pa dyshim që ndryshimet më të mëdha dhe të papritura kanë ndodhur lidhur me Kosovën. Përfshirja e Serbisë në një rezolutë të përbashkët të BE-së dhe Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së në vitin 2010 shënoi një ndryshim thelbësor në marrëdhëniet e saj me Kosovën. Në të shkuarën, shqiptarët e Kosovës e konsideronin

¹² Marek Kubista, "Reprise du dialogue entre la Serbie et la Croatie", *Euractiv. fr*, 29 mars 2010.

¹³ Stephen Castle, "Serbia's censure of 1995 massacre falls short for EU", *International Herald Tribune*, 1 prill 2010.

¹⁴ Darko Gavrilovic and Vjekoslav Perica (eds.), "Political Myths in the former Yugoslavia and Successor States: a Shared Narrative", *Institute for Historical Justice and Reconciliation* (Dordrecht: The Republic of Letters, 2011).

çështjen e statusit si thelbësore ndërsa Serbia preferonte të merrej me çështje teknike. Pas deklarimit të pavarësisë së Kosovës në shkurt të vitit 2008, rolet u ndërruan. Beogradi i konsideroi bisedimet mbi statusin si parakusht për zgjidhjen e problemeve praktikë ndërsa Prishtina preferonte të fokusohet te specifikat. Në shtator të vitit 2010, Serbia ra dakord për bisedime të drejtpërdrejta pa kushte me Kosovën, kryesisht për sa i përket marrëdhënieve të serbëve të Kosovës me Serbinë, por edhe për një sërë çështjesh bilaterale që variojnë nga doganat deri te furnizimi me energji. Ky ndryshim në qëndrimin e Serbisë është në vijim të gjyqimit të GJND-së të datës 22 korrik 2010, që thekson se “deklarata e Kosovës për pavarësi nuk është në kundërshtim me normat e të drejtës ndërkombëtare”. Kjo ishte një dështim për Serbinë e cila mendonte se kishte një argument ligjor të fortë edhe pse realitetet politike në terren po ecnin në drejtim të kundërt. Ajo që ndodhi që prej verës së vitit 2010 mund të përshkruhet si kënaqja e kosovarëve me vendimin e GJND-së dhe mbi të gjitha triumfi i realizmit proeuropian në politikat e Serbisë. Gjithashtu ka qenë një sukses për BE-në, e cila ka qenë e aftë të hartojë një rezolutë të përbashkët me Serbinë dhe të dalë si një ndërmjetësuese e marrëdhënieve ndërmjet Beogradit dhe Prishtinës. Si rrjedhojë u mundësua që bisedimet e drejtpërdrejta ndërmjet Serbisë dhe Kosovës të fillonin në 8 mars 2011. Askush nuk mund të thotë se sa do të bisedohet dhe as se çfarë do të arrihet nëpërmjet këtyre bisedimeve pasi të parashtrihen në tavolinë çështjet më të ndjeshme si Mitrovica dhe Kosova e Veriut. Por nëse BE-ja mundëson mbështetjen e duhur dhe incentivat politike, mund të jemi afër tejkalimit të çështjes më të vështirë të sigurisë në Ballkan si dhe të asaj që është pengesa kryesore në përpjekjet e BE-së për stabilizimin dhe integrimin e rajonit.

Një nga pengesat politike për zhvillimin e bashkëpunimit rajonal, menjëherë pas përfundimit të luftës, ishte dyshimi mbizotërues, sidomos në Kroaci, se kjo përbënte një përpjekje të nxitur nga jashtë për të ribërë së bashku një entitet që t'i ngjasonte ish-Jugosllavisë. Ky perceptim nuk mbizotëron më, pasi siç ka theksuar me të drejtë Tim Judah: “Nga Sllovenia deri në kufirin maqedonas me Greqinë, shumica e njerëzve në rajon ende kanë shumë të përbashkëta, edhe pse nuk flasin shumë për to. Çdo ditë lidhjet ndërmjet tyre, që u shkëputën në vitet 1990, po rivendosen qetësisht. Jugosllavia ka kohë që ka ikur dhe në vend të saj po lind Jugosfera”¹⁵. Kjo shkon përtej retorikave

¹⁵ Tim Judah, “Entering the Yugosphere”, *The Economist*, 20 gusht 2009. Një analizë më e detajuar për këtë çështje u prezantua nga autori në një studim të përgatitur për *London School of Economics*.

të presidentëve Josipoviç dhe Tadiç dhe lidhet me tregtinë dhe rivendosjen e lidhjeve ndërmjet kompanive, profesioneve dhe qytetarëve. Pa mbivlerësuar efektin potencial në zinxhir të këtyre zhvillimeve, ato do të krijonin një kontekst të favorshëm për t'ju qasur integritit në BE përtej logjikës së emulacionit dhe strategjisë për aderim individual.

Megjithatë, përtej këtyre zhvillimeve të favorshme, rasti më i mirë për një qasje rajonale të zgjerimit të BE-së në Ballkan buron nga natyra specifike e zotimeve të rajonit: për të pajtuar detyrat në dukje kontradiktore për ndërtimin e shteteve-kombe dhe integrimin evropian. Ndryshimi kryesor me vendet e Europës Qendrore nuk është vetëm një boshllëk kohor apo niveli i konsolidimit demokratik, por çështja e shtetësisë dhe e kapaciteteve të shtetit. Për sa kohë kjo nuk u vendos në kuadër të shpërbërjes së ish-Jugosllavisë dhe për aq kohë sa çështjet e kufijve dhe minoriteteve kombëtare kanë përbërë agjendën politike, shanset për konsolidim demokratik mbeten të pakta. Me pavarësinë e Kosovës, rivizatimi i hartës është përfunduar, por shtetet pasardhës janë ende duke u zhvilluar. Në vitin 1988, Zoran Xhinxiç e quajti Jugosllavinë një shtet “të papërfunduar”. Sot, Veton Surroi përkufizon pasardhësit e saj si “shtete të papërfunduara”: Kosova në kërkim të njohjes dhe sovranitetit; Bosnjë Hercegovina në kërkim të një kushtetute të post-Dejtonit (vendosja e një kushtetute hartuar për të përfunduar luftën dhe për një demokraci politike funksionale); Serbia në kërkim të pranueshmërisë së kufijve me shtetet e sipërpërmendur (mosnjohja e Kosovës si një ambivalencë e marrëdhënive të saj me Republikën e Srpskas); Maqedonia në kërkim të identitetit dhe emrit). Për herë të parë, Bashkimi Evropian, një projekt i konceptuar për relativizmin e sovranitetit të shteteve është përfshirë në formimin e shteteve-kombe të rinj që aspirojnë anëtarësinë në BE. Deri tani fuqia transformuese e BE-së ka qenë efikase për integrimin e shteteve të formuar dhe njohur, ndërsa aktualisht po përballet me sfidat e integritit të shteteve të kontestuar.

Me siguri ky nuk është një argument shumë popullor për Komisionin ose për vendet më të avancuara candidate. Pa dyshim që aderimi i asnjë vendi nuk duhet të jetë peng i paqëndrueshmërisë së fqinjëve të tij. Megjithatë, duke pasur parasysh, për shembull, ndërveprimin ndërmjet aspekteve të ndryshme të “çështjes serbe” (me Kosovën dhe Bosnjën), duket diçka zgjuar, ndërtimi i zhvillimeve aktuale pozitive për inkurajimin e qasjes rajonale dhe zgjidhjen e këtyre problemeve¹⁶.

¹⁶ Cf “Pour une nouvelle entente balkanique”, special issue of Anatoli (CEMOTI), CNRS, Paris, Shtator 2010.

Për të përmbledhur trendet e favorshëm: BE-ja ka dalë si aktor i pasfidueshëm ndërkombëtar në Ballkan, rajoni i lodhur nga një dekadë konflikti po rimerr stabilitetin dhe kapacitetin për të bashkëpunuar; BE-ja nuk ka një agjendë tjetër të mirëpritur zgjerimi dhe mund të përdorë përfshirjen e drejtpërdrejtë të disa prej vendeve anëtare në rajon për lehtësimin e procesit të aderimit.

Vendet anëtare si vektorë për integrimin në BE?

Parë nga pozicioni i BE-së, duket një lëvizje e zgjuar që të sigurohesh se çështjet e kontestuara lidhur me “shtetet e papërfunduara” të zgjidhen gjatë procesit të bashkimit ku edhe ndikimi i BE-së është më i madh. Një hipotezë lidhur me këtë thekson se vendet anëtare të BE-së mund të veprojnë si lehtësues ose si nxitës për procesin e “europianizimit”. Një analizë e shkurtër e disa prej pengesave të mbetura, hedh dyshime mbi këtë hipotezë.

Ekzistojnë një sërë çështjesh bilaterale të kontestueshme që mund të bëhen pengesa serioze për procesin e anëtarësimit në BE. Për të marrë si shembull vendin pararojë, Kroacia ka çështje të pazgjidhura për kufijtë me shumicën e fqinjëve të saj. Ajo që ishte më e lehta për t’u zgjidhur prej tyre (ose të paktën kështu dukej), ishte aksesin i Sllovenisë në ujërat ndërkombëtare. Por gjatë viteve të fundit kjo çështje është përshkallëzuar në një bllok potencial pengese për anëtarësimin e Kroacisë në BE¹⁷. Referendumi i vitit 2010 në Slloveni mbi zgjidhjen e propozuar ishte një bast me rrezikshmëri të lartë, i cili mund të kishte shkaktuar një kthim të madh prapa për perspektivën e Kroacisë në BE, çka do të kishte pasur edhe për pjesën tjetër të Ballkanit Perëndimor.

Konflikti i dytë bilateral që përbën një pengesë serioze në rrugën drejt BE-së i përket kërkesës së Maqedonisë për një emër post-RIJM-së dhe për një identitet që të pranohet prej Greqisë fqinje. Gjatë vitit 2009, Greqia vendosi veton për anëtarësimin e RIJM-së në NATO dhe ka pak gjasa që ajo do të jetë më elastike për sa i përket anëtarësimit të këtij vendi në BE. Qeveria e RIJM-së (e cila po shfrytëzon kundërshtitë për çështje të brendshme) ka çuar tashmë mosmarrëveshjen në fjalë në Gjykatën Ndërkombëtare të Drejtësisë në Hagë duke

¹⁷ Për një prezantim më të detajuar të negociatave, shih: Vasilka Sancin, “Slovenia-Croatia Border Dispute: from ‘Drnovsek-Racan’ to ‘Pahor-Kosar’ Agreement”, in *European Perspectives*, tetor 2010, f. 93-111.

akuzuar Greqinë se ka shkelur dispozitat e Marrëveshjes së vitit 1995¹⁸. Përtej çështjes së pazgjidhur të emrit ndërmjet Athinës dhe Shkupit, çështja Greke ka domethënie më të gjerë për zgjerimin e BE-së në Ballkan¹⁹. Duke pasur parasysh historinë e saj, zhvillimin socio-ekonomik dhe kulturën politike, Greqia përbën një shembull të asaj që Bullgaria dhe Serbia do të ishin nëse ato nuk do të kishin pasur një të shkuar regjimesh komuniste që pas Luftës së Dytë Botërore. Një vend që ka qenë anëtar i BE-së prej 30 vjetësh dhe që ka përfituar dukshëm nga fondet strukturore të saj, tashmë po nxjerr në pah se është i korruptuar dhe se nuk ka një shtet funksional. Në këtë rast nuk është e qartë se kush duhet të mësojë nga kush. Megjithatë, kriza greke është lajm i keq për Ballkanin sepse ndikon në mënyrën se si perceptohet rajoni në BE. Gjërat mund të jenë ndryshe vetëm nëse kriza financiare aktuale dhe ndihma e madhe ofruar nga partnerët e BE-së përcjell brenda vendit mesazhin se nuk është koha për të penguar politikën e BE-së në Ballkan.

Çështja maqedonase nxjerr në pah tensionet ndërmjet politikave të BE-së në Ballkan dhe atyre të disa prej vendeve anëtare të saj. Disa vende anëtarë (Greqia, Austria, Italia), për arsye historike dhe gjeografike, kanë qenë drejtpërdrejtë të përfshira dhe janë konsideruar në Bruksel si vektorët e ndikimit të BE-së në rajon. Të tjerë vende, si anëtarët e rinj të BE-së, Sllovenia, Bullgaria dhe Rumania kanë një rol të drejtpërdrejtë për stabilitetin e rajonit dhe perspektivat e anëtarësimit. Megjithatë, problemet me të cilat përballen dy vendet e fundit lidhur me shtetin ligjor dhe luftën kundër korrupsionit kanë rritur rezervat brenda BE-së lidhur me “hyrjen përpara kohe” të vendeve të tjera ish-komuniste të Ballkanit. Kështu, afërsia dhe përfshirja nuk mundësojnë automatikisht që vendet anëtare të BE-së të luajnë rolin e lehtësuesit në procesin e zgjerimit

Shqetësimi i tretë për BE-në në rajon vjen nga Qiproja. Ajo u përfshi në zgjerimin lindor të vitit 2004 me insistimin e Greqisë që pretendonte se anëtarësimi në Bashkimin Europian do të tejkalonte në të njëjtën kohë edhe çështjen e ndarjes së ishullit

¹⁸ GJND-ja filloi të ekzaminonte rastin në fjalë në mars 2011. Shih: Dnevnik (Skopje), 7 mars 2011. Siç pritej, Greqia perceptohet nga qytetarët e Maqedonisë si anëtarja e BE-së më armiqësore kundrejt aderimit të tyre ndërsa në Serbi, Greqia në të kundërt perceptohet si shteti më i favorshëm ndaj aderimit të vendit. (Gallup Balkan Monitor).

¹⁹ Georges Prevelakis shkruan për “riballkanizimin” e Greqisë në “La Grèce: trois décennies d’anesthésiant européen”, in *Géostratégiques*, no. 31, 2011, f. 97-109.

sipas Planit Annan²⁰. Ne e dimë se çfarë ndodhi me këtë argument dhe mënyrën se si BE-ja shfaqti mosvullnet ose mosdashje për të përdorur plotësisht ndikimin që ajo gëzon në momentin e anëtarësimit të një anëtari të ri. BE-ja tashmë duhet ta mbajë mend mirë këtë fakt, si “mësimet e Qipros”, gjatë marrëdhënieve të saj të ardhshme me vendet e Ballkanit Perëndimor. Nuk do të ketë marrëdhënie dypalëshe me BE-në pa zgjidhur, së pari, mosmarrëveshjet dypalëshe të ngelura pezull.

Këto zhvillime mjaftojnë për të vënë në diskutim pohimin e përhapur gjerësisht se vendet anëtarë të BE-së veprojnë automatikisht si stabilizatorë dhe si avokatë për hyrjen në BE të një vendi fqinj. Hyrja e Kroacisë në BE do të kontribuonte pa dyshim në stabilizimin e demokracisë dhe shtetit të së drejtës në këtë vend. Megjithatë, ndikimi mbi Bosnjë Hercegovinën fqinje mbetet i debatueshëm duke qenë se kroatët e atjeshëm, të cilët janë masivisht të pajisur me pasaporta kroate, po humbasin interesin në të ardhmen e shtetit të tyre. Kroacia është i vetmi shtet evropian që përmban më shumë votues sesa qytetarë. Pasaportat e shpërndara nga Rumania për rreth 800 000 qytetarë në Moldavi ose ato bullgare (ndonëse në nivel shumë më të ulët) për qytetarët e RIJM-së përbëjnë një problem të ngjashëm. Atëherë, cila është norma evropiane për këtë çështje? Në esenë e tij, Igor Štiks kërkon më kot një përgjigje koherente për këtë pyetje. Pa dyshim që nuk ka mundësi që Hungaria e Viktor Orbanit të mbajë Presidencën e BE-së në vitin 2011, ndërkohë që pajis me pasaporta dhe shtetësi minoritetet hungareze në shtetet fqinje²¹.

Megjithatë, kjo konfirmon rëndësinë e pyetjeve që lidhen me llojin e shtetësisë dhe me disa efekte destabilizuese të mundshme të zgjerimit të BE-së mbi disa prej fqinjëve të saj të rinj. Çdo lloj zgjerimi i BE-së në Ballkan duhet të përfshijë marrjen në konsideratë me kujdes të ndikimit të saj te shtetet e dobëta që nuk janë të përfshirë, dhe kështu edhe të marrëdhënieve të saj në kuadër të “Politikës së Fqinjësisë” dhe “Partneritetit Lindor”.

²⁰ Plani i OKB-së u hodh poshtë me referendum nga qipriotët grekë më 24 prill 2004, thuajse në prag të hyrjes së vendit në BE. Për një analizë të detajuar të rastit, shih: Olga Demetriou, “Catalysis, Catachresis: the EU impact on the Cyprus crisis”, in Thomas Diez et al. (eds.), *The European Union and Border Conflicts* (Cambridge: Cambridge University Press, 2008).

²¹ Kjo provokoi një reagim të ashpër nga Sllovakia dhe rrezikun për heqjen e të drejtës për të zgjedhur qytetarinë hungareze ose sllovake të të gjithë qytetarëve të minoritetit hungarez.

Konkluzione

Këto janë disa prej sfidave dhe dilemave kryesore me të cilat përballet BE-ja gjatë qasjeve të saj kundrejt Ballkanit Perëndimor. Logjika e zakonshme (e cila sigurisht që duhet vënë në pikëpyetje) është se qasja *regatta* funksionon mirë për BE-në duke qenë se ajo e bën procesin e zgjerimit mjaftueshëm diskret për t'u pranuar prej opinionit publik të Perëndimit si dhe stimulon mjaftueshëm agjendat reformiste të elitave politike në vendet përkatëse. Prandaj nuk duhet të habitemi nga fakti se "europianizimi" duket i ndryshëm nëse shihet nga perspektiva e BE-së apo nga ajo e vendeve që janë marrësit e fundit.

Kjo gjithashtu është edhe pika ku "lodhja nga zgjerimi" brenda BE-së përputhet me "lodhjen nga aderimi" në Ballkan. Procesi i fundit ka dy pamje. Nga njëra anë, elitat politike të rajonit përdorin zotime verbale për anëtarësimin në BE si një perde tymi për zhvillimin e politikave si modele biznesi. Gjithashtu nuk është më pak e rëndësishme erozioni i mbështetjes popullore për aderimin në BE (më i fortë në rastet më pak të avancuara si Shqipëria dhe më i dobët në vendet ku është avancuar më shumë si Kroacia)²². Sipas *Gallup Balkan Monitor*, shumica e qytetarëve në vendet e Ballkanit (përveç Kroacisë) do të votonin pro anëtarësimin në BE, edhe pse një shumicë në secilin prej vendeve kandidate beson se vendi i tyre "po shkon në drejtimin e gabuar"²³. Prandaj, ka rëndësi kontrolli i këtyre dyshimeve të parakohshme për një proces i cili ka ende rrugë për të bërë dhe nuk mund t'ia dalë pa mbështetjen e shoqërive të përfshira. Kjo tregon efektet e kufizuara të iniciativave si "samiti për të kujtuar samitin" (Sarajevë 2010, për të festuar Zagreb 2000) dhe nevojën për masa të dukshme që qytetarët të mund t'i identifikojnë drejtpërdrejtë me Europën. Nuk ka dyshim se liberalizimi i vizave ka qenë masa më e rëndësishme e këtij lloji, simbolikisht dhe politikisht, edhe pse duke lënë përkohësisht jashtë Kosovën.

²² Në Kroaci po dëshmojmë daljen në pah të dy llojeve euroskepticizmi. I pari dhe më familjari vjen nga nacionalistët dhe sovranistët. Ai lidhet me të drejtat e spektrit politik që mendon se BE-ja bëri pak për Kroacinë gjatë viteve të luftës së viteve 1990 dhe që gjeneral Gotovina (dorëzimi i të cilit në GJNKJ në Hagë u vendos si kusht për hapjen e negociatave) është Hero Kombëtar. I dyti vjen nga një gjeneratë e re e të majtës. Gjatë demonstratave të marsit 2011, në Zagreb, ata hodhën parulla si: "Jo kapitalizmit! Jo BE-së!". Kjo sfidë dyplaneshe për aderimin në BE bën të pasigurt përfundimin e referendumit të ardhshëm për anëtarësim.

²³ Gallup Balkan Monitor, Brussels.

Agjenda duket mjaftueshëm e qartë si për vendet e Ballkanit Perëndimor ashtu edhe për BE-në. Për BE-në ajo përfshin adresimin e dyshimeve të ngritura mbi shtetin e së drejtës pas hyrjes së Rumanisë dhe Bullgarisë, duke adresuar përballjen me korrupsionin, nepotizmin dhe preferencën për të anashkaluar normat ligjore. Këtu vendoset përballja me burimet kryesore të këtyre fenomeneve, trashëgimia nga socializmi (kapitali social perceptohet si rrjete të korruptuar për anashkalimin e ligjit), ekonomia e luftës (shkelja e embargove në bashkëpunim me krimin e organizuar) dhe tranzicioni i tregut (një proces i rrëmujshtëm dhe gjerësisht i korruptuar privatizimi). Së fundmi, por jo më pak e rëndësishme, është përdorimi i punonjësve të sektorit publik për patronazh politik dhe kapja e shtetit.

Vija ndarëse në politikat e Ballkanit nuk është (ose është shumë rrallë) ndërmjet liberal-demokratëve të cilët lidhin Europën me shoqëritë e tyre civile, nga njëra anë, dhe nacionalistëve autoritaristë e radikalë, nga ana tjetër. Në shumicën e rasteve vërehet një nacionalizëm i vazhdueshëm dhe sot detyrat e aderimit në BE janë kryesisht në duar të qeverive të përbëra prej nacionalistëve të moderuar. Rasti i Kroacisë sugjeron se nacionalizmi pragmatist mund të bëhet “eurokompatibel”. Zhvillimi i qeverive të HDZ-së të pas Tuxhmanit²⁴ nën Ivo Sanader dhe tani Jadranka Kosor (nën presionin e BE-së dhe të dy presidentëve Josipoviç dhe Mesiç) kanë hapur rrugën për këtë. Procesi tashmë është në zhvillim e sipër edhe në Serbi, e cila ka lëvizur drejt dekadës së nacionalizmit modern (nga Milosheviçi te Koshtunica dhe tashmë te Tadiç)²⁵. Ky ndryshim në qendrën e gravitetit të politikave të brendshme me daljen në pah të “eurorealizmit” dhe pragmatizmit do të jetë kryesor për tejkalimin e çështjeve të kontestueshme të përmendura më sipër dhe rrjedhimisht për arritjen e konsensusit për reformat e nevojshme për të përfunduar procesin e aderimit në BE të rajonit.

Pas pengesave në Ballkan vijnë ato që ekzistojnë në BE. Kriza e euros dhe sfidat që ajo vendos për kohezionin e BE-së

²⁴ Ky argument u zhvillua për herë të parë nga Jacques Rupnik në “The demise of Balkan nationalisms? A skeptical view”, në Judy Batt (ed.), “The Western Balkans: Moving On”, *Chaillot Paper* no. 70, European Union Institute for Security Studies, Paris, Tetor 2004.

²⁵ Trashëgimtarët e Millosheviçit dhe Partia Socialiste (PS) janë aktualisht në koalicionin qeverisës duke aplikuar për anëtarësim në *Internacionalen Socialiste* dhe duke punuar për zgjerimin në BE. Edhe Partia Radikale (me themeluesin e saj V. Seselj në Hagë) ka ulur nacionalizmin e saj eurofobik për t’u përqendruar më shumë te pakënaqësia shoqërore gjatë kërkimit të votave.

dhe udhëheqjen e saj ngrenë shqetësime për aftësinë e BE-së për t'u përballur me to dhe në të njëjtën kohë për të mbajtur një sy te topi i zgjerimit. Nuk është e lehtë të promovohet hapja dhe zemërgjerësia (pa të cilën zgjerimi i BE-së në Ballkan është një çështje pa vlerë që iu përket kryesisht teknokratëve) kur ekonomia është në krizë dhe politikat e shkurtimeve janë në plan të parë. Rezultati është një mosbesim reciprok ose pretendime: “Ne pretendojmë se ne ju duam dhe ju pretendoni se po bëheni gati”. E gjitha kjo po ringjall dyshime në Ballkan për efektshmërinë e agjendës së zgjerimit. BE-ja perceptohet si e paqartë për procesin, por edhe e pasigurt për përfundimin. Për dyshime të tilla nevojiten dy gjëra njëra pas tjetrës. Së pari, një sinjal i fortë pozitiv nga Brukseli në formën e një zgjerimi rajonal të përsheptuar dhe të politikave koherente të zgjerimit të BE-së në rajon. Së dyti, vjen kapaciteti i aktorëve vendorë për t'u përballur me agjendën e reformave Europiane jo vetëm si diçka e imponuar nga jashtë, por edhe si detyrë e brendshme për çdo shoqëri europiane të shekullit të njëzetënjëtë.

Zgjidhja e keqkuptimeve nuk ndihmohet as nga përcaktimet e ndryshme dhe shpesh konfuze të asaj për të cilën është konceptuar “Europa” ose “Projekti European”. Ky argument mund të përmblihet në tre paradokse. Projekti European që prej Luftës së Dytë Botërore përfaqëson paqen nëpërmjet ndërvarësisë së institucionalizuar, bashkimi i sovraniteteve përbën thjesht një tjetër term për relativizimin e shteteve-kombe dhe integrimi european si vektor për globalizimin e post-1989-s. Megjithatë, në Ballkan, që prej fillimit të shekullit të 19-të, rruga për modernizimin european është identifikuar qartësisht me ndërtimin e shtetit-komb. BE-ja po advokon kalimin e modelit të saj të paqes me anë të ndërvarësisë së institucionalizuar në Ballkan, ndërkohë që në të njëjtën kohë dhe me më shumë ngurrim po futet në një proces të vështirë të ndërtimit të shteteve-kombe ose të ndërtimit të vendeve anëtare të ardhshme.

Një paradoks i dytë lidhet me multikulturalizmin. BE-ja me të drejtë i reziston ndarjes etnike në Kosovë, Bosnjë ose RIJM në emër të konceptit qytetar të shtetit-komb të ri në zhvillim dhe të një shoqërie shumëkulturore. Ky argument u ngrit me zë të lartë dhe qartësisht në vitet 1990 nga intelektualët perëndimorë, politikanët dhe media, duke krijuar legjitimitet dhe mbështetje publike për përfshirjen evropiane, madje edhe për ndërhyrjet ushtarake kundër spastrimeve etnike në Bosnjë dhe Kosovë. Sot argumenti po megjulohet duke qenë se kudo në Europën e re dhe të vjetër po shohim një rikthim të politikave të identitetit dhe rritjen e forcave nacional-populiste për çështje që lidhen

me emigrimin dhe integrimin. Nëse kancelarja Merkel deklaroi se “ka pasur një dështim total të multikulturalizmit në Gjermani”, si mendoni, atëherë, që ta nxitim atë në Bosnjë? Ne kundërshtuam logjikën etnonacionaliste në Ballkan vetëm për të zbuluar se kjo ekziston brenda nesh.

Paradoksi i tretë lidhet me opinionin publik në vendet aplikante. Sipas një sërë vëzhgimesh të *Gallup Balkan Monitor*²⁶, qytetarët janë bërë më skeptikë sa më shumë që vendet e tyre i afrohen aderimit në BE. Ne jemi në dijeni rreth opinionit publik në Europën Perëndimore, i cili në mes të një krize të madhe ekonomike mund të preferojë të mbyllë derën për të ruajtur një *acquis* (pavarësisht se ky nuk do të jetë dhe aq *communaute*). Megjithatë, aktualisht në Ballkan po zbulojmë atë që mund të quhet “euroskepticizëm i parakohshëm”, në përgatitje për avancimin e procesit të aderimit. Shqiptarët duket se e dashurojnë BE-në duke qenë në një distancë të sigurt; kroatët po pendohen për të kur janë në prag të hyrjes; serbët janë diku në mes. Nëse konfirmohet ky trend do të ishte shumë i rrezikshëm duke qenë se nuk ka shanse që zgjerimi t’ia dalë mbanë pa mbështetjen e opinionit publik dhe pa përfshirjen e aktorëve të shoqërisë civile.

Asnjë prej paradokseve të sipërpërmendur, i vetëm, nuk do të mund të dëmtonte besimin tk procesi i integritit të Ballkanit në BE. Megjithatë, ndodh që këto paradokse të rastisin me një krizë besimi dhe udhëheqjeje në bërthamën e BE-së. Nuk është e lehtë zgjerimi i BE-së në periferi, ndërkohë që bërthama e saj duket minimalisht e lëkundur për këtë dhe maksimalisht e zënë me punë të tjera.

Kjo situatë mund të çojë që disa të bëjnë thirrje për një kombinim të “pesimizmit të arsyes”, Gramshian dhe “optimizmit të dëshirës”. Pa dyshim që disa OJF, *think tanke* dhe grupe interesi të indinjuar po bëjnë thirrje që procesi të përshpejtohet dhe nuk mundet veçse të kemi simpati për ta. Megjithatë është krijuar përshtypja e kundërt se mund të ketë vend për pesimizëm për sa i përket dëshirës politike në BE duke ruajtur ndërkohë optimizmin rreth mundësive të arsyes. Ndryshe nga përmbyllja e revolucioneve të vitit 1989, në Europën Lindore dhe Qendrore, rasti i zgjerimit të BE-së në Ballkan nuk mund të bazohet tek apeli emocional për t’u kthyer në Europë. *Elan-i* nuk mund të vijë as nga simpatia apo nga përgjigjia humanitare që frymëzohet nga tragjeditë e viteve 1990. Premtimi europian për Ballkanin duhet të mbetet i bazuar tek argumentet e arsyetuar mbi atë që luhet për rajonin dhe BE-në.

²⁶ *Gallup Balkan Monitor*, Brussels.

Këtu, ndërmjet të tjerash, ekzistojnë tre argumente për të mbështetur një rast realist: suksesi politik, vetëinteresi dhe besueshmëria. Zgjerimi i BE-së në Ballkan përfaqëson qëllimin e politikave të saj më të suksesshme që prej rënies së Murit të Berlinit. Kjo nuk vihet në pikëpyetje brenda BE-së dhe mbetet në të ardhmen e afërt, e vetmja perspektivë e pranueshme për zgjerimin e saj. Përfshirja e vendeve të Ballkanit Perëndimor do të përfaqësonte një shtesë prej rreth 20 milionësh e gjysmë miliardëve qytetarëve të BE-së Nëse konsiderohen kostot e zgjerimit në kontekstin e shkurtimeve buxhetore nuk duhet harruar kostoja e moszgjerimit. Kostot e luftërave dhe të programeve pasuese të rimëkëmbjes janë vlerësuar rreth 100 miliardë dollarë për vitet 1990²⁷. Pa një perspektivë të besueshme të aderimit në BE, ndikimi i kësaj të fundit do të largojë elitat politike dhe format më radikale të nacionalizmit që do të dalin në sipërfaqe rreth çështjeve të pazgjidhura duke penguar “shtetet e papërfunduara” të Ballkanit. Pa një vullnet të dukshëm dhe të prekshëm europian në Ballkan, progresi i bërë gjatë dekadës së fundit mund të shembet me një kosto të madhe politike dhe financiare për BE-në, e cila do të ishte e detyruar t'i kthehej logjikës së protektorateve. Ajo që do t'i sillte një dështim të tillë fuqisë transformuese të Europës dhe modelit të saj frymëzues të ndërvarësisë së institucionalizuar, do të ishte i debatueshëm. Ajo që është absolutisht e sigurt është se kjo do të shkundte besueshmërinë e BE-së si një aktor ndërkombëtar. Çfarë besueshmërie do të kishte ajo kur merrej me krizat në Lindjen e Mesme, Afrikë ose Azi nëse do të ishte e paaftë për zgjidhjen e problemeve në oborrin e saj të mbrapëm? Ivan Krastev argumentoi para disa vjetësh se zgjedhja me të cilën përballët BE-ja në Ballkan është ndërmjet zgjerimit dhe Perandorisë²⁸, një çati e përbashkët për përfundimin e shteteve të papërfunduara me shtetndërtimin e shteteve-komb si një qasje rajonale për integrimin europian dhe si një prej tre dimensioneve të procesit. Për këto arsye Ballkani kërkon një rimendim të qasjes së BE-së drejt zgjerimit, e cila nuk mundet që thjesht të lidhet me tiparin e aplikuar me sukses në Europën Qendrore. BE-ja duhet të forcojë qasjen rajonale duke i dhënë gjithë vendeve të rajonit statusin

²⁷ A. Ross Johnston, “An assessment of the decade of Western peace-keeping and nation-building in the Balkans”, *East European Studies Special Report*, Woodrow Wilson Center, Maj 2003, f. 3.

²⁸ Jacques Rupnik, “L’Europe centrale et les Balkans à la recherche d’un substitute d’empire”, in Anne-Marie Le Gloannec et Aleksander Smolar (eds.), *Entre Kant et Kosovo* (Paris: Presses de Sciences Politiques, 2003).

kandidat dhe një datë për hapjen e negociatave. Pas kësaj, hapi dhe përfundimi i procesit do të varet te kapaciteti për të dorëzuar produktet finale që ka çdo elitë politike e vendeve, duke bërë kështu të qarta përgjegjësit dhe kostot e tyre politike në rast dështimi. Por kjo, nga ana tjetër, do të kërkonte që BE-ja të tejkalonte hezitimin e saj ndërmjet përmbajtjes dhe integritetit dhe të rinovonte vullnetin e saj për të ardhmen europiane të Ballkanit për të rivendosur besueshmërinë e saj në rajon dhe në nivel ndërkombëtar.

Agon Demjaha, PhD

ROLI I INTEGRIMIT EUROATLANTIK NË LIDHJE ME TË ARDHMEN E MARRËDHËNIEVE MES MAQEDONISË DHE KOSOVËS

Hyrje

Maqedonia dhe Kosova kanë ndarë, në përgjithësi, fate relativisht të ngjashme gjatë gjithë historisë. Të qenit pjesë e Ballkanit, në udhëkryq mes Lindjes dhe Perëndimit, të dyja bashkë kanë pësuar sundime nga njëra perandori në tjetrën. Si Maqedonia, ashtu dhe Kosova ishin provinca në varësi të Perandorisë Osmane edhe gjatë luftërave ballkanike (1912-1913); si njëra dhe tjetra kanë qenë pushtuar nga Serbia, thënë ndryshe, të dyja kanë qenë pjesë e të njëjtit vend për gati 80 vjet. Megjithatë, përgjatë historisë, marrëdhëniet mes tyre nuk mund të analizohen pa marrë parasysh marrëdhëniet që ekzistojnë mes popullsisë etnike si maqedonase ashtu edhe shqiptare, për faktin se i përkasin të njëjtës periudhë formimi. Në fund të shekullit të 19-të, kolapsi i Perandorisë Osmane përkoj me fillimin e zgjimit kombëtar të popujve në Ballkan. Gjatë kësaj periudhe ata “strukturuan marrëdhëniet e brendshme në mbështetje të ekspansionit territorial nationalist në kurriz të Perandorisë Osmane, zakonisht në konkurrencë të vazhdueshme me njëri-tjetrin”¹. “Shqiptarët dhe Maqedonasit, duke jetuar nën sundimin osman, ishin praktikisht të detyruar të aplikojnë agjendën e tyre kombëtare të vetëmbrojtjes”².

Ndonjë mund të thotë se historia e marrëdhënieve të përgjithshme mes maqedonasve etnik e kosovarëve dhe maqedonasve etnik e shqiptarëve, në tërësi, daton sot e prapa në histori kur këto dy vende ishin vetëm koncepte gjeografike fluide. Ata kishin shumë gjëra të përbashkëta në drejtim të shtetit dhe zhvillimit kombëtar, sepse, siç Perry vë në dukje, “as

¹ Dennis P. Hupchick, *The Balkans: from Constantinople to Communism* (New York: Palgrave Macmillan, 2002), f. 274.

² Ibid, f. 274.

shqiptarët e as maqedonasit nuk e kishin zhvilluar vetëdijen kombëtare deri në fund të shekullit të 19-të dhe fillim të shekullit të 20-të³. Për më tepër, sipas Mishës, “gjatë kësaj periudhe të dy popujt, shqiptarët dhe maqedonasit, karakterizoheshin nga lëvizje të dobëta kombëtare në krahasim me popujt e tjerë në Ballkan”⁴. Duke ndarë një fat të ngjashëm, ndokush ka besuar se bashkëpunimi dhe marrëdhëniet mes Maqedonisë dhe Kosovës kanë ndihmuar në arritjen e të njëjtit qëllim për liri dhe pavarësi. Mirëpo, me përjashtim të disa episodeve sporadike në histori që u karakterizuan me një bashkëpunim të tillë, historia e marrëdhënieve mes tyre tregon se kanë qenë kryesisht të tensionuara. Në të dyja rastet, pyetja për etnicitetin e shqiptarëve përbën një faktor mjaft të rëndësishëm. Sot, si Maqedonia dhe Kosova kanë një popullsi prej rreth 2 milionë banorë, nga të cilat 90% e popullsisë në Kosovë janë shqiptarë etnik dhe 25% e popullsisë në Maqedoni janë po ashtu shqiptarë etnik.

Gjatë 65 viteve të fundit, marrëdhëniet ndërmjet Maqedonisë dhe Kosovës kanë pësuar ndryshime të mëdha, kryesisht për shkak të çështjeve të ndërlikuara ndëretnike mes maqedonasve dhe shqiptarëve. Edhe pse ndokush mund të besojë se një pakicë e madhe, siç janë shqiptarët në Maqedoni, duhet të shërbejë si një urë që i afron vendet me njëri-tjetrin, në të vërtetë nuk ka ngjarë gjithmonë kështu. Në të kaluarën, perceptimi i përgjithshëm i maqedonasve ndaj kosovarëve ka qenë mjaft negativ, për më tepër që Kosova në vetvete ka qenë një çështje mjaft e ndjeshme dhe dukshëm “përçarëse” në Maqedoni, në veçanti dy dekadat e fundit.

Në vitet 1990, fluksi i shqiptarëve nga Kosova që kërkonin shpëtim prej politikave të egra serbe, u perceptua nga Maqedonasit si prishje e balancave etnike të Maqedonisë. Përveç kësaj, Kosova ka qenë për mjaft kohë një nga temat e diskutimit për divergjencat më të mëdha etnike mes tyre. Për shembull, në mesin e maqedonasve etnik, mundësia që Kosovës t'i jepej pavarësia ishte për ta një shqetësim i thellë. Sipas sondazhit të Gallup-it në mars-prill 2007, “vetëm 3,1% e maqedonasve kanë qenë në favor të pavarësisë së Kosovës, ndërsa 30,5% ishin mbështetës për “republikë të pavarur brenda Serbisë” dhe 33,9%

³ Duncan Perry, “Conflicting Ambitions and Shared Fates: The Past, Present and Future of Albanians and Macedonians”, in *The Macedonian Question: Culture, Historiography, Politics*, ed. Victor Roudometof (Boulder: Columbia University Press, 2000), f. 261.

⁴ Piro Misha, “Invention of Nationalism: Myth and Amnesia”, in *Albanian Identities: Myth and History*, ed. Stephanie Schwandner-Sievers and Bernard Fisher (London: Hurst, 2002), f. 40.

mbështetën rikthimin në statusin e mëparshëm. Ndërsa 95,3% e shqiptarëve ishin në favor të pavarësisë⁵, tregues i një diference ndarjeje të madhe mes tyre. Gjithashtu, sipas sondazhit të kryer nga Instituti për Demokraci në Shkup, gjatë muajit maj 2007, maqedonasit dhe shqiptarët etnik në Maqedoni kishin pikëpamje diametralisht të kundërta në perceptimin e tyre ndaj Kosovës. Ndarë në perceptim “shumë negativ” dhe “negativ”, sondazhi tregoi se 40,4% e maqedonasve kishin perceptim “shumë negativ”, ndërsa 20,6% të tjerë kishin perceptim thjesht “negativ”. Në kontrast me maqedonasit, 51,5% e shqiptarëve etnik kishin perceptim “shumë pozitiv” për Kosovën dhe 26,9% ishin thjesht “pozitiv”⁶. Siç tregohet nga një sondazh i kryer në muajin mars të vitit 2008 nga Qendra për Hulumtime dhe Politikëbërjen (Centre for Research and Policy Making, CRPM), një trend i tillë i ngjashëm vazhdoi edhe pasi Kosova shpalli pavarësinë në shkurt të vitit 2008.

Ngjashmërisht me rezultatet e mëparshme, sondazhi tregoi se shumica e popullsisë maqedonase, rreth 60% e tyre kundërshtuan njohjen e Kosovës, kundrejt 95% të shqiptarëve etnik që mbështesin njohjen e saj⁷. Në këtë kontekst nuk është për t'u habitur që elita politike maqedonase duhet të formulonte një politikë shumë të ekuilibruar dhe të kujdesshme në çështjen e Kosovës. Është e qartë se midis komuniteteve shqiptare dhe maqedonasve në Maqedoni, problemi i bashkëjetesës mbetet problem prezent. Të dy grupet janë dyshues në veprime dhe kanë paragjykitime ndaj njëri-tjetrit, duke penguar zhvillimin e marrëdhënieve mes Maqedonisë dhe Kosovës.

Deri kohët e fundit, marrëdhëniet mes dy vendeve janë dominuar nga frika e së kaluarës dhe jo nga perspektivat e së ardhmes. Ishte perspektiva euroatlantike që hapi rrugën për tolerancë dhe forcimin e bashkëpunimit. Në fakt, për shkak të ambicieve të saj euroatlantike, Maqedonia gjatë konfliktit në

⁵ Nadège Ragaru, “Macedonia: Between Ohrid and Brussels” in *Is there an Albanian question?* ed. Judy Batt, (Chaillot Paper, no. 107, Institute For Security Studies, January 2008), f. 54.

⁶ Zhidas Daskalovski and Dane Taleski, “The Independence of Kosovo and the Consolidation of Macedonia - A Reason to Worry?”, in *Cutting or Tightening the Gordian Knot? The Future of Kosovo and the Peace Process in the Western Balkans after the Decision on Independence*, ed. Ernst M. Felberbauer, Predrag Jurekoviæ and Frederic Labarre (Vienna: National Defence Academy and Bureau for Security Policy at the Austrian Ministry of Defence, October 2008), f. 43.

⁷ *Centre for Research and Policy Making*, “Results of the survey held on Marxh 2008”, Accessed November 19, 2011. <http://www.crpm.org.mk/Home.htm>.

Kosovë në vitin 1999, për herë të parë ka marrë anën e Kosovës kundër Serbisë duke e lejuar NATO-n që të përdorë territorin dhe hapësirën e saj ajrore. Me përjashtim të një periudhe të shkurtër gjatë vitit 2001, marrëdhëniet ndërmjet Maqedonisë dhe Kosovës kanë treguar se janë përmirësuar.

Duke promovuar respektin pa rezerva të të gjitha komuniteteve dhe angazhimin ndaj vlerave tradicionale europiane, integrimi euroatlantik ka ndihmuar në transformimin e marrëdhënieve midis këtyre dy vendeve nga relativisht armiqësorë në bashkëpunuese. Sot parimisht nuk ka çështje të hapura dhe kjo është një fillësë e rëndësishme e pozitive për zhvillimin e marrëdhënieve normale bilaterale mes tyre. Megjithatë, pavarësisht nga mundësitë e shumta për një bashkëpunim të tillë, këto marrëdhënie nuk kanë arritur ende nivelin e dëshiruar.

Shkrimi do të shqyrtojë rolin e integritit euroatlantik në marrëdhëniet ndërmjet Maqedonisë dhe Kosovës. Gjithashtu do të analizojë edhe rolin e faktorëve të tjerë relevantë, si: etnik, ekonomik dhe ekuilibrat politikë, si indikatorë për të ardhmen e marrëdhënieve të fqinjësisë mes tyre.

Roli i faktorëve të tjerë relevantë

Siç është përmendur tashmë, me përjashtim të një periudhe të shkurtër gjatë vitit 2001, marrëdhëniet e përgjithshme bilaterale ndërmjet Maqedonisë dhe Kosovës janë përmirësuar vazhdimisht që nga konflikti i Kosovës në vitin 1999. Është e rëndësishme të theksohet se në parim nuk ka çështje të hapura mes dy vendeve - një fakt ky që është përmendur në disa raste nga politikanët si në Maqedoni ashtu edhe në Kosovë. Pa dyshim që ky është një tregues i rëndësishëm për një zhvillim të mbarë të marrëdhënieve të përgjithshme bilaterale.

Në këtë shkrim do të analizojmë rolin e faktorëve të ndryshëm si dhe sinergjia që mund të krijohet mes tyre dhe perspektiva e së ardhmes së këtyre marrëdhënieve. Natyrisht, faktori etnik ishte dhe vazhdon të jetë një aspekt i rëndësishëm që motivon dhe ndikon në marrëdhëniet në tërësi. Në fakt, marrëdhëniet në të ardhmen mes dy fqinjëve do të varen nga marrëdhëniet midis maqedonasve dhe shqiptarëve në Maqedoni. Marrëdhëniet e mira, të qëndrueshme dhe të sigërtë ndërmjet dy grupeve më të mëdha etnike në Maqedoni, janë një garanci e fortë për marrëdhënie të mira fqinjësore të përjetshme mes dy vendeve. Kohët e fundit, për shkak të rolit në rritje të partive shqiptare në Maqedoni, bashkëpunimi i përgjithshëm midis dy vendeve është intensifikuar shumë. Kosova ka nënshkruar marrëveshje me

Maqedoninë, më shumë se me çdo vend tjetër, përfshirë edhe Shqipërinë. Fakti se këto marrëveshje janë nënshkruar mes ministrive përkatëse, kryesisht në fushat që janë të drejtuara nga ministrat shqiptarë në qeverinë maqedonase, dëshmon rëndësinë e faktorit etnik në formësimin e marrëdhënieve midis dy vendeve. Transformimi i bashkëpunimit aktual mes shqiptarëve përtej kufirit në bashkëpunim ndërshtetëror, është një parakusht i rëndësishëm për marrëdhënie afatgjata të qëndrueshme mes Maqedonisë dhe Kosovës.

Për fat të keq duhet të theksohet se tensionet etnike mes maqedonasve dhe shqiptarëve në Maqedoni janë rritur së fundmi. Shkëndija fillestare erdhi në janar pas një feste karnavalesh fshati, ku maqedonasit me maska vunë në lojë shqiptarët myslimanë. Më pas, shqiptarët myslimanë organizuan një protestë para ndërtesës së komunës së qytetit të Strugës, një qytet i përzierë etnikisht. Si kundërpërgjigje hakmarrëse, një kishë u sulmua në fshatin Borovec dhe një flamur maqedonas u dogj⁸. Më pas, incidente të ngarkuara etnikisht u pasuan gjatë ndeshjeve sportive që ndikuan në klimën e tolerancës midis maqedonasve dhe shqiptarëve. Fatkeqësisht, është e dukshme që marrëdhëniet ndëretnike në Maqedoni janë të ngarkuara ende nga paragjykime dhe stereotipa, në vend të klimës së bashkëpunimit dhe prosperitetit të përbashkët.

Tensionet e shpeshta ndëretnike të kohëve të fundit ndërmjet dy komuniteteve, u përshkallëzuan në dhunë, pasi një oficer policie në detyrë vrau dy shqiptarë në qytetin e Gostivarit, më 28 shkurt 2012. Pas incidentit, protestat e mijëra shqiptarëve kundër vrasjeve të mësipërme përfundoi në dhunë dhe dëme të rënda të pronës dhe pasurisë. Më pas ka pasur një seri sulmesh mes maqedonasve dhe të rinjve shqiptarë në autobusë dhe në rrugë, me pasoja të plagosurish rëndë nga të dy anët⁹. Këto incidente kanë ndikuar dhe kanë shkaktuar reagime si në Kosovë dhe në Shqipëri. Në Kosovë, në përgjigje të dhunës së përdorur mbi shqiptarët në Maqedoni, Ambasada e Maqedonisë në Prishtinë është sulmuar dy herë. Fillimisht Ambasada u gjuajt me gurë pas një proteste të organizuar nga një grup shqiptarësh

⁸ Sinisa Jakov Marusic, "Macedonia to Curb Fans Offensive Chants", Balkan Insight, Skopje, February 17, 2012, accessed March 13, 2012, <http://www.balkaninsight.com/en/article/macedonia-curbs-fan-s-offensive-chanting>.

⁹ "Situation in Macedonia calmer but inter-ethnic tensions with Albanians linger", The Sofia Echo, March 14, 2012, accessed March 26, 2012, http://sofiaecho.com/2012/03/14/1787294_situation-in-macedonia-calmer-but-inter-ethnic-tensions-with-albanians-linger.

radikalë, ndërsa disa ditë më pas u godit me bomba “Molotov”, pa pasoja në njerëz, duke shkaktuar vetëm dëme materiale¹⁰. Nga ana tjetër, më 13 mars, një incident në qytetin shqiptar të Burrelit u mbyll me djegien e flamurit maqedonas. Përveç kësaj, ka pasur protesta para Ambasadës Maqedonase në Tiranë të shoqëruara me parulla antimaqedonase. Zyrtarët shqiptarë si në Prishtinë dhe Tiranë dënuan aktet e dhunës dhe të violencës, duke theksuar rëndësinë e marrëdhënieve të mira fqinjësore. Presidentja e Kosovës, Atifete Jahjaga, tha se sulmi në ambasadën maqedonase me bomba Molotov është i papranueshëm për institucionet e Kosovës dhe qytetarët e saj. Në të njëjtën kohë, Ministria e Punëve të Jashtme të Kosovës përmes një deklarate për shtyp dënoi sulmin, duke thënë se ky incident dëmton rëndë marrëdhëniet miqësore midis Kosovës dhe Maqedonisë¹¹. Në të njëjtën mënyrë, ministrja e Integritimit European të Kosovës, Vlora Çitaku, tha se stabiliteti i Maqedonisë është në interes të Kosovës, megjithatë, ajo ka shtuar se kjo nuk duhet të bëhet nga shqiptarët. Nga ana tjetër, Ministria e Jashtme e Shqipërisë tha se dënon në mënyrë eksplicite incidentin, përfshirë djegien e flamurit kombëtar maqedonas dhe parullat e sloganet e hedhura para ambasadës maqedonase në Tiranë, me një gjuhë fyese që rrallë mund të lexohet apo dëgjohet në publik¹².

Megjithatë, tensionet ndëretnike në vend arritën kulmin në 12 prill 2012, kur pesë civilë maqedonas u vranë në afërsi të liqenit të Smilkovcit në periferi të Shkupit, kryeqytet i vendit. Spekulumet se vrasjet janë kryer nga shqiptarët etnik, menjëherë shkaktoi trazira antishqiptare dhe bllokimin e rrugëve nga Maqedonasit etnik nga Radishani - lagjja nga ish-in viktimat. Sulmet mbi shtëpitë dhe pronat e shqiptarëve që jetojnë në këto lagje u raportuan menjëherë. Thirrjet e policisë për vetëpërmbytje dhe kundërshtimet nga ana e partive politike dhe nga gjithë spektri etnik nuk ndihmuan shumë në qetësimin e situatës. E njëjta gjë vlen edhe për thirrjet që vinin nga fqinjët, Kosova dhe Shqipëria, që mbështetën hetimin e plotë të ngjarjeve

¹⁰ “Macedonian Embassy in Kosovo Suffers Molotov Cocktail Attack”, Novinite, March 01, 2012, accessed March 23, 2012, http://www.novinite.com/view_news.php?id=137641.

¹¹ “Macedonian Embassy Attacked”, *Kosovo Media Monitor*, Pristina, March 18, 2012, accessed March 23, 2012, http://newsmonitors.org/mon/index.php?option=com_content&view=article&id=1125:sunday-report-18-03-2012&catid=38:sunday.

¹² “Situation in Macedonia calmer but inter-ethnic tensions with Albanians linger.”

duke u përcjellë ngushëllime familjeve të viktimave. Vetëm pak ditë më pas, policia u përlesh për të parandaluar një turmë të rinjsh maqedonas që lëvizin nëpër lumin Vardar drejt kryeqytetit të populluar kryesisht nga shqiptarë¹³. Kur dukej se situata ishte qetësuar, në orët e para të mëngjesit të datës 1 maj 2012, rreth 800 policë bastisën 26 shtëpi duke arrestuar 20 persona, me pretendimin se ishin radikalë islamikë dhe terroristë. Shumica e të arrestuarve ishin shqiptar dhe në mesin e tyre kishte më tepër gra dhe të moshuar.

Si reagim ndaj aksionit policor dhe pretendimeve se autorët e vrasjeve të shumëfishta pranë fshatit Smiljkovci ishin terroristët islamikë, një grup prej 10 000 të rinjsh shqiptarë organizuan një protestë në Shkup¹⁴. Edhe pse, për fat të mirë, situata është qetësuar, pa dyshim për shkak të faktorit etnik, sërish marrëdhëniet mes maqedonasve dhe shqiptarëve, në përgjithësi, dhe Maqedonisë e Kosovës, në veçanti, janë dëmtuar. Pa dyshim, në perspektivë sukcesi i marrëdhënieve mes dy vendeve do të varet shumë nga zhvillimi i marrëdhënieve ndëretnike ndërmjet dy grupeve më të mëdha në Maqedoni.

Nga pikëpamja ekonomike, ka sigurisht mundësi të shumta për përmirësimin e bashkëpunimit mes dy vendeve në të ardhmen. Pas konfliktit të Kosovës në vitin 1999, marrëdhëniet ekonomike janë përmirësuar, kryesisht në fushën tregtare. Dritaret e mundësive për intensifikimin e mëtejshëm ekzistojnë, veçanërisht në fushën e transportit, energjisë dhe infrastrukturës. Lidhur me bashkëpunimin në fushën e energjisë, tashmë ka një plan për të ndërtuar një linjë elektrike 40 kv mes dy vendeve, për të përmirësuar në një masë më të madhe shpërndarjen e energjisë elektrike¹⁵. Përveç kësaj, ka një interes të përbashkët për të ndërtuar një tubacion gazi nga Maqedonia në Kosovë, që do të mundësonte gazifikimin e Kosovës. Në fushën e transportit, ndërtimi i një autostrade që lidh kryeqytetet e dy vendeve është një përpjekje shtesë për të përmirësuar lidhjet ekonomike mes tyre.

Kosova ka ndërtuar tashmë 10 kilometrat e para të autostradës dhe synon ta përfundojë në vitin 2014. Nga ana

¹³ Sinisa Jakov Marusic, "Unsolved Killings Raise Fears of Macedonian Turmoil", *Balkan Insight*, April 18, 2012, accessed October 15, 2012, <http://www.balkaninsight.com/en/article/unsolved-killings-raise-fears-of-macedonian-turmoil>.

¹⁴ Natasha Gaber-Damjanovska and Aneta Jovevska, "Current Events and Political Parties Development in the Republic of Macedonia", *Barometer* 26 (June 2012): f. 53-55.

¹⁵ "Largpërçuesit kërkojnë 60 milionë euro investime", *Zhurnal*, Shkup, 12 dhjetor 2011.

tjetër, sipas Valon Saraqinit, ministër i Ekonomisë, Maqedonia ka në plan të fillojë ndërtimin e rrugës Shkup-Bllacë në vitin 2013. Biznesmenë të të dy vendeve theksojnë se ka shumë kompani të vogla që janë të interesuar për të kryer punë ndërtimore në të dy anët e kufirit. Për të krijuar mundësi të tilla ata pohojnë se jo vetëm rruga drejt Shkupit, por edhe pjesë të tjera të infrastrukturës që lidhin të dy vendet janë të rëndësishme. Në këtë drejtim, përveç modernizimit të autostradës, ajo që është e rëndësishme për sektorin e biznesit është hapja e rrugëve të reja kufitare dhe modernizimin e atyre ekzistuese¹⁶. Me sa duket, nëse këto projekte do të përfundojnë, të dy vendet do të arrijnë të kapin mundësi të mëdha ekonomike, që do të bëhen një forcë shtytëse në përmirësimin e marrëdhënieve të përgjithshme mes Maqedonisë dhe Kosovës. Politika e baraslarguar është një qasje drejt vendosjes së balancave rajonale dhe një faktor i rëndësishëm që ndikon pozitivisht në politikën e jashtme të Maqedonisë. Duke pasur parasysh marrëdhëniet tepër delikate dhe të komplikuar që Maqedonia kishte me fqinjët në fillim të viteve 1990, një politikë e tillë u duk një zgjedhje racionale nga ana e saj që, pa dyshim ka pasur një ndikim të qartë në marrëdhëniet e përgjithshme mes Maqedonisë dhe Kosovës për gati dhjetë vjet. Duke pasur parasysh se ky barazlartim ose kjo balancë shihet me dyshim nga shqiptarët e të dyja anëve, si të Maqedonisë dhe Kosovës, është e qartë se kjo gjë ka luajtur një rol negativ në formimin e marrëdhënieve të mira mes dy vendeve. Si rezultat, në vitet e mëvonshme kjo politikë e ka humbur rëndësinë e saj gradualisht dhe thujse tërësisht është braktisur nga autoritetet maqedonase. Prandaj, është e vështirë të besohet se politika e baraslarguar apo e ekuilibruar do të luajë një rol të rëndësishëm në marrëdhëniet e ardhshme ndërmjet Maqedonisë dhe Kosovës.

Roli i Integritimit Euroatlantik

Nga ana tjetër, perspektiva euroatlantike përmes procesit të stabilizim-integritimit i hapi rrugën tolerancës dhe të bashkëpunimit midis Maqedonisë dhe Kosovës. Se cili do të jetë ndikimi i këtij faktori në marrëdhëniet e ardhshme ndërmjet dy vendeve, do të varet në masë të madhe nga ecuria e tyre. Pavarësisht fazave

¹⁶ "Skopje - Pristina highway in two years?!", *Macedonian Information Centre*, Daily News Service, October 17, 2011, accessed March 03, 2012, <http://www.thefreelibrary.com/Skopje-pristina+highway+in+two+years%3F!-a0271323993>.

të ndryshme të progresit drejt NATO-s dhe BE-së, integrimi deri tani, në këto dy organizata, mbetet ende një prioritet i lartë i të dy vendeve. Megjithatë, anëtarësimi i Maqedonisë në NATO dhe BE është bllokuar seriozisht në vitet e fundit. Që nga Samiti i Bukureshtit në vitin 2008, anëtarësimi i plotë i Maqedonisë në NATO është në pritje të gjetjes së një zgjidhjeje për mosmarrëveshjen e emrit me Greqinë. Nga ana tjetër, edhe pse vend kandidat i BE-së që prej dhjetorit 2005, Maqedonia nuk ka ende një datë të përcaktuar për të filluar negociatat e pranimit në këtë union. Edhe pse Komisioni Europian ka rekomanduar që nga viti 2009 fillimin e negociatave, Këshilli i Ministrave e ka refuzuar përcaktimin e saj. Ndërsa ka ende një sërë kriteresh objektive që Maqedonia duhet të përmirësojë, po bëhet gjithmonë edhe më e qartë se negociatat nuk do të fillojnë pa një zgjidhje të çështjes së emrit. Që nga Samiti i NATO-s në Bukuresht, përparimi i Maqedonisë drejt institucioneve euroatlantike ka filluar të ngadalësohet. Çfarë është më e rëndësishme, bllokimi në procesin e integritimit, kryesisht për shkak të kontestimit për emrin, ka pasur një efekt negativ mbi qëndrimet publike ndaj BE-së. Ndërsa anëtarësimi në NATO dhe BE, qysh në fillim është mbështetur nga një pjesë e madhe e popullsisë nga të gjitha grupet etnike, për herë të parë në vite sondazhet kanë treguar gjithnjë në rritje ndjenjat antieuropiane mes maqedonasve etnik: 72% e maqedonasve etnik nuk besojnë në politikën e BE-së ndaj Maqedonisë, ndërsa 74% e shqiptarëve etnik e besojnë atë. Në të njëjtën kohë, shumica e të anketuarve (51%) nuk janë të kënaqur me politikën e qeverisë për integrimin në BE, në krahasim me 47% të atyre që janë të kënaqur. Nga ana tjetër, shumica e qytetarëve (62,9%) janë kundër anëtarësimit të vendit në NATO, nëse anëtarësimi është parakusht për ndryshimin e emrit kushtetues të vendit. Në aspektin e strukturës etnike të vendit, 79% e maqedonasve etnik nuk mbështesin ndryshimin e emrit, ndërsa vetëm 14,5% e shqiptarëve etnik dhe komuniteteve të tjera etnike e kundërshtojnë këtë çështje. Këto të dhëna konfirmojnë në mënyrë të qartë hendeqe të mëdha midis maqedonasve dhe shqiptarëve në vend, kur është fjala për perceptimet aktuale në lidhje me BE-në, anëtarësimin në NATO dhe çështjen e emrit¹⁷.

¹⁷ “Áíéáðà: Áðáíáíéðá íá ñá çà ÷éáíñòáí áí ÍÀÓÍ áéí á óñéíá íðííáíá íà èíáðí”, ÓÀ Ñèðáé, Áíðèè 04, 2011, accessed February 17, 2012, <http://sitetel.com.mk/dnevnik/makedonija/anketa-graganite-ne-se-za-chlenstvovo-nato-ako-e-uslov-promena-na-imeto>.

Pas Samitit të NATO-s në Bukuresht, në nëntor 2008, Shkupi nisi procedimin kundër Athinës para Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë të OKB-s (GJND), për atë që e përshkroi si “një shkelje flagrante të detyrimeve të Greqisë, në bazë të nenit 11 të Marrëveshjes së Përkohshme të nënshkruar nga palët, më 13 shtator 1995”¹⁸. Më 5 dhjetor 2011, Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë ka vendosur që Greqia ka bllokuar kërkesën e Maqedonisë për t’iu bashkuar NATO-s në vitin 2008, për shkak të emrit të saj. U tha se Athina duhet të kishte respektuar marrëveshjen e vitit 1995, që të mos bllokonte aplikimin e Maqedonisë në rast se bëhet nën emrin e ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë. Edhe pse vendimi i kësaj gjykate nuk i ka dhënë zgjidhje mosmarrëveshjes për emrin, vendimi i saj ishte pa dyshim një fitore e rëndësishme diplomatike për Maqedoninë¹⁹. Natyrisht, shpresat e Maqedonisë për t’iu bashkuar NATO-s dhe BE-së kanë marrë një shtysë të re diplomatike, pas vendimit të GJND-së. Vendimi unanim u mirëprit nga ministri i Jashtëm i Maqedonisë Nikola Poposki, i cili vuri në dukje se “ne kemi marrë pjesë me mirëbesim në negociatat me Greqinë dhe nuk ka pasur asnjëherë asnjë argument të vetëm prej tyre kundër anëtarësimit tonë në NATO dhe në BE”²⁰. Në të njëjtën linjë, në një seancë të Këshillit të Atlantikut të Veriut në Bruksel, kryeministri Nikolla Gruevski i bëri thirrje të gjitha vendeve anëtare të NATO-s për të rishqyrtuar çështjen për anëtarësimin e Maqedonisë, në rastin më të parë të mundshëm, para Samitit të Aleancës në Çikago. Ai theksoi se një ftesë për anëtarësimin e Republikës së Maqedonisë në NATO është i mundshëm në Samitin e Çikagos. Nga ana tjetër, Komiteti i Punëve të Jashtme i Parlamentit Europian miratoi në janar versionin përfundimtar të një projektrezolute drejtuar Këshillit Europian për të vendosur sa më parë një datë për fillimin e bisedimeve për pranimin e Maqedonisë në BE. Drafti gjithashtu theksonte rëndësinë për mbështetjen e përpjekjeve të vendit në rrugën për anëtarësim²¹.

¹⁸ “Macedonia Savours World Court Victory Over Greece”, *Balkan Insight*, December 05, 2011, accessed February 17, 2012, <http://www.balkaninsight.com/en/article/icj-judgment>.

¹⁹ “ICJ rules Greece ‘wrong’ to block Macedonia’s NATO bid”, *BBC News Europe*, December 05, 2011, accessed February 19, 2012, <http://www.bbc.co.uk/news/world-europe-16032198>.

²⁰ “Macedonia’s NATO and EU hopes given boost by International Court of Justice”, *The Guardian*, December 05, 2011, accessed February 01, 2012, <http://www.guardian.co.uk/world/2011/dec/05/macedonia-nato-eu-greece-icj>.

²¹ “Macedonia: Putting the World Court to Use”, *Macedonian Information Agency*, January 24, 2012, accessed February 21, 2012, <http://www.topix.com/forum/ëorld/macedonia/T2H6Q6DB55EQAL9EI/p5>.

Megjithatë, Greqia menjëherë deklaroi se do të vazhdojë kundërshtimin për futjen e Maqedonisë në organizatat ndërkombëtare, pavarësisht vendimit të GJND-së se “Athina ishte e gabuar duke kundërshtuar ofertën e Shkupit të vitit 2008”. Përveç kësaj, sipas Ministrisë së Jashtme greke “Greqia do të vazhdojë të ndjekë bisedimet në mirëbesim për të arritur një zgjidhje të pranueshme reciprokisht mbi emrin e ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë, brenda frymës së Kartës dhe Rezolutave përkatëse të Këshillit të Sigurimit dhe të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara”. Kryeministri grek, Lukas Papademos, ishte konkret kur vuri theksin se “Greqia ka mbështetur perspektivën europiane të Shkupit në shumë raste. Megjithatë, normalizimi i marrëdhënieve varet nga zgjidhja e çështjes së emrit”²². Reagimet që vijnë nga zyrtarët e NATO-s nuk ishin në përputhje me pritshmëritë e autoriteteve të Shkupit. Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Anders Rasmussen, tha se edhe pse ai pranon vendimin e GJND-së, “ai nuk ndikon në vendimin e marrë nga Aleanca e NATO-s, në Samitin e Bukureshtit në vitin 2008”. Ai sqaroi gjithashtu se “ne ramë dakord që një ftesë e mundshme do t’i jepet ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë, sa më shpejt që të arrihet zgjidhja për çështjen e emrit. Ky vendim është përsëritur në çdo samit dhe në çdo takim ministror”²³.

Konfirmimi final vjen në Deklaratën e Përbashkët të Kryetarëve të Shteteve të vendeve anëtare të NATO-s në Samitin e Çikagos: “Ne përsërisim marrëveshjen e vitit 2008 në Samitin e Bukureshtit, siç kemi bërë edhe në samitet e mëvonshme, për t’i dhënë një ftesë ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë për t’iu bashkuar Aleancës sa më shpejt që ajo të gjejë një zgjidhje reciproke e të pranueshme për çështjen e emrit në përputhje me Kartën e OKB-së dhe kërkon fuqimisht intensifikimin e përpjekjeve për këtë qëllim. Rrjedhimisht, vendimi i Gjykatës Ndërkombëtare ka dështuar në dhënien e efekteve të pritura pozitive për Maqedoninë, me qëllim anëtarësimin e saj në NATO.

Nga ana tjetër, perspektiva euroatlantike e Kosovës duket më e largët. Siç dihet tashmë, Kosova është vendi i vetëm i Ballkanit Perëndimor që nuk ka vendosur ende marrëdhënie kontraktuale

²² “Greece Unimpressed by ICJ Ruling on Macedonia Dispute”, Novinite, December 05, 2011, accessed May 17, 2012, http://www.novinite.com/view_news.php?id=134562.

²³ “Greece, Macedonia urged to end name dispute after ICJ ruling”, The Sofia Echo, December 06, 2011, accessed May 19, 2012, http://sofiaecho.com/2011/12/06/1278342_greece-macedonia-urged-to-end-name-dispute-after-icj-ruling.

me NATO-n ose me BE-në. Kjo kryesisht për faktin se pesë shtete anëtare të BE-së dhe katër shtete anëtare të NATO-s nuk e kanë njohur ende Pavarësinë e Kosovës. Përveç kësaj, Serbia ka kundërshtuar vazhdimisht Pavarësinë e Kosovës dhe ka ndërmarrë përpjekje të mëdha diplomatike për të parandaluar njohjen e saj nga shtetet e tjera anëtare të OKB-së. Si pasojë, më 15 gusht 2008, ministri i Jashtëm Serb, Vuk Jeremiç, zyrtarisht ka paraqitur një kërkesë në Kombet e Bashkuara duke kërkuar opinionin e Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë, nëse shpallja e pavarësisë së Kosovës ishte në shkelje të ligjit ndërkombëtar. Më 8 tetor 2008, me 77 vota pro, 6 vota kundër dhe 74 abstenim, Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara miratoi këtë propozim në Rezolutën 63/3, duke i kërkuar një mendim këshillues nga GjND-ja në lidhje me shpalljen e pavarësisë së Kosovës²⁴. Gjykata dha mendimin e vet këshillues më 22 korrik 2010, duke deklaruar se “Shpallja e Pavarësisë së Kosovës më 17 shkurt 2008 nuk ka shkelur asnjë ligj të përgjithshëm ndërkombëtar, sepse e drejta ndërkombëtare nuk përmban asnjë ndalesë në deklarimet e pavarësisë”²⁵.

Në mënyrë të ngjashme në Maqedoni, opinioni i GjND-së legjitimon shpalljen e pavarësisë duke rritur shpresat e qeverisë në Prishtinë për të bindur shtetet në njohjen pavarësisë për Kosovën. Pas vendimit të GjND-së, presidenti Fatmir Sejdiu u bëri thirrje vendeve që nuk e kanë njohur Kosovën, gjithashtu edhe Serbisë, që “të bashkohet me vizionin e përbashkët të vendeve të rajonit, duke sjelle një të ardhme të ndritshme e të shpejtë drejt integritit euroatlantik”²⁶. Në të njëjtën frekuencë, ministri i Jashtëm Skënder Hyseni lëshoi një deklaratë duke thënë se “ne tani shikojmë përpara për njohje të mëtejshme të Kosovës. Ne u bëjmë thirrje shteteve që kanë vonuar njohjen e Republikës së Kosovës që të përshpejtojnë procesin e njohjes së saj. E ardhmja e Kosovës dhe e Serbisë është në Bashkimin Europian dhe në NATO, dhe për këtë duhet të ekzistojnë marrëdhënie të mira e fqinjësore”²⁷. Megjithatë, numri i njohjeve

²⁴ “UN seeks World Court Kosovo view”, *BBC News*, October 08, 2008, accessed February 18, 2012, <http://news.bbc.co.uk/2/hi/europe/7658103.stm>.

²⁵ “UN seeks World Court Kosovo view”, *BBC News*, October 08, 2008, accessed February 18, 2012, <http://news.bbc.co.uk/2/hi/europe/7658103.stm>.

²⁶ “Kosovo Albanians hail ICJ decision as big victory”, *B92, News-Politics*, July 22, 2010, accessed February 21, 2012, http://www.b92.net/eng/news/politics-article.php?yyyy=2010&mm=07&dd=22&nav_id=68621.

²⁷ “Statement by the Foreign Minister of the Republic of Kosovo, H.E. Mr Skender Hyseni, on the ICJ Opinion of 22 July 2010”, *Ministry of Foreign Affairs*, July 22, 2010.

pas vendimit të GJND-së ishte shumë më i ulët nga ajo që pritej nga autoritetet e Kosovës. Përveç kësaj, pesë vendet e BE-së (dhe katër vendet anëtare të NATO-s), të cilat nuk e kanë njohur pavarësinë e Kosovës kanë njoftuar tashmë se ato nuk do t'i rishikojnë politikat e tyre përkatëse në lidhje me Kosovën, duke zvogëluar perspektivën euroatlantike të saj²⁸. Natyrisht, roli i integritit euroatlantik në marrëdhëniet e ardhshme ndërmjet Maqedonisë dhe Kosovës do të varet nga progresi që të dy vendet do të bëjnë drejt NATO-s dhe BE-së. Nëse Maqedonia dhe Kosova do të punojnë për të kapërcyer bllokimet e deritanishme në rrugën e tyre për t'iu bashkuar këtyre dy organizatave, integrimi euroatlantik do të vazhdojë të luajë një rol të rëndësishëm në përmirësimin e marrëdhënieve të përgjithshme mes tyre. Kështu, aspiratat euroatlantike të dy vendeve, forcimi i marrëdhënieve fqinjësore dhe i bashkëpunimit rajonal, do të luajnë një rol pozitiv në sjelljen e tyre sa me pranë njëri-tjetrit. Përveç kësaj, për shkak të afrimit më të madh të Maqedonisë drejt NATO-s dhe integritit në BE, ajo mund të luajë një rol të rëndësishëm për të ndihmuar përafrimin e Kosovës në këto organizata.

Përfundime

Në përfundim mund të thuhet se ka shumë perspektiva premtuese për bashkëpunimin e ardhshëm ndërmjet Maqedonisë dhe Kosovës. Në këtë drejtim, roli i faktorit etnik do të mbetet pa dyshim vendimtar. Marrëdhëniet e mira, të qëndrueshme dhe të sigqerta ndërmjet anëtarëve të dy grupeve të mëdha etnike në Maqedoni janë një garanci e fortë për marrëdhëniet të mira fqinjësore të përjetshme mes dy vendeve. Tensionet e fundit ndëretnike dhe dhuna në Maqedoni si dhe reagimi i mëvonshëm në Kosovë, kanë tensionuar marrëdhëniet midis dy fqinjëve. Edhe pse aktualisht situata është relativisht e qetë, faktori etnik ka dëmtuar sërish marrëdhëniet mes Maqedonisë dhe Kosovës, në veçanti, dhe midis maqedonasve dhe shqiptarëve, në përgjithësi. Pa dyshim në perspektivë, sukcesi i këtyre marrëdhënieve do të varet shumë nga zhvillimi i marrëdhënieve ndëretnike, mes dy grupeve më të mëdha në Maqedoni.

Për sa i përket bashkëpunimit të përgjithshëm ekonomik, duhet

²⁸ Marta Szpala, "Regional impact of the ICJ's advisory opinion on Kosovo", (Warsaw: Centre for Eastern Studies, August 04, 2010), accessed February 18, 2012, <http://www.osw.waw.pl/en/publikacje/ceweekly/2010-08-04/regional-impact-icj-s-advisory-opinion-kosovo>.

thënë se tregtia ndërmjet dy vendeve është përmirësuar në mënyrë të qëndrueshme. Biznesmenët maqedonas dhe kosovarë janë dakord se këto marrëdhënie ende nuk përputhen me nivelin e mundësive ekzistuese dhe të përfitimeve për të dy vendet. Duke pasur parasysh përfitimet reciproke nga bashkëpunimi ekonomik mes dy vendeve mund të thuhet se ky bashkëpunim mund të ndikojë dukshëm në forcimin e marrëdhënieve të ardhshme midis Maqedonisë dhe Kosovës.

Në përfundim, integrimi Euro-Atlantik ka ndihmuar në transformimin e marrëdhënieve midis këtyre dy vendeve nga marrëdhënie relativisht armiqësore në një bashkëpunim të ndërsjellë mes tyre. Megjithatë, bllokimi i Maqedonisë drejt integritit euroatlantik i kontribuon ndarjeve etnike në vend dhe të ardhmes së përbashkët. Integrimi i suksesshëm i Maqedonisë në NATO dhe BE pa dyshim që do të kontribuojë në çaktivizimin e tensioneve aktuale ndëretnike. Përmirësimi i përgjithshëm i klimës mes maqedonasve dhe shqiptarëve do të sjellë, në fund të fundit, një kontribut të madh drejt marrëdhënieve më të ngushta ndërmjet Maqedonisë dhe Kosovës.

Bibliografia

“Àíéâðà: Ãðàfàíèòà íà ñà çà ÷ëáíñòâî âî ÍÀÔÎ àèî à óñëîâ ïðîíáíà íà èíàðî”, *ÒÁ Ñèðàãë*, Áíðëë 04, 2011, Accessed February 17, 2012.

<http://sitetel.com.mk/dnevnik/makedonija/anketa-gragjanite-ne-se-za-chlenstvo-vo-nato-ako-e-uslov-promena-na-imeto>.

“Arifi: Incidents in Macedonia should not be underestimated”, *Kosovapress*, Pristina, March 22, 2012. Accessed March 25, 2012, <http://kosovapress.com/?cid=2,86,144793>.

Centre for Research and Policy Making, “Results of the survey held on Marxh 2008”, Accessed November 19, 2011. <http://www.crpm.org.mk/Home.htm>.

Daskalovski, Zhidas and Dane Taleski, “The Independence of Kosovo and the Consolidation of Macedonia - A Reason to Worry?”, in *Cutting or Tightening the Gordian Knot? The Future of Kosovo and the Peace Process in the Western Balkans after the Decision on Independence*, edited by Ernst M. Felberbauer, Predrag Jurekoviæ and Frederic Labarre, Vienna: National Defence Academy and Bureau for Security Policy at the Austrian Ministry of Defence, October 2008.

Gaber-Damjanovska, Natasha and Aneta Jovevska, “Current Events and Political Parties Development in the Republic of Macedonia”, *Barometer* 26 (June 2012),f. 01-55.

- “Greece Unimpressed by ICJ Ruling on Macedonia Dispute”, *Novinite*, December 05, 2011. Accessed May 17, 2012. http://www.novinite.com/view_news.php?id=134562.
- “Greece, Macedonia urged to end name dispute after ICJ ruling”, *The Sofia Echo*, December 06, 2011. Accessed May 19, 2012. http://sofiaecho.com/2011/12/06/1278342_greece-macedonia-urged-to-end-name-dispute-after-icj-ruling.
- Hupchick, Dennis P. *The Balkans: from Constantinople to Communism*, New York: Palgrave Macmillan, 2002.
- “ICJ rules Greece ‘wrong’ to block Macedonia’s NATO bid”, *BBC News Europe*, December 05, 2011, Accessed February 19, 2012, <http://www.bbc.co.uk/news/world-europe-16032198>.
- “Kosovo Albanians hail ICJ decision as big victory”, *B92, News-Politics*, July 22, 2010, Accessed February 21, 2012. http://www.b92.net/eng/news/politics-article.php?yyyy=2010&mm=07&dd=22&nav_id=68621.
- “Largpërçuesit kërkojnë 60 milionë euro investime”, *Zhurnal*, Shkup, 12 dhjetor 2011.
- “Macedonia Savours World Court Victory Over Greece”, *Balkan Insight*, December 05, 2011, Accessed February 17, 2012, <http://www.balkaninsight.com/en/article/icj-judgment>.
- “Macedonia: Putting the World Court to Use”, *Macedonian Information Agency*, January 24, 2012, Accessed February 21, 2012. <http://www.topix.com/forum/world/macedonia/T2H6Q6DB55EQAL9EI/p5>.
- “Macedonian Embassy Attacked”, *Kosovo Media Monitor*, Pristina, March 18, 2012, Accessed March 23, 2012. http://newsmonitors.org/mon/index.php?option=com_content&view=article&id=1125:sunday-report-18-03-2012&catid=38:sunday.
- “Macedonian Embassy in Kosovo Suffers Molotov Cocktail Attack”, *Novinite*, March 01, 2012. Accessed March 23, 2012, http://www.novinite.com/view_news.php?id=137641.
- “Macedonia’s NATO and EU hopes given boost by International Court of Justice”, *The Guardian*, December 05, 2011, Accessed February 01, 2012. <http://www.guardian.co.uk/world/2011/dec/05/macedonia-nato-eu-greece-icj>.
- Marusic, Sinisa Jakov, “Macedonia to Curb Fans Offensive Chants”, *Balkan Insight*, Skopje, February 17, 2012, Accessed March 13, 2012. <http://www.balkaninsight.com/en/article/macedonia-curbs-fan-s-offensive-chanting>.

- Marusic, Sinisa Jakov, "Unsolved Killings Raise Fears of Macedonian Turmoil", *Balkan Insight*, April 18, 2012, Accessed October 15, 2012. <http://www.balkaninsight.com/en/article/unsolved-killings-raise-fears-of-macedonian-turmoil>.
- Misha, Piro, "Invention of Nationalism: Myth and Amnesia", in *Albanian Identities: Myth and History*, edited by Stephanie Schwandner-Sievers and Bernard Fisher, London: Hurst, 2002.
- North Atlantic Treaty Organization, "Chicago Summit Declaration", *issued by the Heads of State and Government participating in the meeting of the North Atlantic Council in Chicago*, Press Release (2012) 062, May 20, 2012.
- Perry, Duncan, "Conflicting Ambitions and Shared Fates: The Past, Present and Future of Albanians and Macedonians", in *The Macedonian Question: Culture, Historiography, Politics*, edited by Victor Roudometof, Boulder: Columbia University Press, 2000.
- "Ilanë të çarë çà à è à ç à â à Å ð ï ñ è à Ó i è ¼ à", *Áiáâíèè*, *Àâèâíâðè* 04, 2010.
- "Premier hopes for Macedonia's NATO entry at Chicago summit", *Investors Business Daily*, January 25, 2012, Accessed February 21, 2012. <http://news.investors.com/newsfeed/article/140580172/201201260937/premier-hopes-for-macedonias-nato-entry-at-chicago-summit.aspx>.
- Ragaru, Nadège, "Macedonia: Between Ohrid and Brussels", in *Is there an Albanian question?* edited by Judy Batt, Chaillot Paper, no. 107, Institute For Security Studies, January 2008.
- "Situation in Macedonia calmer but inter-ethnic tensions with Albanians linger", *The Sofia Echo*, March 14, 2012, Accessed March 26, 2012. http://sofiaecho.com/2012/03/14/1787294_situation-in-macedonia-calmer-but-inter-ethnic-tensions-with-albanians-linger.
- "Skopje - Pristina highway in two years?!", *Macedonian Information Centre*, Daily News Service, October 17, 2011, Accessed March 03, 2012. <http://www.thefreelibrary.com/Skopje-pristina+highway+in+two+years%3F!-a0271323993>.
- "Statement by the Foreign Minister of the Republic of Kosovo, H. E. Mr Skender Hyseni, on the ICJ Opinion of July 22, 2010", *Ministry of Foreign Affairs*, July 22, 2010.
- Szpala, Marta, "Regional impact of the ICJ's advisory opinion on Kosovo", Warsaw: Center for Eastern Studies, August 04, 2010, Accessed February 18, 2012.

<http://www.osw.waw.pl/en/publikacje/ceweekly/2010-08-04/regional-impact-icj-s-advisory-opinion-kosovo>.

Tanner, Adam and Reed Stevenson, "Kosovo independence declaration deemed legal", *Reuters*, July 22, 2010, Accessed February 16, 2012.

<http://www.reuters.com/article/idUSTRE66L01720100722>.

"UN seeks World Court Kosovo view", *BBC News*, October 08, 2008, Accessed February 18, 2012, <http://news.bbc.co.uk/2/hi/europe/7658103.stm>

Doktorante Elvana Çiçolli

NDIHMJA E NDËRSJELLË JURIDIKE, URDHRI EUROPIAN I ARRESTIT

Abstrakt

Shqipëria gjithnjë e më shumë ka bërë përpjekje për njohjen dhe zbatimin e konventave, instrumenteve dhe akteve të tjera me rëndësi ndërkombëtare në fushën e bashkëpunimit gjyqësor dhe ndihmës së ndërsjellë juridike për çështjet penale. Mes Shqipërisë dhe vendeve të tjera janë ndërtuar mekanizma të fortë bashkëpunimi.

Legjislacioni ynë është ndryshuar në mënyrë thelbësore në përputhje me standardet bashkëkohore, për sa i përket krimit të organizuar, terrorizmit dhe financimit të tij, sequestrimit dhe konfiskimit të pasurive që rrjedhin nga veprimtaritë kriminale, infiltrimit të agjentëve policorë, strukturat dhe mekanizmat procedurale të specializuara etj.

Përshtatja dhe harmonizimi i legjislacionit është hapi i parë në krijimin e instrumenteve të qëndrueshëm me qëllim realizimin e ndihmës së ndërsjellë juridike. Një prej formave të shfaqjes së kësaj fryme bashkëpunimi është urdhri evropian i arrestimit, i cili mund të konsiderohet edhe si kapërcyesi i kufijve në hapësirën evropiane.

Fjalët kyçe: *legjislacion, penal, evropian, bashkëpunim, rajonal.*

Hyrje

Në fund të Luftës së Dytë Botërore, në sfond ishte një kontinent i rrënuar nga konflikti, dy ideologji të kundërta, që për dyzet vjet përjetuan Luftën e Ftohtë. Ideja e integritimit evropian lindi pikërisht

në atë periudhë, me qëllim që të mos përjetoheshin më tej tragjedi të ngjashme. Prej viti 1949, Këshilli i Europës manifestoi përpjekjet për bashkëpunimin ndërmjet shteteve. Prej traktatit për qymyrin dhe çelikon bashkëpunimi u shtri në sektorë të tjerë të ekonomisë dhe jo vetëm. U nënshkrua Traktati ECC, u themelua Tregu i Përbashkët për Lëvizjen e Lirë të Njerëzve, Mallrave dhe Shërbimeve, dhe shtetet e tjera iu bashkuan kësaj iniciative.

Që atëherë projekti i Europës së bashkuar nuk pushoi së zhvilluari. Europa hyri në një epokë të re, ku bashkëpunimi ndërkombëtar, në përgjithësi, dhe ndihma e ndërsjellë juridike, në veçanti, evoluan duke shënuar fillimin e periudhës së nënshkrimit të konventave shumëpalëshe.

Në këtë periudhë historike kemi edhe nënshkrimin e disa konventave kryesore në fushën e bashkëpunimit penal midis shteteve anëtare të KE-së, siç është nënshkrimi në vitin 1959 i Konventës “Për ndihmë të ndërsjellë juridike në fushën penale”. Kjo Konventë përfaqëson dhe fillimin e një bashkëpunimi të gjerë, shumëpalësh, që do të përmirësonte ndjeshëm luftën ndaj kriminalitetit dhe arritjen e rezultateve të para efikase në paraarrestimin e tij. Po në këtë kohë, u nënshkrua edhe Konventa për Ekstradimin, nëpërmjet së cilës shtete palë morën përsipër jo vetëm të ndëshkonin personat të cilët kishin kryer veprime të paligjshme, por edhe të kujdeseshin për ekzekutimin me efektivitet të këtyre sanksioneve¹.

Në fakt, që prej fillimit, bashkimi ideal parashikohej në të gjitha nivelet, por vetëm në vitet e fundit kjo po ndodh edhe në fushën e të drejtës penale. Megjithëse kjo kishte qenë e planifikuar që gjashtëdhjetë vjet më parë, kohët e fundit është shfaqur nevoja urgjente për një strategji të përbashkët kundër të gjitha veprimtarive të paligjshme.

Me kalimin e kohës u nënshkruan konventa të tjera, të cilat e zgjeruan këtë objekt bashkëpunimi, si p.sh.: Konventa e nënshkruar në vitin 1964, “Për dënimin me kusht”; Konventa “Për dënimin e veprave penale në fushën e trafikut rugor”; “Për vlerën ndërkombëtare të gjyqimeve penale” etj. Megjithatë, vetëm në kuadër të Këshillit të Europës, shtetet anëtare arritën të konsolidonin gjithnjë e më shumë bashkëpunimin e tyre në fushën penale dhe t’i paraprinin luftës ndaj krimit të organizuar. Ndryshimet ekonomiko-shoqërore vazhdonin të ndikonin në vullnetin pozitiv të shteteve për të ecur drejt zgjerimit të mëtejshëm të sferës së veprimit të konventave dhe marrëveshjeve europiane.

¹ Konventa e Këshillit të Europës për ekstradimin u nënshkrua në vitin 1957.

Kjo i çoi shtetet në nënshkrimin dhe ratifikimin e konventave të tjera në fushën penale, si ajo “Për transferimin e procedimeve penale”, e nënshkruar në vitin 1972; Konventa “Për luftën ndaj terrorizmit” e vitit 1977; Konventa “Për transferimin e personave të dënuar” e vitit 1983 etj. Vlen të theksohet se, në këtë kohë, po në kuadër të Këshillit të Europës, u miratuan edhe një sërë protokollesh shtesë të konventave të nënshkruara më parë, me qëllim thjeshtëzimin e procedurave aplikative dhe futjen e instrumenteve shtesë të detyrueshme për shtetet, të cilat do të lehtësonin zbatimin efikas në praktikë të këtyre konventave.

Nga Këshilli i Europës në funksion të një bashkëpunimi të ndërsjellë juridik, janë miratuar dhe një sërë rekomandimesh, rezoluta, vendime, rregullore të cilat kanë pasur një ndikim të rëndësishëm në vullnetin e shteteve për bashkëpunim dhe mbështetje juridike ndaj njëri-tjetrit.

1. Legjislacioni shqiptar dhe ndihma juridiko-penale

Shqipëria ka nënshkruar e më pas ratifikuar një sërë konventash dhe marrëveshesh të ndërmarra nga ana e organizmave ndërkombëtare në kuadër të partneritetit të luftës kundër krimit të organizuar dhe fenomeneve të lidhura me të. Duke iu referuar Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 5 të saj: “*Republika e Shqipërisë zbaton të drejtën ndërkombëtare të detyrueshme për të*”. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, në dispozitat e saj kalimtare ka rregulluar vlerën juridike të traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare të hershme, të ratifikuara para hyrjes së saj në fuqi. Kështu, të gjitha marrëveshjet dhe traktatet e ratifikuara nga shteti shqiptar, para hyrjes në fuqi të kësaj Kushtetute, konsiderohen të ratifikuara sipas kësaj Kushtetute². Republika e Shqipërisë ka vijuar procesin e përafrimit dhe harmonizimit të legjislacionit me ratifikimin e një sërë konventash³.

Konventa “Për ndihmë të ndërsjellë në fushën penale”, e vitit 1999, përbën bazën e realizimit të një hapësire të përbashkët

² Neni 180/1 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

³ Karta e Kombeve të Bashkuara dhe Statuti i Gjykatës Ndërkombëtare Penale; Konventa e OKB-së kundër krimit të organizuar ndërkombëtar (2000); Konventa e OKB-së kundër trafikimit të paligjshëm të drogave (2000); Konventa e OKB-së për ndalimin dhe ndëshkimin e gjenocidit (1954); Konventa e OKB-së kundër drogave narkotike (2000); Konventa Europiane “për krimin në fushën e kibernetikës” (2002); Konventa Europiane “për mbrojtjen e të drejtave të njeriut” (1996); Konventa Europiane “për pastrimin, hetimin dhe kapjen e produkteve të krimit” (2000); Konventa Europiane “për mbikëqyrjen e të dënuarve ose të liruarve me kusht” (2000);

gjyqësore në fushën penale. Ashtu sikurse rezulton nga Konventa edhe fryma e legjislacionit procedural penal shqiptar: *“Ndihmë e ndërsjellë juridike do të konsiderohet çdo mbështetje juridike që një shtet i jep një shteti tjetër, me kërkesë të këtij të fundit, për një procedim penal të ndërmarrë në shtetin kërkuar. Kjo mbështetje nuk varet nëse procedimi penal ndërmerret nga një gjykatë apo nga një organ tjetër procedural”*.

Mbështetja spontane e një gjykimi të huaj penal, pa kërkesën e shtetit që zhvillon gjykimin, në kuptimin e ngushtë, nuk përfshihet në konceptin e ndihmës juridike, megjithatë ligji i shumë shteteve, duke përfshirë këtu edhe ligjin shqiptar⁴, lejojnë që të ndërmerren veprime të caktuara mbështetëse në pritje të një kërkesë për ndihmë të ndërsjellë që mund të bëhet më pas. Baza për mbështetjen e një procedimi penal të huaj nga gjykatat dhe organet e shtetit që e japin atë, është në çdo rast legjislacioni i brendshëm. Është vetë Konventa që në paragrafin e parë të nenit 3 të saj, sanksionon se: *“Pala së cilës i drejtohet një kërkesë do të ekzekutojë, sipas procedurave të parashikuara nga legjislacioni i vendit të saj, letërporositë që lidhen me një procedim penal që do t’i drejtohen asaj nga autoritetet gjyqësore të palës kërkuese...”*.

Në Shqipëri, legjislacioni bazë për çdo lloj forme mbështetjeje juridike është Kodi i Procedurës Penale. Ashtu siç është parashikuar edhe në legjislacionet e vendeve të tjera, në legjislacionin procedural penal janë parashikuar mënyrat e realizimit të ndihmës së ndërsjellë juridike dhe bashkëpunimit gjyqësor:

- Ekstradimi i një personi të kërkuar për/dhe nga jashtë shtetit⁵.
- Ndihma e ndërsjellë juridike⁶ nëpërmjet letërporosive ndërkombëtare⁷.
- Ekzekutimi i vendimeve të dhëna në një shtet të huaj⁸.

Konventa Europiane “për shtypjen e terrorizmit” (2000); Konventa Europiane “për vlefshmërinë e gjyqësorëve penale ndërkombëtare” (2003); Konventa Europiane “për ekstradimin dhe protokollet shtesë” (1998); Konventa Europiane “për korrupsionin në fushën penale” (2001); Konventa Europiane “për ndihmë të ndërsjellë në fushën penale” (1999); Konventa Europiane “për transferimin e personave të dënuar” (1999); Konventa Europiane “për transferimin e procedimeve të çështjeve penale” (1999); Statuti i Romës.

⁴ Neni 493, 494 dhe 495 të Kodit të Procedurës Penale, ku sanksionohen masat e përkohshme (masa shtrënguese, sekuestrime dhe arrestim i përkohshëm që mund të ndërmerren nga shteti Shqiptar në pritje të një kërkesë për ekstradim nga një shtet i huaj.

⁵ Kreu i parë i Titullit X, të Kodit të Procedurës Penale, nenet 488-504.

⁶ Kreu i dytë i Titullit X, të Kodit të Procedurës Penale, nenet 505-511.

⁷ Mënyra e dhënies së ndihmës së ndërsjellë bëhet nëpërmjet letërporosive ose *leter of rogatory*.

⁸ Kreu i tretë i Titullit X, të Kodit të Procedurës Penale, nenet 512-524.

Është me rëndësi të theksohet se rregullimi ligjor që i bën Kodi i Procedurës Penale marrëdhënieve të bashkëpunimit dhe ndihmës juridike, është shumë i përgjithshëm dhe nuk i përgjigjet evoluimit aktual të këtyre marrëdhënieve dhe formave të reja të mbështetjes juridike që ofron Konventa e KE-së “për ndihmë të ndërsjellë juridike në fushën penale”, dhe sidomos protokollin i dytë shtesë i saj.

Përveç sa më sipër, për shkak të aspiratës për të qenë pjesë e BE-së, legjislacioni shqiptar është duke u përfaruar dhe harmonizuar me *acquis communautaire*. Legjislacioni komunitar në tërësinë e tij sanksionon standarde të cilat duhet të jenë orientuese për të gjitha vendet të cilat kërkojnë të jenë pjesë e BE-së.

Në këtë këndvështrim, legjislacioni penal material dhe procedural është duke u përshtatur në vijimësi me parashikimet europiane të formalizuara në konventa, direktiva, rregullore, rekomandime, vendime kuadër. Edhe pse Shqipëria nuk është ende pjesë e BE-së, përafrimi i legjislacionit është një nevojë e domosdoshme, me qëllim krijimin e kushteve dhe infrastrukturës së përshtatshme për implementimin e *acquis communautaire*.

Aktualisht shteti shqiptar ka arritur një progres të veçantë në përshtatjen dhe përafrimin e legjislacionit të brendshëm me atë europian penal. Kjo është arritur duke miratuar një sërë ligjesh të rëndësishme në fushën penale, të cilat kanë krijuar kështu një bazë ligjore të plotë në luftën për paraarrestimin e kriminalitetit kombëtar dhe ndërkombëtar.

2. Urdhri europian i arrestimit

Me vendimin kuadër 2002/584, u parashikua për herë të parë në Europë “urdhri europian i arrestimit”⁹. Terminologjia e përdorur i referohet një urdhri nëpërmjet të cilit bëhet i mundur dorëzimi i personave të kërkuar, ndaj të cilit mund të jetë caktuar një masë sigurimi apo një vendim dënimi në një vend anëtar të BE-së. Ky instrument paraqitet si shprehje e drejtpërdrejtë e parimit të ndihmës së ndërsjellë, i cili është i destinuar t’i japë një kthesë të jashtëzakonshme bashkëpunimit gjyqësor. “Urdhri europian i arrestimit”, sipas nenit 1 të vendimit kuadër 2002/584, parashikon një veprim kompleks, të veçantë dhe tërësisht autonom. “Urdhri europian i arrestimit” është një vendim gjyqësor i lëshuar nga një shtet anëtar me qëllim arrestimin dhe dorëzimin nga një shtet tjetër anëtar, të një personi të kërkuar për ushtrimin e një veprimi

⁹ Publikuar në buletin zyrtar të saj më 18 qershor 2002.

penal ose ekzekutimin e një dënimi penal, ose një mase sigurimi privues për lirinë¹⁰. Ashtu sikurse mund të konstatohet lehtësisht, ky vendim nuk është i zbatueshëm për Shqipërinë në këtë moment, por me vijimin e procesit për të qenë pjesë e BE-së, ky akt do të prodhojë efekte ligjore.

“Urdhri europian i arrestimit” është parashikuar në funksion të procedimit penal, i cili ka si qëllim dorëzimin e një personi të kërkuar nga një shtet anëtar i BE-së me qëllim: ekzekutimin e një dënimi penal, ekzekutimin e një mase sigurimi e cila ka privuar lirinë personale. Neni 6 i vendimit kuadër e ka konsideruar “urdhrit e arrestit europian” si konkretizimin e parimit të ndihmës së ndërsjellë në fushën penale, të cilin Këshilli i Europës e përkufizon si themelin e bashkëpunimit gjyqësor.

Pyetja që mund t’u lindë studiuesve të së Drejtës dhe zbatuesve të legjislacionit procedural penal në praktikë, është: përse duhet të ekzistojë ky instrument ndërkohë që nëpërmjet kërkesës për ekstradim apo transferim mund të realizohet privimi i lirisë së individit në funksion të procedimit apo dënimit penal? Kjo pasi në nenin 16 të Konventës Europiane të Këshillit të Europës “për ekstradimin”, në nenet 494 dhe 495 të Kodit të Procefurës Penale, si dhe në nenet 35 dhe 36 të Ligjit nr. 10/193, datë 3.12.2009 “Për marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja në çështjet penale është parashikuar mundësia e marrjes së një mase shtrënguese me karakter të përkohshëm (përpara se të vijë kërkesa e ekstradimit).

Dy janë elementët thelbësorë dallues me ekstradimin e parashikuar nga Konventa Europiane për Ekstradimin e vitit 1957:

Së pari, kërkesa për arrestim dhe kërkesa për dorëzimin e një personi për zbatimin e një vendimi penal ose mase sigurimi nuk përbëjnë më dy momente procedurale të shkëputura, por integrohen në një procedurë të vetme.

Së dyti, në lidhje me urdhrin e arrestimit konsiderohet me rëndësi thelbësore dorëzimi i personit pasi mungesa e tij do ta bënte vendimin pa efekt.

Me Konventën e vitit 1957, arrestimi startonte procesin e shkëmbimit të informacioneve dhe dokumentacionit mes shtetit kërkuar dhe atij të kërkuar. Kjo në mënyrë që ky i fundit të kishte të gjitha mundësitë për të vlerësuar dorëzimin e të kërkuarit. Ndërkohë që me urdhrin e arrestit europian shteti zbatues është i detyruar të ekzekutojë masën e kërkuar dhe, në këtë mënyrë, autoriteteve të këtij vendi i mbetet vetëm një vlerësim *aposterior* mbi vazhdimin e gjendjes së arrestimit.

¹⁰ Neni 1 i vendimit kuadër 2002/584/GAI.

Këto elementë dallues konsiderohen me rëndësi thelbësore për shkak të efektivitetit të garantuar të këtij veprimi procedural. Ndryshe nga procedura e ekstradimit, qëllimi i “urdhrit europian të arrestit” është dorëzimi në mënyrë **“urgjente”** i personit të kërkuar. Objektivi mbetet realizimi i një hapësire të përbashkët juridike, e frymëzuar nga realizimi eficient i ndihmës së ndërsjellë për njohjen e vendimeve penale të huaja.

Në vendimin kuadër parashikohen shprehimisht veprat penale për të cilat mund të zbatohet “urdhri europian i arrestimit” pa iu nënshtruar inkriminimit të dyfishtë¹¹, si p.sh.: pjesëmarrja në organizata kriminale, terrorizmi, trafikimi i qenieve njerëzore, shfrytëzimi seksual i fëmijëve, trafikimi i lëndëve narkotike, trafikimi i armëve, mashtrimi, korrupsioni, vrasja, racizmi dhe ksenofobia. Për veprat penale të cilat nuk janë parashikuar, vazhdon ekzekutimi duke iu nënshtruar parimit të inkriminimit të dyfishtë. Kjo do të thotë që “urdhri europian i arrestimit” ekzekutohet vetëm nëse vepra penale për të cilën është lëshuar parashikohet dhe në legjislacionin e vendit, i cili do ta zbatojë këtë masë. Ky parashikim nuk i referohet kualifikimit ligjor. Mjafton që fakti të përbëjë vepër penale dhe në shtetin zbatues pavarësisht nëse është i njëjti cilësim për veprën penale për të cilën është caktuar masa e sigurimit apo vendimi dënimit.

Gjithsesi, pavarësisht limiteve të vendosura për autoritetet e vendit që do të zbatojnë arrestimin europian, kjo procedurë vë në vend të parë qëllimin e realizimit të dorëzimit të personit. Në funksion të këtij qëllimi, autoritetet e shtetit zbatues zgjedhin nëse mund ta dëgjojnë ose jo personin e kërkuar.

Urdhri europian i arrestimit ka si qëllim zëvendësimin e sistemit aktual të ekstradimit, duke i imponuar autoriteteve gjyqësore të shteteve anëtare të Bashkimit të njohin kërkesën e dorëzimit të një personi, të lëshuar nga autoriteti gjyqësor i një shteti tjetër anëtar¹². Ky urdhër do të zëvendësojë gjithë procedurat e zgjatura politike, juridike dhe administrative që duhet të kalojë një kërkesë për ekstradim.

3. Procedura

Urdhri europian i arrestimit është i detyrueshëm për t’u zbatuar nga çdo autoritet gjyqësor për shtetet anëtare dhe konsiderohet

¹¹ Parashikimi i figurës së veprës penale si nga legjislacioni i vendit kërkues dhe i atij të kërkuar.

¹² Këtu bëhet fjalë për autoritetet gjyqësore kompetente për nxjerrjen dhe zbatimin e urdhrit të ndalimit ose kërkesës për dorëzim

si një nga gurët e themelit në krijimin e një hapësire të vërtetë gjyqësore europiane. Ai nxirret me qëllim arrestimin ose dorëzimin e një personi që ka kryer një vepër penale, për ekzekutimin e një dënimi të formës së prerë të dhënë në mungesë dhe ekzekutimin e një mase policore me heqje lirie.

Shtetet anëtare do të përcaktojnë se cilat do të jenë autoritetet gjyqësore kompetente të lëshimit dhe ekzekutimit të një urdhri arrestimi ose dorëzimi. Urdhri duhet të përmbajë një sërë informacionesh lidhur me identitetin e personit, autoritetin gjyqësor që ka lëshuar urdhrin, natyrën e shkeljes së kryer, dënimin e dhënë kur ka një vendim të formës së prerë etj. Në përgjithësi urdhri do të komunikohet direkt nga autoriteti i shtetit anëtar lëshues për tek autoriteti gjyqësor i ekzekutimit.

Çdo shtet anëtar do të marrë të gjitha masat e nevojshme në rast ekzekutimi të një urdhri arrestimi ose dorëzimi. Menjëherë sapo personi ndalohet, ai do të ketë të drejtën për t'u informuar mbi përmbajtjen e urdhrin si dhe të drejtat e tij. Autoriteti i ekzekutimit është i lirë të vendosë nëse do ta mbajë të ndaluar personin apo do ta lirojë atë nën kushte të caktuara.

Autoriteti i ekzekutimit përpara se të marrë një vendim të formës së prerë mbi ekzekutimin e urdhrin të arrestimit ose dorëzimit, mund t'i kërkojë autoritetit lëshues të urdhrin informacione shtesë, kur informacioni i komunikuar nuk është i plotë ose i mjaftueshëm.

Një shtet anëtar mund edhe të mos e ekzekutojë një urdhër të tillë nëse ka një vendim të formës së prerë për të njëjtën shkelje dhe për të njëjtin person¹³, shkelja është amnistuar në shtetin anëtar të ekzekutimit si dhe kur personi nuk mund të jetë përgjegjës nga shteti anëtar i ekzekutimit për shkak të moshës së tij.

Kriteret dhe procedura për ekzekutimin e “urdhrit europian të arrestimit” nuk duhet të pësjellohen me caktimin e masave shtrënguese sipas ligjit nr. 10/193, datë 3.12.2009 “Për marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja në çështjet penale”, i cili parashikon se¹⁴: “

4. *Gjykata, për caktimin e masave shtrënguese dhe të sekuestrimit, respekton rregullat e Kodit të Procedurës Penale.*

5. *Masat shtrënguese dhe sekuestrimi caktohen nëse urdhri ndërkombëtar i arrestit ose kërkesa e shtetit të huaj përmban:*

a) gjeneralitetet e shtetasit të huaj;

¹³ Kjo lidhet me parimin e njohur të së drejtës, “*ne bis in idem*”.

¹⁴ Neni 35, pika 4 dhe 5 i Ligjit nr. 10/193, datë 3.12.2009 “Për marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja në çështjet penale”.

b) të dhënat mbi autoritetin gjyqësor të huaj që ka lëshuar urdhrin ndërkombëtar të arrestit ose një kopje të aktit, me të cilin është urdhëruar masa shtrënguese apo sekuestrimi;

c) të dhënat mbi veprën penale, për të cilën kërkohet masa shtrënguese ose sekuestrimi; dhe

ç) deklarin e shtetit kërkues se do të paraqitet një kërkesë për ekstradim”.

Neni 36 i Ligjit nr. 10/193, datë 3.12.2009 “Për marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja në çështjet penale”, parashikon se: “1. Në rastet e ngutshme të arrestimit të personit, kundër të cilit është paraqitur kërkesa për arrestimin e përkohshëm, zbatohen rregullat e nenit 495 të Kodit të Procedurës Penale.

1. Me kërkesë të Prokurorit të Përgjithshëm, Ministria e Drejtësisë realizon përkthimin e akteve të kërkuara brenda 24 orëve”.

Ashtu sikurse u shpjegua më lart, urdhri evropian i arrestimit ka për qëllim të zëvendësojë gjithë procedurat e zgjatura politike, juridike dhe administrative që duhet të kalojë një kërkesë për ekstradim. Po kështu, nëpërmjet realizimit të kësaj procedure, kompetencat e autoriteteve gjyqësore të shtetit zbatues kufizohen në verifikimin e mëparshëm të arrestimit dhe jo verifikimit paraprak të kushteve në të cilat është lëshuar.

4. Problematika

Me gjithë kontributin e çmuar për realizimin e ndihmës së ndërsjellë juridike, zbatimi i urdhrit të arrestimit evropian ka shkaktuar probleme të shumta që rrjedhin nga mosperceptimi i saktë si instrument. Urdhri i arrestimit evropian, pavarësisht qëllimit legjitim, nuk mund të realizohet në mënyrë të tillë që të vijë në kundërshtim me liritë dhe të drejtat e njeriut¹⁵. Organizata të ndryshme të mbrojtjes së lirive dhe të drejtave të njeriut kanë bërë publike raste të arrestimit të personave të pafajshëm, arrestime disproporcionale, dhunimin e të drejtave procedurale dhe në disa shtete pamundësinë për të paraqitur ankim kundër arrestimit dhe dorëzimit në shtetin kërkues. Kjo pasi, pavarësisht lehtësimit të mënyrës së bashkëpunimit mes shteteve, Vendimi Kuadër parashikon ekzekutimin e arrestimit me urgjencë, duke i lënë mundësinë shtetit zbatues të cenojë ose të mos realizojë në mënyrë të efektshme të drejtat dhe liritë themelore duke iu referuar nenit 5 të KEDNJ-së.

¹⁵ Deklaratë për shtyp, Zyra për të Drejtat e Njeriut, Këshilli i Europës, 15.03.2011.

Kështu, në nenin 18 të këtij vendimi kuadër, i jep të drejtën autoriteteve gjyqësore që të zgjedhin të dëgjojnë ose të transferojnë përkohësisht të kërkuarin. Mohimi ose vonesa në realizimin e të drejtës për t'u dëgjuar dhe si rrjedhojë e saj në cenimin për mbrojtje efektive përbën cenim të nenit 5 të KEDNJ-së¹⁶. Neni 5 i KEDNJ-së sanksionon jo vetëm të drejtën për të asistuar nga një avokat, përkthyes¹⁷ po edhe:

3. *Çdo njeri që arrestohet ose ndalohet në përputhje me dispozitat e paragrafit 1. c. të kët3 neni, sillet brenda një afati sa më të shkurtër, para një gjyqtari ose një nëpunësi tjetër të autorizuar me ligj që të ushtrojë kompetenca gjyqësore, dhe ka të drejtën e gjykimi brenda një afati të arsyeshëm, ose të lirimit në pritje të gjykimit. Lirimi mund të kushtëzohet me garanci për t'u paraqitur në gjyq.*

4. *Çdo njeri të cilit i është hequr liria me anë të arrestimit, “ka të drejtë të ndërmarrë procedura me anë të të cilave do të vendoset me shpëjtësi nga një gjykatë ligjshmëria e arrestimit të t3 ose lirimit të t3 nëse arrestimi nuk është i ligjshëm...”*

Në vijim të dispozitave të këtij Vendimi Kuadër, lihet e hapur mundësia që i arrestuari të rivendosë në vend të drejtën, mirëpo, për shkak të procedurës emergjente, këto të drejta lihen në një plan aksesor me qëllim realizimin në një moment të dytë. Urgjenca e dorëzimit të personit bën që praktikisht, realizimi i këtyre të drejtave të mbetet për t'u ekzekutuar pasi urdhri europian i arrestimit t'i ketë prodhuar efektet e tij. Nga sa më sipër, zbatimi i këtij veprimi procedural emergjent duhet të vijë në përputhje me respektimin e të drejtave të njohura dhe të garantuara me aktet ndërkombëtare. Organet e ngarkuara me realizimin e kësaj procedure, si policia gjyqësore, prokuroria dhe gjykata, duhet t'i japin mundësinë të kërkuarit të realizojë me efektivitet të drejtat e tij.

Në të vërtetë, ky veprim procedural ka si qëllim evitimin e të gjitha pengesave procedurale, administrative dhe burokratike me qëllimin realizimin me sukses të luftës kundër kriminalitetit. Në këtë këndvështrim, gjithmonë do të ekzistojë përplasia dhe pyetja së cilës duhet t'i japin përgjigje autoritetet: cili është qëllimi më i rëndësishëm mes luftës kundër kriminalitetit dhe respektimit të të drejtave të njeriut?

Në përfundim të asaj që u paraqit më lart, do të theksoja se ndërtimi i një hapësire të vërtetë gjyqësore europiane kërkon

¹⁶ Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut.

¹⁷ Neni 11 i Vendimit Kuadër 2002/584.

një angazhim tepër të lartë nga të gjitha shtetet anëtare të Bashkimit Europian, angazhim i cili gjithashtu kërkon një vullnet të fortë dhe një besim reciprok. Shqipëria, duke mos qenë ende pjesë e këtij realiteti, ka ende mundësinë e përshtatjes paraprake të legjisllacionit kombëtar me legjisllacionin europian. Realizimi i kësaj përshtatje duhet të respektojë parimet e njohura të së drejtës si dhe kushtetutën në të cilën janë garantuar të drejtat dhe liritë themelore të njeriut.

Bibliografia

- Burimet ligjore

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, datë 21.10.1998.

Konventa e Këshillit të Europës “Për ndihmë të ndërsjellë juridike në fushën penale”, datë 20.04.1959, së bashku me protokollin shtesë, datë 17.03.1978, ratifikuar me ligjin nr. 8498, datë 10.06.1999.

Protokolli i dytë shtesë i Konventës së KE-së “Për ndihmë të ndërsjellë juridike në fushën penale”, datë 08.11.2001, ratifikuar me ligjin nr. 8883, datë 18.04.2002.

Konventa e Bashkimit Europian “Mbi asistencën gjyqësore në fushën penale ndërmjet shteteve anëtare të Bashkimit Europian”, krijuar me aktin e Këshillit Europian datë 29 maj 2000, Fletore Zyrtare C/197, datë 12.07.2000 dhe protokollin, shtesë i saj, datë 16.10.2001.

Konventa e Këshillit të Europës “Mbi transferimin e procedimeve në çështjet penale”, datë 15.05.1972, ratifikuar me ligjin nr. 8497, datë 10.06.1999.

Konventa e Këshillit të Europës “Për ekstradimin” dhe dy protokollin e saj shtesë, ratifikuar me ligjin nr. 8322, datë 02.04.1998.

Kodi Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë, ligji nr. 7905, datë 21.03.1995 (gjendja e ndryshuar).

Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë, ligji nr. 7895, datë 27.01.1995, (gjendja - ndryshuar).

Literaturë

Komentari i Kodit të Procedurës Penale, Halim Islami, Artan Hoxha, Ilir Panda, Botimet Morava, Maj 2003.

E Drejta Penale Ndërkombëtare, viti 2001, botuar nga Fondacioni Gjerman për Bashkëpunim Ndërkombëtar Juridik (IRZ).

Bazat e bashkëpunimit ndërkombëtar në çështjet penale, viti 2001, dr. Thomas Hacker, kryeprokuror në Hanover, Gjermani.

Demokratizimi i legjislacionit penal, Halim Islami, Tiranë 2000, "Luarasi".

E drejta komunitare, cikël leksionesh, viti 2005, Ledi Bianku, Xhezair Zaganjori.

Gentjan Skara¹

BE, SI NXITËS I SIGURISË DHE I PAQES NË PERIFERI TË SAJ: RASTI I BALLKANIT PERËNDIMOR

Abstrakt

Nevoja për sigurimin e stabiliteti dhe për përhapjen e paqes në vendet fqinje ka qenë motivi kryesor i BE-së në Ballkanin Perëndimor që pas rënies së murit të Berlinit. Anëtarësia e premtuar, bazuar në kushtëzueshmëri ka qenë deri diku e suksesshme por, megjithatë, për sa i përket sigurisë duket se ky rajon vuan ende prej “shteteve të dobët” dhe “protektorateve” të cilët mund ta destabilizojnë atë.

Përhapja e operacioneve civile dhe ushtarake riformuloi politikën e jashtme të BE-së që u sfidua prej shpërbërjes së Jugosllavisë. Në këtë kontekst, dështimi i BE-së për të përfunduar luftën në Bosnjë dhe hezitimi për ndaljen e konfliktit në Kosovë në vitin 1999 nxorën në pah paaftësinë e saj për të vepruar si një lojtar ndërkombëtar. Prandaj BE-ja paraqiti operacionet ushtarake dhe civilë për t’u marrë me vendet postkonfliktuale si prioritetin e saj kryesor duke i prezantuar ato si pjesa thelbësore e veprimit të saj të jashtëm. Gjithashtu, veprimet e BE-së në skenën ndërkombëtare udhëhiqen nga principet e demokracisë, shtetit të së drejtës, të drejtave të njeriut si veprime që plotësojnë njëra-tjetrën dhe që nevojiten për arritjen e sigurisë dhe paqes brenda dhe përtej kufijve të saj.

¹ **Shënime biografike:** Gentjan Skara është lektor në Departamentin Juridik në Universitetin Beder. Ai u diplomua për juridik në Universitetin e Tiranës dhe ka përfunduar një Master për “Studimet Europiane” në Universitetin Epoka me temë: “*Menaxhimi i operacioneve civile të BE-së: rasti i EULEX-it në Kosovë*”. Në tetor 2012 ai u përfshi në programin e Masterit “Për të Drejtën Europiano-Juglindore dhe Integrimin Europian”, në Universitetin e Gracit, në Austri, dhe është duke shkruar disertacionin e Masterit me temë: “*Procesi i Stabilizim-Asocimit si një mekanizëm integrues për Ballkanin Perëndimor: rasti i Shqipërisë*”.

Ky artikull analizon se sa të suksesshëm kanë qenë operacionet civile dhe ushtarake për sigurimin e stabilitetit dhe vendosjen e shtetit të së drejtës në vendet postkonfliktuale duke u përqendruar te vendet e Ballkanit Perëndimor. Hipoteza ime është se nëpërmjet pozicionimit të këtyre operacioneve në vendet e Ballkanit Perëndimor, BE-ja nxit mbajtjen e sigurisë dhe vendosjen e shtetit të së drejtës për të ndihmuar këto vende që të realizojnë udhëtimin e tyre drejt të ardhmes europiane.

Fjalë kyçe: Bashkimi European, politika e jashtme, PPSM, Ballkani Perëndimor, EULEX.

Mbrojtja dhe siguria në kuadrin e BE-së

Politika e Përbashkët e Sigurisë dhe Mbrojtjes² shpesh përkufizohet si mjet i suksesshëm i politikës së jashtme të BE-së lidhur me shtetet postkonfliktuale që synojnë nxitjen e sigurisë dhe vendosjen e shtetit të së drejtës. Megjithatë, në të shkuarën çështjet e sigurisë dhe mbrojtjes kanë shkaktuar mosmarrëveshje për shkak të sovranitetit, udhëheqësve politikë dhe frikës së një lufte tjetër në Europë. Përpyekjet për themelimin e një politike të përbashkët të mbrojtjes kanë filluar që prej vitit 1952, një vit pas formimit të Komunitetit European të Qymyrit dhe Çelikut (KEQÇ) brenda kuadrin të të ashtuquajturit projekt të Komunitetit European të Mbrojtjes, i cili u hodh poshtë nga Parlamenti francez në vitin 1954. Ky traktat ambicioz synonte të themelonte një komunitet mbikombëtar me forca ushtarake të përbashkëta, buxhet dhe institucione të veçanta në përputhje me frymën që karakterizonte KEQÇ-në. Një tjetër përpyekje për të themeluar mbrojtjen e përbashkët ishte i ashtuquajturi “*Plani Fouchet*”, i vitit 1962. Edhe ky plan dështoi për shkak të vullnetit politik të udhëheqësve europianë për të mos u bashkuar në çështjet e mbrojtjes³. Që prej asaj kohe e deri me paraqitjen e Aktit Unik European (AUE)⁴, diskutimi për çështjet e mbrojtjes ndërmjet anëtarëve të Komunitetit Ekonomik European (KEE) konsiderohej si tabu. Neni 30/6 i AUE-s si dispozitë detyruese për anëtarët e BE-së vendosi koordinimin ndërmjet anëtarëve europianë edhe për çështjet e sigurisë europiane. Fjala “mbrojtje”

² Pas hyrjes në fuqi të Traktatit të Lisbonës Politika Europiane e Sigurisë dhe Mbrojtjes (PESM) ndryshoi emërtim dhe u quajt Politika e Përbashkët e Sigurisë dhe Mbrojtjes (PPSM).

³ Simon Duke, *The Elusive Quest for European Security: From ECD to CFSP*, (London: Macmillan Press LTD, 2000), f. 18-67.

⁴ Akti Unik European [1986] OJ L169.

nuk u përfshi qëllimisht⁵. Fundi i Luftës së Ftohtë solli transformimin e arenës ndërkombëtare si pasojë e shpërbërjes së Bashkimit Sovjetik, krijimit të shteteve të rinj në Europë dhe ribashkimit të Gjermanisë. Këto ndryshime vendosën në agjendën europiane dy çështje: a) ambicien për pasjen e një zëri të përbashkët për politikën e jashtme të BE-së, dhe b) ambicien për të luajtur një rol të rëndësishëm në politikat ndërkombëtare.

Traktati i Mاستrihtit (Traktati i Bashkimit European (TBE))⁶ përbënte një hap të ri për integrimin europian dhe çështjet e sigurisë duke përdorur për herë të parë fjalët “politikë e përbashkët e mbrojtjes”⁷. Përpara Traktatit të Mاستrihtit çështja nëse Europa duhej të ishte një “fuqi” ishte hipotetike⁸. Krijimi i Shtyllës së Dytë mundësoi një shtysë për zhvillimin e ardhshëm të BE-së si aktor global.

Pavarësisht krijimit të Politikës së Përbashkët të Jashtme dhe të Sigurisë (PPJS), që ishte një hap pozitiv, Bashkimi European dështoi në parandalimin e përshkallëzimit të mëtejshëm të konfliktit në Ballkan. Mungesa e një strategjie të përbashkët të BE-së për të adresuar shpërbërjen e ish-RFJ-së shfaqti paaftësinë e saj për të marrë përgjegjësi për eksportimin e sigurisë. Pas firmosjes në tetor të vitit 1997 të Traktatit të Amsterdimit, u vendosën detyrat e Petersburgut që i mundësuan BE-së bazën ligjore për të ndërhyrë për çështje që kanë të bëjnë me “detyrat humanitare dhe të shpëtimit, detyrat paqeruajtëse dhe detyrat e forcave sulmuese në menaxhimin e krizave, duke përfshirë dhe vendosjen e paqes”⁹. Sërish, dobësia e shfaqur nga BE-ja gjatë reagimit për rastin e Kosovës tregoi paaftësinë e saj për menaxhimin efikas të krizave.

Të lodhur nga dështimi i BE-së për të siguruar zgjidhje diplomatike për konfliktin e Kosovës brenda Europës, në dhjetor të vitit 1998, një Samit Franko-Britanik u organizua në Saint Malo, i cili shërbeu edhe si pikë kthese për BE-në për çështjet e mbrojtjes

⁵Akti Unik European, Neni 30/6/a “Palët kontraktuese mendojnë se një bashkëpunim më i ngushtë në çështjet e sigurisë europiane mund të kontribuojë në mënyrë thelbësore për zhvillimin e identitetit europian në çështjet e politikës së jashtme. Ata janë të gatshëm të koordinojnë pozicionet e tyre më ngushtësisht mbi aspektet politike dhe ekonomike të sigurisë”, http://ec.europa.eu/economy_finance/emu_history/documents/treaties/singleeuropeanact.pdf parë për herë të fundit në 9 nëntor 2012.

⁶Traktati i Bashkimit European [1992] OJ C191.

⁷Ibid, Titulli 1, Neni B.

⁸L. Cohen - Tanugi, *An Alliance at Risk: The United States and Europe since September 11* (Baltimore - London: John Hopkins University Press, 2003), f. 73.

⁹Traktati i Amsterdimit [1997] OJ C340, Neni 17/2.

dhe të sigurisë. Dy vende anëtare të BE-së (Franca dhe Britania e Madhe) ranë dakord të miratonin një deklaratë që synonte krijimin e një kapaciteti për mbrojtjen të Bashkimit European pa rrezikuar marrëdhëniet me NATO-n. Deklarata thekson:

1. Nevojën e BE-së për të qenë në pozicionin e duhur për të luajtur një rol të rëndësishëm në skenën ndërkombëtare duke përdorur detyrat që i janë dhënë nga Traktati i Amsterdimit brenda kuadrit të PPJS-së.

2. Unioni duhet të ketë kapacitetin për veprime autonome si reagim ndaj krizave ndërkombëtare, duke vepruar në përputhje me detyrimet përkatëse në NATO.

Samiti shërbeu si gur themeli për rolin e ardhshëm të BE-së në arenën ndërkombëtare. Tashmë për herë të parë, udhëheqësit e saj kanë një pikëpamje të qartë për politikën e jashtme të BE-së dhe qëllimet që duhen arritur. Ideja e Saint-Malos u zhvillua më tej gjatë muajve në vijim. Një vit më vonë (1998) Samiti i Këlnit, i cili ishte një thirrje për shpejtimin e procesit të europianizimit të sigurisë, vendosi themelimin e strukturave të reja brenda Këshillit për t'u marrë me Politikën Europiane të Sigurisë dhe Mbrojtjes: Komitetin Politik të Sigurisë (KPS) dhe Komitetin Ushtarak të Bashkimit European (KUBE)¹⁰. Që prej asaj kohe çështjet e mbrojtjes dhe sigurisë janë zhvilluar shpejt. Një tjetër hap i rëndësishëm për zhvillimet e mëvonshëm të PESM-së është e ashtuquajtura "Marrëveshja Berlin Plus" e cila e lejon BE-në që të përdorë asetet dhe kapacitetet e NATO-s kur ajo nuk përfshihet si organizatë¹¹. Traktati i Lisbonës shtoi një seksion të ri në Kapitullin 2 të Titullit V të TBE-së që parashtron organizimin dhe funksionimin e PPSM-së. Ky seksion përbëhet nga nenet 42-46. Çështjet më kryesore të këtyre neneve janë: ndryshimi i emrit nga Politika Europiane e Sigurisë dhe Mbrojtjes të Politika e Përbashkët e Sigurisë dhe e Mbrojtjes; vendosja e detyrave të Petersburgut si qëllimi i operacioneve civile dhe ushtarake në kuadër të PPSM-së; vendosja e dispozitës që mund të çojë në krijimin e një ushtrie të vetme europiane¹²; PPSM si pjesë integrale e PPJS¹³ dhe marrëdhëniet PPSM-NATO¹⁴. Dy risitë kryesore të këtyre

¹⁰ KPS-ja është përgjegjëse për operacionet civile të PESM-së, ndërsa KUBE-ja përgjigjet për të gjithë operacionet ushtarake.

¹¹ Samiti i Këshillit European të Helsinkit, *Konkluzionet e Presidencës*, 10-11 dhjetor 1999.

¹² Version i Konsoliduar i Traktatit të Bashkimit European dhe i Traktatit të Funksionimit të Bashkimit European [2010] OJ C83/01, Neni 42/2.

¹³ Ibid, Neni 42/1.

¹⁴ Ibid, Neni 42/2/2.

neneve janë se, së pari, përcaktimi i NATO-s si udhëheqëse në çështjet e sigurisë (NATO e para) dhe, së dyti, theksimi se anëtarësimi në PPSM nuk dëmton detyrimin e disa vendeve anëtare që mund ta shohin realizimin e mbrojtjes së përbashkët në kuadër të NATO-s¹⁵.

Ndërtimi i një organizate sigurie nëpërmjet PPSM-së

Më 28 qershor 1991, ministri i Jashtëm i Luksemburgut bëri një deklaratë ku theksoi se: “[...] nëse ka një problem që mund të zgjidhet prej europianëve ai është problemi Jugosllav. Ky është një vend evropian dhe nuk lidhet me dëshirën e amerikanëve. Nuk lidhet me dëshirën e askujt tjetër”¹⁶. Nëpërmjet kësaj deklarate, Poos i referohej marrëveshjes së mundshme ndërmjet 12 anëtarëve të Komunitetit Evropian për të parandaluar ofensivën ushtarake të Beogradit kundër Sllovenisë dhe Kroacisë. E ashtuquajtura “Ora e Europës”, doli se ishte një dështim për shkak të mungesës së unitetit në vendimmarrje për çështjet e sigurisë së jashtme. Sërish BE-ja dështoi për të evituar konfliktin në Bosnjë Hercegovinë dhe më pas atë në Kosovë për shkak të mungesës së kapaciteteve ushtarake për parandalimin e konfliktit; mungesës së unitetit politik për të adresuar krizat dhe mungesës së eksperiencës¹⁷. Në këtë kontekst, ndërhyrja e NATO-s ishte vendimtare.

Ballkani Perëndimor ka qenë një sfidë e madhe për BE-në për sa i përket sigurisë së saj. Dështimi për të parandaluar konfliktet në oborrin e saj të mbrapsëm, ka artikuluar pyetjen nëse BE-ja ka kapacitetet e saj për t’u marrë me shoqëritë postkonfliktuale si Ballkani Perëndimor? Si pikë kthese për këtë shërbeu Samiti i Saint-Malos i ndjekur nga “Marrëveshja Berlin Plus” dhe Strategjia Europiane e Sigurisë. Miratimi i Strategjisë Europiane të Sigurisë dha i BE-së - ambicie të mëdha për të qenë një aktor botëror¹⁸ nëpërmjet përcaktimit të tre objektivave:

a) Përballja me rreziqet nëpërmjet zhvillimit të një politike për parandalimin e konfliktit që kombinon kapacitetet ushtarake dhe civile.

¹⁵ Ibid, Neni 42/2/2 së bashku me “Protokolli 11”.

¹⁶ Cituar nga C. J. Smith “Conflicts in the Balkans and possibility of a European Union common foreign and security policy”, *International Relations*, no. 2 (1996), f. 21.

¹⁷ Roberto Belloni, “European integration and the Western Balkans: lessons, prospects and obstacles”, *Journal of Balkan and Near Eastern Studies* (15 shtator 2009), 11:3, 314-316.

¹⁸ Sven Biscop, *The European Security Strategy: A Global Agenda for Positive Power* (England: Ashgate Publishing, 2005), f. 135.

b) Eksportimi i sigurisë në vendet fqinje.

a) Promovimi i nismave shumëpalëshe efikase dhe zhvillimi i të drejtës ndërkombëtare sipas Kartës së OKB-së¹⁹.

Pas kësaj, BE-ja filloi pozicionimin e kapaciteteve ushtarake dhe civile çka është cilësuar si “një nga revolucionet politike më të mëdha të fundshekullit të njëzetë dhe fillimshkullit të njëzetënjëtë”²⁰. Aktualisht, BE-ja ka pozicionuar rreth 33 misione, disa prej të cilëve janë në veprim e sipër, që variojnë në natyrë dhe shtrirje. Pozicionimi i operacioneve ushtarake dhe civile në Ballkanin Perëndimor ka rezultuar një mjet i suksesshëm për vendosjen e sigurisë së shtetit të së drejtës dhe për një shtet funksional. Qëllimi kryesor i misioneve ka qenë parandalimi i përshkallëzimit të mëtejshëm të konflikteve në shoqëri të ndara sipas linjave etnike dhe, së dyti, kthimi i rajonit në një vend më stabil dhe më të sigurt dhe vendosja e sigurisë në shtetet ku mungesa e saj ndikon sigurinë europiane. Njëkohësisht vendet e BP-së kanë qenë provë për BE-në, së pari, për të përcaktuar marrëdhëniet me NATO-n sipas “Marrëveshjes Berlin Plus” dhe, së dyti, për të parë nëse PPSM ka kapacitete dhe burime për menaxhimin e rajonit si i vetmi lojtar për sa i përket sigurisë. Më poshtë jepet një përmbledhje e misioneve të dislokuar në Ballkanin Perëndimor në kuadër të PPSM-së.

Pas katër vjetësh zhvillimesh teorike, në janar të vitit 2003 BE-ja hyri në fazën operative duke vendosur misionin e parë (**MPBE**) të saj në Bosnjë Hercegovinë. Pavarësisht kritikave mbi efikasitetin e tij, mandati i misionit u zgjat deri në dhjetor të vitit 2009. Për këtë arsye, misioni u përkufizua si “model prove dhe kavie eksperimenti”²¹. MPBE-ja është një mision joekzekutiv policor dhe mandati i tij përfshin monitorimin, këshillimin dhe inspektimin e aktiviteteve.

Misionit mund t’i jepet merita për arritjen e tre objektivave kryesor:

1. MPBE-ja ka treguar aftësinë e BE-së për t’ia dalë mbanë në operacionet në kuadër të PPSM-së;

¹⁹ European Council, *European Security Strategy: A Secure Europe in a Better World* (Bruksel: 12 dhjetor 2003), <http://www.consilium.europa.eu/uedocs/cmsUpload/78367.pdf>. Parë për herë të fundit në 7 nëntor 2012

²⁰ Mark Webber. et al, “The governance of European Security”, *Review of International Studies* No. 30 (2004), 14.

²¹ Michael Merlingen, “The EU Police Mission in Bosnia and Herzegovina (EUPM)”, in *European security and Defence Policy: The First 10 Years (1999-2009)*, ed Giovanni Grevi et al. (Paris: The European Union Institute for Security Studies, 2009), f. 162

2. MPBE-ja ka transformuar policinë boshnjake nga një polici e ndarë etnikisht në një njësi profesioniste.

3. MPBE-ja ka ndihmuar për zbatimin e normave dhe standardeve të BE-së në sektorin e policisë²².

Pavarësisht arritjeve mbeten ende probleme, si për shembull, trashëgimia e Dejtonit, mosbesimi ndërmjet politikanëve bazuar tek etnia dhe niveli i ulët i ekonomisë, të cilat mund të çojnë në çdo kohë drejt destabilizimit të rajonit dhe mund të përbëjnë një dështim për BE-në. Trashëgimia e Dejtonit ka ndërtuar një shtet kushtetues qendror të dobët duke mundësuar një qeverisje të ndarë dhe institucione të dobëta. Mosbesimi ndërmjet politikanëve që bazohet tek etniciteti ka bërë që Bosnjë Hercegovina të jetë një shtet thuajse i dështuar. Një tjetër sfidë është sektori ekonomik i cili është i pa zhvilluar dhe për shkak të ndarjes etnike Bosnjë Hercegovina po dështon për të tërhequr IHD dhe donatorë të tjerë.

Vetëm tre muaj pas fillimit të operacionit MPBE në kuadër të PPSM në Ballkan u vendos një mision tjetër: Operacioni **CONCORDIA**. Ky ishte një operacion ushtarak i cili u zhvillua në vijim të misionit *Essential Harvest* të NATO-s që ishte në terren që prej vitit 2001 dhe që synonte sigurimin e një mjedisi të qëndrueshëm dhe të sigurisë në kuadër të Marrëveshjes së Ohrit. Misioni përbënte një hap të rëndësishëm për konsolidimin e rolit të BE-së në Ballkan sepse ai hodhi themelet për rolin e BE-së si aktor ushtarak dhe në të njëjtën kohë ishte një sfidë për NATO-n. Megjithatë, për shkak të pozicionimit të misioneve të saj, duket se Ballkani Perëndimor mbetet ende thembra e Akilit për të ardhmen e PPSM.

Krahas misionit të tij policor civil **PROXIMA** në Republikën ish-Jugosllave të Maqedonisë që synon mbështetjen e forcave të policisë vendore për t'u zhvilluar sipas standardeve europiane, BE-ja gjithashtu ka nisur operacionin **EUFOR ALTHEA** në Bosnjë Hercegovinë. Ky mision mori rolin e SFOR-it për stabilizimin, i cili deri në atë kohë ishte mbuluar nga NATO. Në këtë operacion zhvilluar në kuadër të Marrëveshjes Berlin Plus, BE-ja ka mundësuar një kontribut aktiv për minimizimin e rreziqeve të ardhshëm për destabilizimin e rajonit²³.

²² Michael Merlingen, "The EU Police Mission in Bosnia and Herzegovina (EUPM)", f. 165-170.

²³ Islam Jusufi, "Europeanizing the Western Balkans through Military and Police Missions: The cases of Concordia and Proxima in Macedonia", *Belgrade Center for European Integration and The Vienna Institute for International Economic Studies*, Vol.2, No.1 (2004), f. 10.

Në 16 shkurt të vitit 2008, një ditë përpara shpalljes së Deklaratës së Pavarësisë nga Serbia të Kosovës, BE-ja vendosi të fillonte misionin më të madh për menaxhimin e krizave **EULEX-it në Kosovë**, i cili synonte asistimin e autoriteteve kosovare për konsolidimin e shtetit të së drejtës dhe të kontribuonte për krijimin e një mjedisi të sigurt për të gjithë popullatën e Kosovës pavarësisht përkatësisë etnike. Me gjithë kundërshtitë e serbëve për të pasur marrëdhënie me misionin e BE-së dhe për të lejuar që EULEX-i të përmbushë detyrat e tij, misioni ia arriti që të vepronte me kapacitet të plotë në gjashtë prill të vitit 2009. Duhet theksuar se EULEX-i është operacioni më ambicioz që është ndërmarrë në kuadër të PPSM-së me kompetencë ekzekutive për të ndërhyrë në punët e Kosovës. Detyrat e përshkruara në Aktin e Përbashkët (*Joint Action*)²⁴ të Këshillit janë monitorimi, orientimi dhe këshillimi i autoriteteve kosovare gjatë progresit të tyre drejt stabilitetit dhe shtetit funksional. Pavarësisht kritikëve që thonë se misioni EULEX-it në Kosovë nuk është efikas²⁵, ai ka parandaluar përshkallëzimin e mëtejshëm të konfliktit Kosovë-Serbi.

PPSM si nxitës i sigurisë dhe shtetit të së drejtës në Ballkanin Perëndimor

Shtetet e Ballkanit Perëndimor përbëjnë një sfidë të madhe për politikën e BE-së për shkak të problemeve ekonomike dhe shoqërore. Pavarësisht dështimit të BE-së për të vepruar në Ballkanin Perëndimor gjatë viteve 1990, rajoni mbetet një shqetësim i BE-së. Siç thekson dhe Përfaqësuesi i Lartë për PPJS, Javier Solana:

*“Eksperienca në Ballkan ka qenë e hidhur për Bashkimin European. Por, megjithatë, unë besoj se ajo gjithashtu na ka dhënë një mundësi. Ajo përbën një provë për vullnetin tonë kundrejt rajonit, për një Europë më të zgjeruar dhe për një politikë të jashtme dhe të sigurisë më të maturuar. Ballkani ka treguar se Bashkimi European nuk mund të mbetet më një forcë për paqen që thjesht ofron shembuj. Ai duhet që gjithashtu të jetë i drejtpërdrejtë në mbrojtjen e vlerave bazë të demokracisë, të drejtave të njeriut dhe të shtetit të së drejtës mbi të cilat është themeluar”*²⁶.

²⁴ Council Joint Action 2008/124/ CFSP of 4 February 2008.

²⁵ European Court of Auditors, *European Union Assistance to Kosovo Related to the Rule of Law*, Special Report No. 18, 2012.

²⁶ Solana, Javier, “The Development of the CFSP and the Role of the High Representative”, *Institute of European Affairs*, Dublin, 30 mars 2000.

Siç mund të shihet, stabilizimi i Ballkanit Perëndimor ka qenë një sfidë e madhe për misionet e BE-së. Pas luftës në Kosovë, shqetësimi kryesor i BE-së është se si ajo mund të veprojë pozitivisht për të ushtruar një ndikim të fuqishëm në BP, i cili ka vuajtur nga konfliktet dhe destabiliteti? Ekziston konsensus ndërmjet udhëheqësve të BE-së dhe politikave të SHBA-së për faktin se anëtarësimi në BE i BP-së është e vetmja strategji e mundshme për demokracinë dhe rivitalizimin ekonomik²⁷. Në këtë kontekst, Missiroli argument se BE-ja ka ndërmarrë dy politika të ndryshme kundrejt fqinjëve të saj. Politika e parë synon stabilizimin bazuar në stabilizimin bazuar te bashkëpunimi rajonal. Politika e dytë synon integrimin bazuar te kushtëzueshmëria. Në rastin e BP-së, këto dy politika u shkrinë së bashku duke shkaktuar ndonjëherë edhe rrëmujë²⁸. Pas Marrëveshjes së Dejtonit, BE-ja vendosi Qasjen e saj Rajonale e cila dështoi pasi nuk parandaloi konfliktin në Kosovë. Një strategji e re u miratua në vitin 1999 për të mundësuar sigurinë në Ballkanin Perëndimor nëpërmjet Paktit të Stabilitetit për Europën Juglindore. Sërish kjo strategji e kuptueshme për parandalimin e konfliktit për të vendosur sigurinë dhe paqen u sfidua nga lufta ndëretnike në Republikën ish-Jugosllave të Maqedonisë në vitin 2003. Në përgjigje të kësaj situate, BE-ja themeloi një politikë të re (Procesin e Stabilizim-Asocimit) si një karotë për BP-në që rajoni të arrijë stabilitetin, sigurinë dhe prosperitetin dhe premtoi anëtarësim pasi vendet të kishin përmbushur Kriteret e Kopenhagës. Kjo politikë ka qenë deri diku e suksesshme, por megjithatë rajoni ende vazhdon të jetë një gur prove nëse BE-ja si fuqi transformuese zotëron kapacitetet e nevojshme për të përhapur vlerat mbi të cilat është themeluar si një projekt paqeje në oborin e saj të mbrapëm²⁹.

Në studimin e tij, Higoshima argumenton se nevoja për të arritur stabilitet dhe paqe ka qenë motivi kryesor për zgjerimin e

²⁷ Milada Anna Vucadova, "Promoting Political Change and Economic Revitalization in the Western Balkans: The Role of the European Union", *The National Council for Eurasian and East European Research*, (shtator 2006), f. 4-6.

²⁸ Antonio Missiroli, "The EU and Its Changing Neighbourhoods: stabilization, integration and partnership" in Judy Batt, Dov Lynch, Antonio Missiroli, Martin Ortega and Dimitrios Triataphyllou, *Partners and neighbours: a CFSP for a Wider Europe* (Chaillot Paper 64, Institute for Security Studies European Union Paris 2003), f. 9.

²⁹ Bjørn Møller, "The EU as a Security Actor: Security by Being" and "Security by Doing", *Danish Institute for International Studies DIIS* (2005), f. 23-26.

Bashkimit European drejt Europës Lindore dhe ka ndryshuar strategjinë e zgjerimit, duke e bërë të gjithë këtë për hir të çështjes së sigurisë³⁰. Në rastin e vendeve të Ballkanit Perëndimor frika për destabilizim të rajonit dhe ndikimi që kjo mund të ketë mbi Bashkimin European, ka bërë që udhëheqësit politikë të themelojnë strategjinë e PSA-së duke iu referuar sigurisë së Europës. Pozicionimi i kapaciteteve civile dhe ushtarake në Ballkanin Perëndimor ka qenë një mjet i suksesshëm për arritjen e stabilitetit në rajon dhe për të ndihmuar këto vende drejt anëtarësimit në BE. Brenda një periudhe të shkurtër është arritur stabiliteti dhe vendet e BP-së kanë bërë progres në arritjen e kriterëve për anëtarësim. Por probleme të brendshme të rajonit, si e ardhmja e Kosovës si shtet i pavarur, situata në Bosnjë Hercegovinë dhe mosmarrëveshjet mbi emrin e Republikës ish-Jugosllave të Maqedonisë rrezikojnë sigurinë e BE-së dhe ngrenë pikëpyetje mbi rolin e saj si promotor i sigurisë.

Konkluzione

Nga këndvështrimi i BE-së ideja për një mbrojtje të përbashkët është parë me hezitim për arsye politike dhe kombëtare. Krijimi i PPJS-së mundësoi ambicien e BE-së që ajo të luajë një rol në fushën ndërkombëtare si organizatë sigurie. Pavarësisht dështimit për të parandaluar konfliktet në Ballkanin Perëndimor, udhëheqësit e BE-së vendosën të krijojnë (PPSM), çka rezultoi si një mjet i suksesshëm për mbajtjen e sigurisë dhe promovimin e shtetit të së drejtës në shoqëritë postkonfliktuale.

Përhapja e PPSM riformësoi politikën e jashtme të BE-së. BE-ja u kthye në një organizatë të rëndësishme për çështjet e sigurisë. Duke pozicionuar misionet nëpër kontinente të cilët variojnë në qëllim, masë dhe mandat, BE-ja po ushtron një ndikim të fuqishëm në vendet postkonfliktuale me qëllim zbatimin e standardeve dhe vlerave mbi të cilat ajo është themeluar.

Misionet që BE-ja ka pozicionuar në BP kanë luajtur rol të dyfishtë. Së pari, vendosja e misioneve ka ndihmuar që BP-ja të bëhet një rajon më i sigurt duke pasur parasysh luftërat ndëretnike që kanë ndodhur gjatë viteve 1990 dhe, së dyti, ata po luajnë një rol vendimtar për vendosjen e shtetit të së drejtës me qëllim që të bëjnë realitet anëtarësimin në BE.

³⁰ Atsuko, Higashino, "For the Sake of 'Peace and Security?': *The Role of Security in the European Union Enlargement Eastwards, Cooperation and Conflict*, Vol. 39 (2004), f. 347.

Bibliografia

- Akti Unik European [1986] OJ L169.
- Belloni, Roberto, "European integration and the Western Balkans: lessons, prospects and obstacles", *Journal of Balkan and Near Eastern Studies*, 15 shtator 2009.
- Biscop, Sven, *The European Security Strategy: A Global Agenda for Positive Power*, England: Ashgate Publishing, 2005.
- Cohen-Tanugi, L. *An Alliance at Risk: The United States and Europe since September 11*, Baltimore - London: John Hopkins University Press, 2003.
- Council Joint Action 2008 /124/ CFSP of 4 February 2008.
- Duke, Simon, *The Elusive Quest for European Security: From ECD to CFSP*, London: Macmillan Press LTD, 2000.
- Deklaratë e Përbashkët hartuar në Samitin Franko-Britanik të Saint-Malos, Francë, 3-4 dhjetor 1998.
- European Council, *European Security Strategy: A Secure Europe in a Better World*. Brussels: 12 December 2003, <http://www.consilium.europa.eu/uedocs/cmsUpload/78367.pdf> . Parë për herë të fundit më 7 nëntor 2012.
- European Court of Auditors, *European Union Assistance to Kosovo Related to the Rule of Law*, Special Report, no. 18, 2012.
- Helsinki European Council, *Presidency Conclusions*, 10-11 dhjetor 1999.
- Higashino, Atsuko, "For the Sake of 'Peace and Security'? The Role of Security in the European Union Enlargement Eastwards", *Cooperation and Conflict*, Vol. 39, 2004.
- Jusufi, Islam, "Europeanizing the Western Balkans through Military and Police Missions: The cases of Concordia and Proxima in Macedonia", *Belgrade Center for European Integration and The Vienna Institute for International Economic Studies*, Vol. 2, No.1, 2004.
- Merlingen, Michael "The EU Police Mission in Bosnia and Herzegovina (EUPM)", in *European security and Defence Policy: The First 10 Years (1999-2009)*, ed Giovanni Grevi et al. Paris: The European Union Institute for Security Studies, 2009.
- Missiroli, Antonio, "The EU and Its Changing Neighbourhoods: stabilization, integration and partnership", in Judy Batt, Dov Lynch, Antonio Missiroli, Martin Ortega and Dimitrios Triataphyllou, *Partners and neighbours: a CFSP for a Wider Europe* (Chaillot Paper 64, Institute for Security Studies European Union Paris 2003).

- Møller, Bjørn, "The EU as a Security Actor: "Security by Being" and "Security by Doing" *Danish Institute for International Studies DIIS*, 2005.
- Smith, C. J., "Conflicts in the Balkans and possibility of a European Union common foreign and security policy", *International Relations*, no. 2, 1996.
- Solana, Javier, "The Development of the CFSP and the Role of the High Representative", *Institute of European Affairs*, Dublin, 30 mars 2000.
- Traktati i Amsterdami [1997] OJ C340.
- Traktati i Bashkimit Europian [1992] OJ C191.
- Versioni i Konsoliduar i Traktatit të Bashkimit Europian dhe Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Europian [2010] OJ C83/01.
- Vucadova, Anna Milada, "Promoting Political Change and Economic Revitalization in the Western Balkans: The Role of the European Union", *The National Council for Eurasian and East European Research*, 2006.
- Webber, Mark. et al, "The governance of European Security", *Review of International Studies* no. 30, 2004.

Tatjana Slijepèeviaè

PERSPJEKTIVA E RE PËR BALLKANIN PERËNDIMOR BRENDA STRATEGJISË SË RAJONIT TË DANUBIT

Hyrje

Bashkëpunimi rajonal shtrihet në themelet e të gjithë strukturës së Bashkimit European dhe është një model që e ka provuar suksesin e tij, veçanërisht në një rreth aq të larmishëm siç është Europa. Përgjatë ekzistencës së tij, Bashkimi European e ka ndryshuar vazhdimisht qëllimin e tij kryesor, ndërsa, duke konsideruar ndodhitë e fundit në zemër të Europës, më saktësisht në Ballkanin Perëndimor, ai ka fituar një vlerë më të madhe si mjet pajtimi, stabiliteti dhe prosperiteti maksimal. Në rastin e Ballkanit Perëndimor, bashkëpunimi rajonal qëndron si një parakusht i domosdoshëm për të ardhmen e rajonit në tërësi, si dhe për çdo shtet individual, kryesisht kur bëhet fjalë për perspektivën e tyre europiane. Vendet e Ballkanit Perëndimor që më parë ishin pjesë e të njëjtit shtet dhe që tani janë vende fqinje të lidhura historikisht dhe gjeografikisht me njëri-tjetrin nuk kanë zgjidhje tjetër përveçse të bashkëpunojnë midis tyre.

Për më tepër, të gjitha këto vende kanë mbulim territorial, popullsi, ekonomi dhe burime respektivisht të vogla, prandaj është në interesin më të mirë të tyre t'i bashkojnë potencialet e tyre dhe të veprojnë si rajon, më tepër se sa aktorë individualë. Megjithatë, bashkëpunimi rajonal, kryesisht nënkupton bashkëpunim midis vendeve të Ballkanit Perëndimor, gjë që mund të mos jetë e mjaftueshme duke qenë se vendet përballen me të njëjtat sfidat, mungesën e përvojës dhe burimeve për të zgjidhur çështjet problematike dhe shpeshherë nuk mund të ndihmojnë njëra-tjetrën. Bashkëpunimi i ngushtë, partneriteti dhe kontakti me vendet anëtare të BE-së më të zhvilluara dhe më me përvojë do t'u siguronte vendeve të Ballkanit Perëndimor mundësitë për mësim të drejtpërdrejtë, adoptim të praktikave më të mira dhe përshtatjen të tyre në kontekstin e Ballkanit Perëndimor, gjë që do të rriste maksimalisht zgjidhjen e çështjeve aktuale dhe sfidat në rajon. Strategjia e Rajonit të Danubit i hap saktësisht këto

mundësi Ballkanit Perëndimor duke qenë se ajo influencon jo vetëm shtetet anëtare, por edhe vendet fqinje gjithashtu. Bashkë me të qenit një mënyrë unike për bashkëpunim të ngushtë dhe të drejtpërdrejtë midis vendeve anëtare dhe jo anëtare, ajo krijon gjithashtu një hapësirë për përfshirje dhe kontribut aktiv nga Ballkani Perëndimor në fushat e interesit të përbashkët të parashikuara nga Strategjia e Danubit. Nëse përqafohen plotësisht dhe përdoren më së miri nga vendet e Ballkanit Perëndimor, kjo mundësi, pa dyshim do të rezultojë në zhvillime pozitive të shumta dhe do t'u hapë rrugën zhvillimeve të reja.

Zgjerimi dhe perspektiva europiane e Ballkanit Perëndimor: probleme dhe sfida

Zgjerimi shumë shpesh përkufizohet si politika më e fuqishme e BE-së (Komisioni i Komuniteteve Europiane, 2008, f. 4). Duke filluar me zgjerimin e parë në vitin 1973, të gjitha zgjerimet e mëpasshme kanë rritur kapacitetet ekonomike dhe tregtare të BE-së, stabilitetin dhe sigurinë dhe kanë kontribuar në parandalimin e konflikteve, si dhe forcimin e vlerave demokratike dhe sundimin e ligjit. Zgjerimet, edhe në drejtim të thellimit dhe zgjerimit të BE-së, e kanë ngritur shumë praninë ndërkombëtare dhe rëndësinë e rolit që BE-ja luan në çështjet botërore sot për sot. Në trendin e përgjithshëm të globalizimit, BE-ja ka dalë si një nga aktorët më të shquar të ushtrimit të ndikimit të saj mbi një gamë të gjerë të politikave, të ndryshimit të qëndrimeve dhe të formësimit të pritshmërive të aktorëve të tjerë (Bretherton dhe Vogler, 1999, f. 17).

Si *sui generis*, me arritje që flasin vetë, BE-ja ka një lloj efekti magnet për shumë të tjerë. Ka pasur një interes të madh dhe të qëndrueshëm nga vendet e Ballkanit Perëndimor, Turqia dhe disa vende në Kaukaz, të tilla, si: Gjeorgjia dhe Armenia, Ukraina, Moldavia dhe Bjellorusia, për t'u bërë pjesë e "familjes europiane". Kjo sigurisht paraqet sfida të mëdha dhe kërkon shumë ndryshime dhe reforma, si në BE dhe në vendet që dëshirojnë të bashkohen. Zgjerimi është një çështje jashtëzakonisht e rëndësishme dhe e ndjeshme kur bëhet fjalë për Ballkanin Perëndimor, duke qenë se i gjithë drejtimi i të ardhmes së tij, zhvillimi, prosperiteti dhe stabiliteti në masë të madhe varet nga pranimi i rajonit në BE.

Pritet që vendet e Ballkanit Perëndimor do të jenë grupi i ardhshëm i shteteve për t'u bashkuar me Bashkimin European gjatë dekadës së ardhshme. Çka është e zakonshme për të gjitha këto vende është se secili ndan një perspektivë të fortë për

anëtarësim në BE, gjë që është konfirmuar në disa raste. Kjo u konfirmua në takimin e parë të Këshillit European në Feira në qershor të vitit 2000, në Samitin në Selanik në vitin 2003 dhe në takimet vijuese të BE-së në nivel të lartë, duke përfshirë edhe një takim jozyrtar të ministrave të Jashtëm që u zhvillua në Salzburg, në mars 2006.

Për më tepër, në janar 2006 Komisioni European miratoi një strategji të re: L “Perspektiva e re për Ballkanin Perëndimor brenda Strategjisë së Rajonit të Danubit” me titull: “Ballkani Perëndimor në rrugën drejt BE-së: konsolidimi i stabilitetit dhe rritja e prosperitetit”, duke vlerësuar se përparim i konsiderueshëm ishte bërë që prej Samitit të Selanikut dhe duke përcaktuar masat dhe instrumentet për të përmirësuar politikën e BE-së ndaj Ballkanit Perëndimor.

Deri tani, statusi i vendit kandidat i është dhënë Kroacisë (pranimi, data 1 korrik 2013), Ish-Republikës Jugosllave së Maqedonisë (IRJM) dhe Malit të Zi, ndërsa Serbia, Bosnja dhe Hercegovina, Shqipëria dhe Kosova janë kandidatë potencialë. Duke qenë se të gjithë këto vende kanë qenë nëpër periudha të vështira dhe konflikte dhe përballen ende me shumë probleme dhe sfida, perspektiva europiane do të jetë një epokë e re për to, duke sjellë prosperitet ekonomik dhe social, dhe më shumë paqe dhe stabilitet në rajon. Bazuar në përvojat me zgjerimet e mëparshme, BE-ja ka përmirësuar procesin e negocimit dhe qasjen me shtetet e reja anëtare, duke i dhënë prioritet sundimit të ligjit dhe qeverisjes së mirë, si dhe reformave ekonomike që duhet të ndërmerren para se një vendi t’i lejohet anëtarësimi në BE. Edhe pse Ballkani Perëndimor ka bërë përparime në rrugën e tij drejt BE-së në vitet e fundit, ai është përballur ende me një numër të madh çështjesh që mund të dëmtojnë sigurinë dhe stabilitetin, të ngadalësojnë progresin ekonomik dhe të errësojnë perspektivën europiane të rajonit. Siç është përmendur tashmë, vendet kandidate dhe potenciale kandidate të Ballkanit Perëndimor janë në faza të ndryshme në përparimin e tyre drejt BE-së. Megjithatë, shumica e problemeve dhe pengesave që hasin në rrugën e tyre drejt anëtarësimit janë të natyrës së njëjtë dhe ata mund të trajtohen dhe zgjidhen nëse vendet bashkëpunojnë ngushtë në nivel rajonal, gjë që do të shihet nga afër në seksionin e ardhshëm.

Bashkëpunimi rajonal në Ballkanin Perëndimor

Bashkëpunimi rajonal në Ballkanin Perëndimor është një temë e dëgjuar shpesh dhe është një çështje me rëndësi të madhe

kur flitet për perspektivën europiane të rajonit. Ka pasur shumë sukses dhe progres në intensifikimin e bashkëpunimit rajonal, sidomos në vitet e fundit, falë aktorëve rajonalë dhe partnerëve ndërkombëtarë. Mbështetje dhe nxitje e madhe për bashkëpunim rajonal ka ardhur nga Bashkimi Europian, por ajo ka qenë edhe një nga kushtet kryesore nën Rezolutën 1244/99 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara i përfshirë në të gjitha dokumentet dhe marrëveshjet për sa i përket anëtarësimit në BE të vendeve të Ballkanit Perëndimor. Siç është përmendur tashmë, një nga arsyet përse është duke u këmbëngulur mbi bashkëpunimin rajonal është se vetë BE-ja është themeluar në bashkëpunimin midis rajoneve dhe për shkak se stabiliteti politik, prosperiteti ekonomik dhe social është arritur kryesisht për shkak të marrëdhënieve të ngushta dhe bashkëpunimit në një gamë të gjerë të fushave të ndryshme midis shteteve europiane dhe rajoneve. Për këtë arsye, ai është parë si një model i suksesshëm për t'u ndjekur dhe aplikuar në rajonin e Ballkanit Perëndimor gjithashtu. Nga ana tjetër, afërsia gjeografike e vendeve të Ballkanit Perëndimor, siç është ilustruar në hartën 1.1, lidhjet historike dhe e shkuara e trazuar që ato ndajnë me njëra-tjetrën, e kanë bërë bashkëpunimin rajonal të paevitueshëm dhe edhe më me vend.

Harta 1: Ballkani Perëndimor



Burimi: <http://kos.rec.org>

Me intervale më të gjata apo më të shkurtra paqeje, rajoni është goditur shpeshherë nga lufta, duke filluar me Luftën e Parë dhe të Dytë Ballkanike, Luftën e Parë dhe të Dytë Botërore dhe me luftërat më të fundit në vitet 1990, që pasuan deklaratat e pavarësisë nga ish-republikat jugosllave. Pas secilit prej këtyre konflikteve dhe luftërave, rajoni u rishfaq i integruar në një formë disi të ndryshme dhe funksionoi gjithmonë si një pjesë e strukturave më të mëdha politike, të cilat mund të mbanin rajonin bashkë dhe të mund të garantonin stabilitet.

Sot ekziston një entitet më i madh që mund të marrë përsipër këtë rol dhe përgjegjësi: BE-ja, duke qenë se “BE-ja, me anë të fuqisë së saj për të tërhequr, pra fuqisë për të promovuar norma të caktuara të sjelljes së përshtatshme shtetërore filloi të perceptohet si aktori më i mirë në gjendje për të sjellë stabilitet në këtë rajon tradicionalisht të paqëndrueshme”. (Deleviæ, 2007, f. 14)

Se bashkëpunimi rajonal është një model që paguan, kjo u provua edhe nga shembulli i vendeve të Europës Qendrore dhe Lindore (EQL). Edhe pse BE-ja i ka kryer më të shumtën e marrëdhënieve të saj dhe negociatat me vendet e EQL-së në një formë bilaterale, bashkëpunimi ndërshtetëror u shfaq fuqimisht në paketën e kërkesave për anëtarësim në BE. Në rastin e vendeve të EQL-së, bashkëpunimi ishte i nevojshëm për zgjidhjen e problemeve kufitare dhe çështjet e minoriteteve. Që atëherë, “fqinjësia e mirë” filloi të shtohet në listën e kriterëve të anëtarësimit dhe përveç përfitimeve për rajonin në fjalë, ai u bë një mjet për të “parandaluar zgjerimin e importimit të problemeve të politikës së jashtme brenda në BE”. (Deleviç, 2007, f. 23). Ndonëse përfitimet e bashkëpunimit rajonal ishin të shumta dhe, edhe pse ai ishte shumë i nxitur, ai kurrë nuk është përfshirë në kërkesat e detyrueshme për anëtarësim në BE dhe kurrë nuk ka fituar më shumë rëndësi sesa qasja dypalëshe që BE-ja kishte ndaj çdo vendi kandidat nga EQL-ja.

Megjithatë, qëndrimi ndaj vendeve të Ballkanit Perëndimor ishte ndryshe. Raporti zyrtar që Komisioni European paraqiti në Këshillin e Europës, dhe parlamenti në vitin 1996 përmbante synime dhe objektiva, si dhe kushtet dhe instrumentet që duhet të zbatohen si një përgjigje ndaj çështjes së Ballkanit Perëndimor dhe futjen e “qasjes rajonale” për herë të parë. Meqenëse kjo ishte koha kur konflikti në Ballkan sapo kishte përfunduar, me luftën në Bosnjë dhe Hercegovinë gati në përfundim, qasja rajonale ishte kryesisht një mjet për të konsoliduar paqen dhe sigurinë në rajon. Për këtë arsye, marrëveshjet që u përfunduan më vonë me çdo vend u fokusuan

në ruajtjen e stabilitetit politik dhe prosperitetit ekonomik përmes bashkëpunimit ndërmjet vetë vendeve, me vendet fqinje dhe me BE-në. (Deleviç, 2007, f. 23)

Ndërsa ato ishin duke i trajtuar të gjitha këto vende së bashku si një e tërë, ato në të njëjtën kohë ishin duke i kushtuar vëmendje të madhe pozicionit specifik të çdonjërit prej vendeve. Hyrja në një marrëveshje të tillë ishte e kushtëzuar nga gatishmëria e secilit vend për të punuar në ndërtimin e paqes, miratimin e vlerave demokratike me theks të veçantë në respektimin e të drejtave të njeriut dhe të pakicave dhe gatishmërinë për të rikrijuar bashkëpunimin me fqinjët.

Kështu, BE-ja i kushtoi rëndësi shumë më të madhe bashkëpunimit rajonal në rastin e Ballkanit Perëndimor, se në rastin e Europës Qendrore dhe Lindore, duke marrë parasysh se bashkëpunimi rajonal me vendet e BP-së ishte promovuar si një prej parakushteve të detyrueshme për integrimin në BE dhe ishte për t'u monitoruar nga afër dhe vlerësuar në rrjedhën e përparimit të vendeve drejt anëtarësimit në BE. (Deleviç, 2007, f. 24)

Në maj të vitit 1999, Komisioni European doli me një plan më të plotë dhe më ambicioz për zhvillimin e rajonit të Ballkanit Perëndimor dhe integrimin e tij eventual në BE. Në mënyrë që të nxisë procesin e aderimit për kandidatët dhe për to BE-ja ka zhvilluar një politikë të njohur si Procesit të Stabilizim-Asocimit. Procesi i Stabilizim-Asociimit (SAP) u iniciua në maj 1999, duke treguar orientimin afatgjatë të BE-së për të ndihmuar vendet e rajonit të Ballkanit Perëndimor në përpjekjet e tyre politike me mjetet e ndihmës financiare dhe burimeve njerëzore që do të çojnë në përfundim të plotë të anëtarësimit të tyre në BE. Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Kroacia, Maqedonia, Mali i Zi, Serbia dhe Kosova janë të përfshirë të gjithë në PSA, që është një pjesë përbërëse e politikës së përgjithshme të zgjerimit dhe që përgatit të gjithë rajonin për integrimin në BE.

Procesi është në të njëjtën kohë dypalësh dhe rajonal, pasi nga njëra anë ai kontribuon në vendosjen e marrëdhënieve midis vendeve të përfshira në këtë proces dhe BE-së dhe, nga ana tjetër, nxit bashkëpunimin e tyre reciprok rajonal. Siç përcaktohet nga Komisioni European, PSA-ja është "kornizë për BE-në në negociatat me vendet e Ballkanit Perëndimor, deri te aderimi i tyre eventual me tri qëllime kryesore:

- Stabilizimi i vendeve dhe nxitja e tranzicionit të tyre të shpejtë në një ekonomi tregu.

- Promovimi i bashkëpunimit rajonal.
- Anëtarësimi eventual në BE (Komisioni European, 2006, f. 5).

Komponenti kryesor i përgjithshëm i PSA-së është theksi në bashkëpunimin rajonal. PSA-ja nuk duhet të kuptohet si një proces që ndodh vetëm midis BE-së dhe një nënshkruesi të PSA-së, por ka të bëjë me bashkëpunimin dhe ndihmën e ndërsjellë midis vetë vendeve të rajonit. Kjo është theksuar në mënyrë specifike në kapitullin e MSA-së mbi bashkëpunimin rajonal, ku thuhet se vendi nënshkrues do të jetë aktiv për nxitjen e bashkëpunimit në të gjithë rajonin. Pas nënshkrimit të marrëveshjes, një vend është i detyruar të fillojë negociatat dhe të përfundojë marrëveshjet dypalëshe mbi bashkëpunimin rajonal me vendet e tjera që e kanë nënshkruar tashmë MSA-në.

Perspektiva e re për Ballkanin Perëndimor në kuadër të Strategjisë për Rajonin e Danubit, për sa i përket bashkëpunimit rajonal, vendet pjesëmarrëse në AP i kanë vënë detyrë vetes për të arritur objektivat konkrete dhe për të zbatuar iniciativat specifike në përputhje me agjendën e Selanikut nga 2033 në fushën e liberalizimit rajonal tregtar, lehtësimit të regjimit të vizave brenda rajonit, sekuestrimit të armëve të vogla dhe armatimeve, të krijimit të një tregu rajonal për gaz dhe energji, zhvillimit të një infrastrukture të energjisë, rrjetit të transportit dhe telekomunikacionit, menaxhimit të ujit, mbrojtjes së mjedisit, bashkëpunimit ndërkuftar dhe parlamentar, si dhe shkencës dhe hulumtimit. (Komisioni European, 2006, f. 6).

Bashkëpunimi konstruktiv rajonal është me vlerë të rëndësishme dhe tregon se vendi është i gatshëm për t'u integruar në BE. Qasja e Ballkanit Perëndimor në BE duhet të shoqërohet nga rritja e bashkëpunimit rajonal modeluar mbi bashkëpunimin brenda vetë BE-së.

Vendet e Ballkanit Perëndimor janë bërë plotësisht të vetëdijshëm për problemet e përbashkëta që ata kanë, shumica e të cilave kanë karakteristika të forta ndërkuftare, nga të cilat lindin përgjegjësitë ndaj njëri-tjetrit. Tani ata i kuptojnë përfitimet dhe rezultatet që bashkëpunimi rajonal ka sjellë për çdo njërën prej tyre, i cili i jep nxitje të mëtejshme për të vazhduar forcimin e bashkëpunimit.

Megjithatë, bashkëpunimi rajonal thjesht brenda Ballkanit Perëndimor nuk do të jetë një përgjigje e mjaftueshme kundrejt sfidave që këto vende po përballen dhe që duhet të zgjidhen para se ato të hyjnë në Bashkimin European. Mungesa e përvojës dhe burimet e varfra, që është e përbashkët për të gjitha vendet

e Ballkanit Perëndimor janë një pengesë serioze për trajtimin e sfidave ekzistuese në nivel rajonal. Ndërsa perspektiva Europiane është e sigurt për vendet e Ballkanit Perëndimor, ajo është ende e largët për shumë prej tyre dhe paaftësia për të përmbushur kërkesat e bashkëpunimit rajonal në një mënyrë të kënaqshme mund të zgjasin procesin e anëtarësimit edhe më shumë. Në një kontekst të tillë, Strategjia e Rajonit të Danubit mund të jetë zgjidhja dhe përgjigja e nevojshme për Ballkanin Perëndimor.

Strategjia e re e Rajonit të Danubit - perspektiva e re për Ballkanin Perëndimor

Strategjia e Danubit është iniciativa e parë e BE-së në një kohë të gjatë, e cila përveç fushave të përparësisë, ndikon në fqinjësinë dhe politikën e zgjerimit. Ajo nuk është vetëm një katalizator i agjendës së Selanikut, e cila zgjeroi dhe pasuroi SAP-në me disa elemente që janë futur për shkak të zgjerimit të pashmangshëm drejt vendeve të Europës Qendrore dhe Lindore, por gjithashtu paraqiti një gamë të mjeteve dhe instrumenteve të reja për të mbështetur proceset e reformave në Ballkanin Perëndimor dhe për ta sjellë atë më afër BE-së.

Strategjia mund të perceptohet si një urë në mes të gjendjes së tanishme të vendeve të Ballkanit Perëndimor dhe anëtarësimit të plotë të tyre, i cili në masë të madhe mund të lehtësojë integrimin e Ballkanit në strukturat europiane. Kjo është një mundësi e shquar për këto vende të jenë pjesë e strategjisë së një makrorajoni dhe të jenë të lidhura ngushtë me disa nga shtetet anëtare përmes çështjeve të interesave dhe përfitimeve të përbashkëta. (Këshilli i Bashkimit European, 2011). Strategjia e Rajonit të Danubit përfshin tetë vendet e BE-së (Gjermania, Austria, Hungaria, Republika Çeke, Republika Sllovaqe, Sllovenia, Bullgaria dhe Rumania) dhe 8 vendet joanëtare të BE-së (Kroacia, Bosnja dhe Hercegovina, Mali i Zi, Ukraina dhe Moldavia).

Harta 2: Ndryshimi territorial i rajonit të Danubit për Strategjinë e Rajonit të Danubit



Burimi: http://ec.europa.eu/regional_policy/cooperation/danube/maps_en.htm

Bazuar në rezultatet paraprake të strategjive makrorajonale në Bashkimin Europian, Këshilli Europian propozoi një strategji të BE-së për rajonin e Danubit. Strategjia e Rajonit të Danubit, ashtu si Strategjia e Rajonit të Baltikut, është një mënyrë për të krijuar një model makrorajonal për bashkëpunim efikas territorial. Ai pritet të sjellë koordinim më të mirë midis autoriteteve zyrtare dhe organizatave që punojnë në zonën e Danubit dhe të rezultojë në prosperitetin, zhvillimin e qëndrueshëm, hapjen e mundësive të reja të punësimit dhe forcimit të sigurisë në rajon. (Komisioni Europian, 2011)

Motivet dhe qëllimet e Strategjisë janë përmbledhur mirë në Deklaratën finale të Konferencës së Liderëve Rajonalë të Komunitetit të Punës së Rajonit të Danubit të mbajtur në Linz në vitin 2008: “Për Rajonin e Danubit dhe integrimin e suksesshëm të shteteve, rajoneve, komunave dhe qytetarëve të tij, ekziston një mundësi dhe detyrim për të dalë nga një mjedis i ri ndërkombëtar më i fortë se më parë, duke bashkuar forcat, veprimet e përbashkëta dhe duke formuluar një politikë për rajonin e Danubit për të ardhmen. Vetëm në këtë mënyrë, rajoni

i Danubit mund të bëhet përsëri një udhëheqës intelektual, si dhe qendra ekonomike dhe kulturore e Europës dhe e botës, ashtu siç ka qenë më parë. Së bashku, rajonet përgjatë Danubit janë të fortë dhe me ta është edhe Europa”.

Ishte e ditur se, në një fazë të hershme, asnjë nga qëllimet e deklaruara nuk do të ishte i arritshëm nëse qëllimi i strategjisë nuk hapej përtej kufijve të BE-së. Vlera e madhe e Strategjisë qëndron pikërisht në faktin se ajo është krijuar jo vetëm për shtetet anëtare të BE-së, por se ajo përfshin të gjitha vendet që kanë qenë pjesë e Procesit të Bashkëpunimit të Danubit (Komisioni Europian, 2011). Ky partneritet i ri është me interes të veçantë dhe me rëndësi për vendet e Ballkanit Perëndimor, meqenëse pellgu i Danubit ka qenë një lidhje historike dhe portë kryesore për integrimin europian të Ballkanit Perëndimor. Një strategji e tillë e parashikuar hap mundësinë për shtetet kandidatë dhe potenciale, për kandidatë për të bashkëpunuar në mënyrë të drejtpërdrejtë me shtetet anëtare, disa prej tyre, ato më të zhvilluarat dhe më të vjetrat, për të marrë udhëzime dhe për të adoptuar praktikat më të mira për t’ju përgjigjur sfidave që vendet e rajonit të Danubit ndajnë.

Strategjia për Rajonin e Danubit ka nisur me qëllimin për rritjen dhe kohezionin socio-ekonomik, forcimin e sigurisë dhe njohjen e multikulturalizmit në rajonin e Danubit. Duke qenë se të gjitha shtetet e përfshira në Strategji janë prekur rëndë nga kriza ekonomike globale, Strategjia e Danubit përqipet kryesisht për të kontribuar në rritjen e qëndrueshme ekonomike në rajon. Strategjia thekson ndërvarësinë ekonomike të vendeve në rajonin e Danubit dhe potencialet e tyre për zhvillimin ekonomik. Ajo propozon krijimin e rrjeteve të biznesit dhe organet joqeveritare të promovimit të tregtisë, të cilat do të gjenerojnë mundësitë e ardhshme të zhvillimit, veçanërisht për NVM-të, rritjen e punësimit dhe nxitjen e rritjes eficiente dhe të qëndrueshme. (Këshilli i Bashkimit Europian, 2011)

Forcimi i sigurisë është një tjetër aspekt shumë i rëndësishëm i Strategjisë së Rajonit të Danubit duke qenë se ky rajon përbëhet edhe nga vendet Shengen dhe ato joshengen, si dhe shtetet anëtare, vendet kandidatë dhe vendet e mundshme kandidatë, ligjet dhe politikat e sigurisë të së cilave nuk janë të harmonizuara, gjë që kërkon bashkëpunim të vazhdueshëm dhe të plotë në çështjet e sigurisë. Ndërlidhur përmes Strategjisë, vendet pjesëmarrëse do të jenë në gjendje të bashkëpunojnë shumë më ngushtë për të shkëmbyer më shumë informacion në mënyrë më të shpeshtë dhe për të organizuar veprime të përbashkëta që synojnë forcimin e sigurisë dhe të sigurisë në rajon. Për

shtetet kandidate dhe kandidatët potencialë, kjo do të jetë një mundësi që ata të njihen më mirë me ligjet dhe politikat e sigurisë të shteteve anëtare dhe të përshtatin ligjet vendore dhe politikat e tyre me standardet europiane.

Për më tepër, Strategjia thekson nevojën për njohjen e multikulturalizmit, duke qenë se pellgu i Danubit ka qenë gjithmonë i përbërë nga popuj dhe kombësi të ndryshme. Duke pasur parasysh strukturën multikulturore, fetare dhe kombëtare e perëndimore të Ballkanit Perëndimor, ky aspekt fiton vlerë shtesë dhe rëndësi.

Fushat prioritare të Strategjisë së Danubit janë ndër pengesat kryesore për avancimin e vendeve të Ballkanit Perëndimor dhe atyre, fuqimisht të favorizuar nga BE-ja. Prandaj, të qenit i integruar në Strategjinë e Danubit hap mundësi të mëdha për vendet e Ballkanit Perëndimor për të përmirësuar fushat që kanë mbetur prapa me anë të bashkëpunimit dhe përpjekjeve të përbashkëta me vendet e zhvilluara, shumë më tepër dhe sigurisht në një ritëm më të shpejtë se sa ata do të bënin vetë.

Në anën tjetër, Strategjia do të mundësojë një ndryshim në pozitën e vendeve të Ballkanit Perëndimor, nga vëzhgues pasivë dhe marrës të ndihmës në shtete që marrin pjesë aktive në zbatimin e Strategjisë. Për herë të parë këto vende do të jenë në një pozicion për të siguruar të dhëna dhe të japin këshilla se si t'i qasen çështjeve në të cilat Strategjia fokusohet. Vendet e Ballkanit Perëndimor do të kenë mundësi për të ofruar iniciativa, të propozojnë zgjidhje dhe të veprojnë si partnerë të barabartë me shtetet anëtare në çështjet e interesit të ndërsjellë dhe shqetësimit. Marrja e një roli aktiv në këtë proces do të ndihmojë në ndryshimin e perceptimit të këtyre vendeve dhe do të reflektojë pozitivisht në afirmimin e tyre në nivel europian.

Përfundime

Vendet e Ballkanit Perëndimor, si nga perspektiva e tyre individuale dhe e përbashkët, besojnë se Strategjia do të hapë mundësi të mëdha për të vënë në përdorim plotësisht potencialet e tyre ekonomike, kulturore, ekologjike dhe të tjera në zonën e Danubit.

Lehtësimi i zhvillimit social dhe ekonomik, përmirësimi i shërbimeve të lidhjes dhe komunikimit, mbrojtjes së mjedisit dhe lehtësimi i rreziqeve të fatkeqësive natyrore janë ndër prioritetet kryesore të çdo vendi, të cilat në kuadër të Strategjisë së Danubit kanë shanse shumë më të mira për t'u arritur.

Përfitimet e Strategjisë së Danubit për vendet e Ballkanit Perëndimor mund të jetë shumë dhe ato mund të jenë një bazë

për bashkëpunim në të ardhmen, për punë të përbashkët dhe qëllime të përbashkëta që ndahen edhe me Bashkimin Europian.

Ndërsa, për momentin, kontributet nga Ballkani Perëndimor mund të jenë pak - është shumë e mundshme që me kohën ky mikrorajon mund të rritet në një partner të barabartë me kontribute të vlefshme. Gradualisht, një kapitull i tërë i ri si për Ballkanin Perëndimor dhe Bashkimin Europian mund të ketë filluar dhe të jetë duke provuar pse Strategjia e Danubit është konsideruar si një sukses që para krijimit të saj.

Referencat

- Aslund, A., (2007), *Europe after Enlargement*, Cambridge University Press, UK.
- Bretherton, C. and Vogler, J., (1999), *European Union as a Global Actor*, Routledge UK, London.
- Commission of the European Communities (2008), *Communication from the Commission to the Council and the European Parliament-Enlargement Strategy and Main Challenges 2008-2009*. Commission of the European Communities, Brussels.
- Deleviæ, M., (2007), *Regional Cooperation in the Western Balkans*, Chaillot Paper 104, European Union Institute for Security Studies, Paris, France, 2007.
- European Commission Directorate - General for Press and Communication (2004). *A world player - The European Union's external relations*, Office for Official Publications of the European Communities, Luxembourg.
- European Commission, Enlargement DG and External Relations DG, (2006), *Regional Cooperation in the Western Balkans - A policy priority for the European Union*. Office for Official Publications of the European Communities, Luxembourg.
- European Commission, Directorate General for Regional Policy (2011), *The EU Strategy for the Danube Region, A united response to common challenges*.
- Panorama 37*, DG for Regional Policy, Brussels.
- Hulvely, I. and Levai, I., (2003), *Regional Politics and Economics of EU Enlargement:*

- East European Regions and Small States in the Changing Architecture of European and Global Integration*, Budapest Forum-Institute for Political Science, Budapest.
- Funck, B. and Pizzati, L., (2003), *European Integration, Regional Policy and Growth*.
- International Bank for Reconstruction and Development, Washington DC.
- Miniæ, J. and Kronja, J., (2007), *Regional Cooperation for Development and European Integration*, European Movement in Serbia, Belgrade.
- Pusca, A., (2003), *European Union: Challenges and Promises of a New Enlargement*, International Debate Education Association, New York.
- Regional Cooperation Council (2009), *Annual Report of the Secretary General of the Regional Cooperation Council on Regional Cooperation in South-East Europe 2008-2009*, Regional Cooperation Council, Sarajevo.
- Stability Pact for South Eastern Europe (2007), *Eight Year of Stability Pact for South Eastern Europe-From Stabilization to Integration*, Stability Pact for SEE, Brussels.
- Working Community of the Danube Regions (2009), *Final Declaration: Sustainability Shaping the Future of the Danube Region*, Working Community of the Danube Regions, Linz.

Burime nga interneti

- Central European University, Presenting the New EU Strategy for the Danube Region
<http://www.ceu.hu/news/2011-04-28/presenting-the-new-eu-strategy-for-thedanube-region> (15.07.2011).
- Communication from the Commission to the European Parliament, the Council, the European Economic and Social Committee and the Committee of the Regions,
 European Union Strategy for the Danube Region, <http://eur-lex.europa.eu/>.
 LexUriServ/LexUriServ.do?uri=CELEX:52010DC0715:EN:NOT (15.07.2011).
- Council of the European Union, Council Conclusions on the European Union Strategy

for the Danube Region http://www.consilium.europa.eu/uedocs/cms_data/docs/pressdata/EN/genaff/121511.pdf (26.04.2011).
European Commission, Regional Policy- Info Regio http://ec.europa.eu/regional_policy/cooperate/danube/index_en.cfm (10.08.2011).
Hungarian Presidency of the Council of the European Union <http://www.eu2011.hu/danube-region-strategy-drs> (25.08.2011).
Interact Point Vienna, Territorial Cooperation onboard with the Danube Region Strategy
http://www.interact-eu.net/downloads/3392/Newsletter_INTERACT_Territorial_Cooperation_Onboard_with_the_EUSDR__Issue_2011-01.pdf
(17.08.2011).

Blerjana Bino, kandidat për PhD*

SIGURIA NJERËZORE, E DREJTA PËR TË KOMUNIKUAR DHE PRIVATËSIA NË KONTEKSTIN E INFORMACIONIT DHE TË NJË SHOQËRIE QË UDHËHIQET NGA DIJA

Abstrakt

Nevoja emergjente, avancimet dhe përhapja e shpejtë e teknologjive të informacionit dhe komunikimit (ICT) kanë transformuar dukshëm, pothuajse të gjithë dimensionet e shoqërisë sonë bashkëkohore, duke çuar në zhvillimin e një shoqërie të udhëhequr nga informacioni dhe dija. Prandaj argumentohet se shkenca, inovacioni dhe ICT-ja mund të kenë ndikim pozitiv te zhvillimi njerëzor dhe progresi shoqëror. Pavarësisht transformimeve dhe zhvillimeve pozitive në kuadër të shoqërisë së udhëhequr nga dija dhe informacioni, progresi në shkencë, teknologji dhe inovacion nxjerr në pah sfida të mëdha për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore *vis-à-vis* - shqetësimeve të sigurisë njerëzore. Ky studim interesohet për sfidat që dalin në pah gjatë përpjekjes për të bashkuar aspektet kundërshtuese të sigurisë, privatësisë (*privacy*) dhe lirisë në kuadër të shoqërisë që udhëhiqet nga informacioni dhe dija. Mbrojtja e të drejtave të njeriut si e drejta për privatësi dhe ajo për të komunikuar në kuadër të shoqërisë së informacionit dhe të udhëhequr nga dija duket se zvogëlohet

* Me një bagazh akademik në shkenca politike, mirëqeverisje, përfaqësim politik dhe komunikim, znj. Bino është diplomuar për Master Shkencor në Politikë dhe Komunikim në London School of Economics and Political Science (LSE, UK). Aktualisht ajo po vazhdon Studimet e Doktoraturës në Queen Mary, Universitet i Londër në School of Politics and International Relations, në një projekt studimor që përqendrohet te media dhe demokratizimi. Fushat e kërkimit: të drejtat e njeriut dhe arsimit; teknologjitë e reja të komunikimit dhe siguria njerëzore; përfshirja sociale e grupeve të marginalizuara, politikat e identitetit; përfaqësimi politik dhe pjesëmarrja, qarqet publike dhe demokracia; studimi cilësor (intervistat e thelluara, analizat e dokumenteve, seminarët, analizat e diskurseve); studimi sasior (analizë e përmbajtjes, pyetësorë). E-mail: blerjana.bino@uet.edu.al.

nga shqetësimet e sigurisë njerëzore dhe në emër të sigurisë publike. Ky studim adreson disa prej pyetjeve mbi natyrën e ndryshueshme të konceptit të sigurisë njerëzore në kuadër të shfaqjes dhe përhapjes së ICT duke u përqendruar kryesisht tek çështjet e privatësisë dhe të drejtës së komunikimit. Ai argumenton se e drejta për të komunikuar mund të konceptohet si një kuadër konceptual brenda të cilit adresohen disa prej shqetësimeve më të dukshme të shoqërisë aktuale si siguria njerëzore dhe privatësia.

Fjalë kyçe: *siguria njerëzore, privatësia, e drejta për të komunikuar, shoqëria që udhëhiqet nga dija, shoqëria e informacionit.*

Hyrje

Nevoja emergjente, avancimet dhe përhapja e shpejtë e teknologjive të informacionit dhe komunikimit (ICT), ka transformuar dukshëm, thuhet, të gjithë dimensionet e shoqërisë sonë bashkëkohore duke çuar në zhvillimin e informacionit dhe të një shoqërie që udhëhiqet nga dija. Përkufizimi i duhur i shoqërisë së informacionit dhe që udhëhiqet nga dija, është ajo e një shoqërie rrjetesh që bazohet në qendrat e komandimit dhe kontrollit të gjenerimit të njohurive si dhe tek rrjedhat e informacionit¹. Edhe pse studiuesit nuk bien dakord mbi një përkufizim të përbashkët gjithëpërfshirës mbi konceptin e shoqërisë së informacionit dhe shoqërisë së udhëhequr nga dija në fushën politike, të politikëbërjes, qarqeve akademike dhe sektorin privat, një sërë programesh ndërkombëtare dhe kombëtare po vendosen me qëllim zhvillimin e mëtejshëm të konceptit. Në këtë kuadër, strategjia “Horizon 2020” e Bashkimit Europian përqendrohet kryesisht te mënyrat se si rritja në mënyrë të zgjuar mund të përshpejtohet duke përqendruar përpjekjet te sektori i dijeve, çka përfshin teknologjitë e informacionit dhe komunikimit, kërkimet dhe shkencën, arsimin dhe inovacionin. Pavarësisht transformimeve politike dhe zhvillimeve në kuadër të shoqërisë së informacionit dhe shoqërisë që udhëhiqet nga dija, progresi në shkencë, teknologji dhe inovacion vendos sfida të mëdha për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore krahas shqetësimeve për sigurinë njerëzore.

Komunikimi dhe informacioni janë burime thelbësore dhe instrumente fuqie². Komunikimi dhe të drejtat e njeriut ndërliohen

¹ Castells, M., “Materials for an exploratory theory of the network society”, *British Journal of Sociology*, Vol. 51, Issue No. 1, (2000a), f. 5-24.

² Ibid, f. 6.

me ICT-në edhe në kuadër të zhvillimeve bashkëkohore; të drejtat e komunikimit nuk kufizohen vetëm te liria e shprehjes, por përfshijnë edhe shqetësime rreth aksesit tek informacioni, qeverisjes transparente dhe demokratike të medias, të drejtën për pjesëmarrje në zhvillimet kulturore dhe shoqërore dhe të drejtën për privatësi (*privacy*). Ky studim trajton sfidat që dalin në pah kur përpiqemi të bashkojmë aspektet kundërshtuese të sigurisë, privatësisë dhe lirisë në kuadër të shoqërisë së informacionit dhe asaj të udhëhequr nga dija. Mbrojtja e të drejtave të njeriut si e drejta për privatësi dhe e drejta për të komunikuar në kuadër të shoqërisë së informacionit dhe të udhëhequr nga dija, duket se buron nga shqetësimet për sigurinë njerëzore dhe ato në emër të sigurisë publike. Ky studim adreson disa prej çështjeve që lidhen me natyrën e ndryshueshme të konceptit të sigurisë njerëzore në kuadër të shfaqjes dhe përhapjes së ICT-ve duke u përqendruar veçanërisht te çështjet e privatësisë dhe ato të së drejtës për të komunikuar. Kapitulli i parë i këtij studimi do të trajtojë gjerësisht konceptin e shoqërisë së informacionit të udhëhequr nga dija duke theksuar rolin e ICT-së në transformimin e shoqërisë bashkëkohore dhe rishikimin e panoramës komplekse që del në pah në lidhje me përfitimet dhe humbjet. Në vazhdim, pjesa e dytë e studimit diskuton konceptin e sigurisë njerëzore, privatësisë dhe të drejtën për të komunikuar si edhe mënyrat se si zhvillohet ndërveprimi i tyre në kuadër të shoqërisë së informacionit dhe asaj të udhëhequr nga dija.

Konceptualizimi i shoqërisë së informacionit të udhëhequr nga dija

Koncepti i shoqërisë së informacionit të udhëhequr nga dija në nivel global e ka origjinën nga teoria e McLuhan, për “fshatin global”, domethënë transformimin e botës në një fshat global falë përhapjes së gjerë të komunikimit, medias dhe ICT-së.³ Për më tepër, mbrojtësit më të mëdhenj të proceseve të globalizimit në shoqërinë bashkëkohore theksojnë se bota është gjithnjë e më e gjerë, më e ndërlidhur dhe më e informuar dhe kësaj argumentojnë se: “*Bota aktualisht po sheshohet për shkak të*

³ McLuhan, M., *Understanding Media: The Extensions Of Man*, (New York: Mentor, 1964).

Shih gjithashtu McLuhan, M., & Power, B. R., *The Global Village: Transformations in World Life and Media in the 21st Century*, (New York: Oxford University Press, 1992).

*avancimeve të teknologjive të informacionit dhe komunikimit*⁴. Sugjerimi këtu është se dinamikat e procesit të globalizimit eliminojnë ndryshimet ndërmjet vendeve dhe i bën ato më të ngjashme për sa i përket ekonomisë, zhvillimeve kulturore dhe shoqërore dhe sistemeve politike. Siç thekson dhe Giddens, globalizimi mund të përkufizohet si: “*Intensifikimi i marrëdhënieve shoqërore botërore të cilat lidhin vende të largëta në mënyrë të tillë që ngjarjet që ndodhin në një vend formësohen prej ngjarjeve që ndodhin shumë kilometra larg dhe anasjelltas*”⁵, duke theksuar kësajsoj ndërveprimet socio-kulturore dhe ekonomike dhe marrëdhëniet njerëzore. Pavarësisht shumëllojshmërisë së teorive mbi globalizimin dhe qëndrimeve kundërshtuese lidhur me efektet e proceseve të globalizimit, studiuesit⁶ bien të gjithë dakord kur identifikojnë zhvillimet në ICT si forca që nxit proceset e globalizimit.

Avancimet në ICT kanë ndikim të dukshëm për organizimet socio-kulturore, ekonomike dhe politike, praktikat dhe strukturat e shoqërisë bashkëkohore sikundër edhe për ndërveprimet dhe marrëdhëniet njerëzore të përditshme. Castells ka prezantuar konceptin e *hapësirave të flukseve*⁷ për të hedhur ndritë mbi logjikën e ndikimit të ICT-së në praktikat dhe ndërveprimet shoqërore. Argumenti i tij kryesor është se shoqëria bashkëkohore ndërtohet rreth formave të ndryshme të flukseve të cilat përfshijnë jo vetëm flukset e parave, burimeve, kapitalit njerëzor në tregtinë ndërkombëtare dhe biznesin, por edhe flukset e informacionit dhe dijes; ato të teknologjisë dhe inovacionit, si dhe flukset e aspekteve kulturore⁸. Koncepti i *hapësirave të flukseve* është thelbësor për të kuptuar konceptualizimin e shoqërisë bashkëkohore si një rrjet i shoqërisë së informacionit e cila udhëhiqet nga dija. Castells identifikon një transformim nga shoqëria industriale drejt asaj të

⁴ Friedman, T. L., *The World is Flat: A Brief History of the Twenty First Century*, (New York: Farrar, Strauss and Giroux, 2006), f. 8.

⁵ Giddens, A., *The Consequences of Modernity*, (Stanford: Stanford University Press, 1990), f. 64.

⁶ Shih McLuhan, 1964; Giddens, 1990; Castells, 2000; Friedman, 2006.

⁷ Castells, M., “Chapter 6: The Space of Flows”, in Castells, M., (2nd Edition) *The Information Society, Volume 1: The Rise of the Network Society*, (Oxford: Blackwell Extract, 2000), f. 440-459.

Castells, M., “Materials for an exploratory theory of the network society”, *British Journal of Sociology*, Vol. 51, Issue No. 1, (2000), f. 5-24.

⁸ Castells, M., “Chapter 6: The Space of Flows”, in Castells, M., (2nd Edition) *The Information Society, Volume 1: The Rise of the Network Society*, (Oxford: Blackwell Extract, 2000), f. 442.

⁹ Ibid, f. 4.

informacionit, e cila ndërtohet rreth *hapësirave të flukseve* dhe ku marrëdhëniet e fuqisë organizohen nëpër rrjete globale⁹. Në shoqërinë e rrjeteve të informacionit, strukturat shoqërore janë ende të organizuara rreth marrëdhënieve të prodhimit dhe konsumit, fuqisë dhe eksperiencës, por tipari thelbësor i tyre është se ato bazohen te rrjetet, informacioni dhe dija, të cilat fuqizohen nga zhvillimi i ICT-së.

Kjo nuk do të thotë se informacioni, dija, shkenca dhe teknologjia nuk kanë qenë të rëndësishme për zhvillimin dhe progresin e shoqërive të tjera. Argumenti kryesor këtu është informacioni, dija, shkenca, rrjetet dhe teknologjia, në përgjithësi, janë nxitësit e zhvillimit shoqëror, politik dhe ekonomik si dhe të vetë realizimit njerëzor. Në kontekstin e shoqërisë së informacionit dhe të udhëhequr nga dija, ICT-ja është bërë pjesë e diskursit politik dhe e zhvillimit të politikave publike si dhe institucioneve domethënëse sociale për shkak të kërkesave dhe nevojave të reja dhe urgjente. Në këtë kuptim, Webster thekson pesë kriteret analitike për shoqërinë e informacionit që udhëhiqet nga dija: teknologjik, ekonomik, punësues, hapësinor dhe kulturor¹⁰. Duke qenë se prodhimi dhe shpërndarja e informacionit dhe dijes janë transformuar në faktorë të rëndësishëm ekonomikë, politikë, shoqërorë dhe kulturorë - qeveritë, organizatat ndërkombëtare, shoqëria civile dhe aktorë të tjerë kombëtarë dhe ndërkombëtarë kanë filluar të krijojnë një rrjet normativ për funksionimin e shoqërisë së informacionit, duke përfshirë zgjerimin e një sërë principesh udhëheqës dhe vendosjen e rregullave specifike për funksionimin e shoqërisë së informacionit¹¹. Nevoja për kuadrin normativ dhe principet udhëheqëse reflekton kompleksitetin e shoqërisë së informacionit që udhëhiqet nga dija si dhe efektet kundërshtuese të përhapjes së ICT-të përfshijnë përfitime dhe shqetësime. Në seksionin vijues përfitimet e ICT-ve do të diskutohen në lidhje me zhvillimin e një kuadri konceptual mbi të drejtën për të komunikuar.

E drejta për të komunikuar dhe siguria njerëzore në shoqërinë e informacionit që udhëhiqet nga dija

Argumentohet se disa prej përfitimeve të shoqërisë së informacionit dhe dijes që mundësohen prej ICT-ve janë: aksesit

¹⁰ Webster, F., *Theories of The Information Society*, (3rd Ed), (London: Routledge, 2006).

¹¹ Pace, C., "Balancing Rights in the Information Society: Human Rights and the Protection of Public Security", *Human Security Perspectives*, Vol. 8, No. 1, (2012), f. 69.

universal tek informacioni; mundësia për rritjen e transparencës dhe hapjes së qeverisë dhe të aktorëve të fuqishëm privatë; një qasje më pjesëmarrëse për vendimmarrjen, qeverisja direkte dhe demokracia; përmirësime në kërkime, arsim dhe inovacion etj¹². Në këtë kuadër, përhapja e ICT-ve dhe zhvillimi i mëtejshëm i shoqërisë së informacionit që bazohet te dija duket se ofron mundësi për themelimin e demokracisë me pjesëmarrje ku qytetarët fuqizohen për të luajtur një rol të dukshëm në vendimmarrje dhe politikë. Modelet përfaqësuese të demokracisë theksojnë rëndësinë e pjesëmarrjes reale të qytetarëve dhe përfshirjes së tyre aktive në proceset demokratike dhe jetën publike¹³. Nëse kjo do të mundësohet, demokracia me pjesëmarrje kërkon një sistem të hapur informacioni dhe mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të komunikimit për të siguruar vendime të informuara prej qytetarëve¹⁴. Në këtë kuptim, media e re i shërben komunitetit duke bërë që qytetarët të marrin pjesë në mënyrë më aktive në qarqet publike nëpërmjet debateve, diskutimeve dhe përfaqësimeve të këndvështrimeve dhe perspektivave të ndryshme në faqet sociale *online*, platformat e lajmeve, blogjeve dhe mikroblogjeve¹⁵. Për shembull, media e gjeneruar nga qytetarët e lehtësuar nga interneti dhe mjetet e tij të ndërveprimit, kërkesat e pakta për akses dhe ndërlidhje po kontribuon dukshëm për një media dhe publikim lajmesh të demokratizuar duke inkurajuar dhe mundësuar pjesëmarrjen e qytetarisë. Megjithatë, studimi¹⁶ mbi kontributin e ICT-ve për demokracinë pjesëmarrëse sugjeron se ka shumë mundësi që ICT-të të zgjerojnë tendencat aktuale dhe mundësitë në mjete politike sesa të prezantojnë mundësi të reja për veprim politik dhe pjesëmarrje. Në këtë kuptim, të drejtat e komunikimit janë shumë relevante nëse ICT-të do të arrijnë potencialin e tyre pozitiv plotësisht.

Përhapja e ICT-ve dhe zhvillimet në median e re vendosin sfida dhe mundësi për konceptet tradicionale të të drejtave të informacionit dhe komunikimit, si: liria e fjalës, e drejta për t'u

¹² Ibid, f. 71.

¹³ Cammaerts, B., "Critiques on the participatory potentials of Web 2.0", *Communication, culture & critique*, Vol. 1, No. 4, (2008), f. 361.

¹⁴ Held, D., *Model of Democracy*, (2nd Edition), (UK: Polity Press, 1996), f. 272.

¹⁵ Cammaerts, B., "Critiques on the participatory potentials of Web 2.0", *Communication, culture & critique*, Vol. 1, No. 4, (2008), f. 361.

¹⁶ Mansell, R., "Power and interests in information and communication technologies and development: exogenous and endogenous discourses in contention", *Journal of international development*, (2011), this version available at: <http://eprints.lse.ac.uk/32152/>, parë në 2 dhjetor 2011.

shprehur lirisht, aksesit universal dhe privatësia (*privacy*) siç argumentohet më sipër. Në kontekstin e shoqërisë së informacionit të udhëhequr nga dija, komunikimi, të drejtat e njeriut, siguria, privatësia dhe ICT-ja, ndërlidhen. Duke pasur parasysh zhvillimin e shoqërisë bashkëkohore në shoqërinë e informacionit që udhëhiqet nga dija, të drejtat për komunikim janë zhvilluar gjithashtu nga të drejtat dhe liritë negative, si liria e shprehjes në të drejta pozitive si dhe ajo për komunikim¹⁷. E drejta për të komunikuar perceptohet si një koncept përmbledhës për të drejta të tjera themelore si e drejta për liri të shprehjes, e drejta për të marrë, kërkuar dhe shpërndarë informacion dhe dije përfshihet në nocionin e “të drejtave të brezit të katërt” ose “të të drejtave të komunikimit”, i cili ka dalë në pah në kuadër të shoqërisë së informacionit që udhëhiqet nga dija. Principi që përfshihet në konceptin e të drejtës për të komunikuar është ajo se për ICT, media e re dhe interneti nevojiten për të mundësuar hapësirë të komunikimit me pjesëmarrje për aspiratat shoqërore, kulturore, politike dhe ekonomike të qytetarëve. Kësisoj kuadri i të drejtës për të komunikuar duhet të marrë zhvillimin e duhur.

Koncepti i të drejtës së komunikimit u hartua në vitin 1968. Që atëherë janë bërë përpjekje të shumta për të siguruar mbështetje politike për këtë të drejtë¹⁸, por zbatimi në politika është penguar nga mungesa e një përcaktimi për të cilin bihet dakord gjerësisht¹⁹. Themelet për të drejtën për komunikim gjenden në nenin 19 të Deklaratës së OKB-së për të Drejtat e Njeriut, e cila thekson se: “Çdokush ka të drejtë për lirinë e opinionit dhe shprehjes, të drejtë për të mbajtur opinionin pa ndërhyrje dhe për të kërkuar, marrë dhe importuar informacion dhe ide nëpërmjet çdo medie, pavarësisht kufijve”²⁰. Më tej deklarata thekson të drejtën e çdokujt për të marrë pjesë në jetën kulturore të komunitetit, të gëzojë artin dhe të ndajë përfitimet e arritjeve shkencore²¹. Këto nene theksojnë se

¹⁷ McIver, W. J., & Birdsall, W. F., “Technological Evolution and the Right to Communicate: The Implications for Electronic Democracy”, prezantuar në *Ericom Colloquium: Electronic Networks & Democracy*, Nijmegen, Holandë, 2002.

¹⁸ Hamelink, C., “Rethinking ICTs: ICT’s on a Human Scale”, *European Journal of Communication*, Vol. 21, No. 3, (2006), f. 389.

¹⁹ McIver, W. J., Birdsall, W. F., & Rasmussen, M., “The internet and the right to communicate”, *Peer Reviewed Journal: First Monday*, Vol. 8, N. 12, (2003), f. 7.

²⁰ Article 19, United Nations, *Human Rights: A Compilation of International Instruments* (New York, NY: United Nations, 1997).

²¹ Article 27, United Nations, *Human Rights; A Compilation of International Instruments* (New York, NY: United Nations, 1997).

përfitimet e përhapjes së ICT-ve nuk duhet të jenë vetëm për ata që kanë burimet dhe kompetencat për t'i arritur ato, por duhen parë si të drejta të qytetarëve të një shoqërie dhe entiteti politik që inkurajon zhvillimin dhe përhapjen e ICT-ve²². Megjithatë, nenet 19 dhe 27 nuk mjaftojnë për t'u përfshirë në transformimet e shoqërisë bashkëkohore në kuadër të avancimeve të ICT-ve duke qenë se ato i referohen kryesisht masmedias dhe komunikimit si një model njëkalimësh dërgues-marrës. Në vitet 1970 dhe 1980 ka pasur përpjekje të konsiderueshme për të formuluar të drejtën për të komunikuar dhe për ta përfshirë atë në kuadrin ligjor dhe politikëbërës. Edhe pse këto përpjekje nuk ishin të suksesshme dhe debate mbi të drejtën për të komunikuar ende ka nevojë për zgjidhje, diskutimet dhe studimet mund të shërbejnë për të ndërtuar një kuadër konceptual për të drejtën për komunikim në suazën e shoqërisë së informacionit që udhëhiqet nga dija. Në të kundërt, me konceptet tradicionale të të drejtave të komunikimit si një model njëkalimësh komunikimi, e drejta për të komunikuar përfshin konceptimin e një komunikimi me pjesëmarrje, interaktiv, horizontal dhe shumëplanësh²³. E drejta për të komunikuar i referohet individit dhe grupeve si dhe thekson potencialin e ICT-ve për një qasje më me pjesëmarrje për komunikimin dhe për akses të hapur tek informacioni. Ajo përfshin elementë ndërveprimi dhe ndërlidhjeje. Në këtë kuptim, e drejta për të komunikuar mund të perceptohet si një kuadër konceptual brenda të cilit adresohen disa prej shqetësimeve më të dukshme në shoqërinë bashkëkohore, si: siguria njerëzore dhe privatësia.

Një kontribut thelbësor për kuadrin konceptual të të drejtës për të komunikuar vjen nga Cees J. Hamelink²⁴, i cili thekson kontributin e ICT-ve për sa i përket forcimit të autonomisë, integritetit dhe sigurisë njerëzore. Hamelink argumenton se kuadri aktual i të drejtave të njeriut formohet duke u bazuar në konceptualizimin e komunikimit që mbulon kryesisht shpërndarjen, aksesin dhe regjistrimin e informacionit²⁵. Megjithatë, komunikimi nuk është thjesht transferimi i përmbajtjes, ai është, së pari, një ndërveprim ose marrëdhënie,

²² McIver, W. J., Birdsall, W. F., & Rasmussen, M., "The Internet and the right to communicate", *Peer Reviewed Journal: First Monday*, Vol. 8, N. 12, (2003), f. 8.

²³ *Ibid*, f. 9.

²⁴ Një projektdeklaratë për të Drejtën e Komunikimit është përgatitur nga C. J. Hamelink në vitin 2002 dhe pret miratimin.

²⁵ Hamelink, C. J., "The 2003 Graham Spry Memorial Lecture: Toward a Human Right to Communicate?", University of Amsterdam, (2004), f. 2.

që do të thotë një proces dialogu personal dhe publik. Në këtë kuptim, ndryshimi në konceptualizimin e komunikimit nga shpërndarja në ndërveprim kërkon përshtatjen e standardeve të të drejtave të njeriut dhe sigurisë njerëzore me çështjet e reja të shoqërisë së informacionit që bazohet në dije.

Sugjerimi këtu është që njohja e të drejtës për të komunikuar e perceptuar si ndërveprimi nëpërmjet bisedimit dhe dialogut është thelbësor për mbrojtjen e të drejtave të njeriut duke përfshirë dhe të drejtën për privatësi (*privacy*). Në këtë kuptim, aktorët shtetërorë dhe joshtetërorë shqetësohen rreth disa prej çështjeve më të ngutshme në fushën e komunikimit dhe informacionit dhe se si ato lidhen me të drejtat e njeriut, sigurinë dhe privatësinë siç u theksua edhe gjatë Samitit Botëror të OKB-së mbi shoqërinë e informacionit gjatë viteve 2003 dhe 2005²⁶. Në vijim të Samitit, përpjekje janë bërë për themelimin e një kuadri normativ për t'u përballur me realitetet e reja në shoqërinë e informacionit që bazohen te dija dhe për mënyrën si të përputhet siguria njerëzore me shqetësimet rreth privatësisë dhe zhvillimit të praktikave ligjore për themelimin e të drejtës së komunikimit. Siç u vërejt me rastin e të drejtës për privatësi, duket se ka një tension të mundshëm ndërmjet qëllimeve të qeverisë për kontroll dhe mbikëqyrje dhe kërkesës së qytetarëve për të drejta komunikimi në një demokraci me pjesëmarrje²⁷. Për shembull interneti dhe ICT-ja mundet që të jenë gjerësisht një instrument për promovimin e pjesëmarrjes dhe lirisë së shprehjes, por njëkohësisht ata mund të shërbejnë edhe si mekanizëm për fjalime të ngarkuar me urrejtje, mbikëqyrje dhe anonimitet.

Rrjedhimisht, ndikimet negative të avancimit në ICT nuk duhen nënvlerësuar. Siç argumentojnë edhe Mansell dhe Wehn (1998) ka shumë rrezik që ICT-ja dhe shërbimet që lidhen me to të thellojnë marginalizimin e atyre që nuk kanë kompetencat, kapacitetet dhe/ose burimet e duhura për të ndërtuar shoqëri që bazohen tek ICT-ja inovative duke e theksuar kësaj ndarjen digjitale²⁸. Rreziqet e perceptuara

²⁶ Mansell, R., "ICTs, discourse and knowledge societies: implications for policy and practice", in Frau-Meigs, Divina and Nicey, Jérémie and Palmer, Michael and Tupper, Patricio, (Eds.) *From NWICO to WSIS: 30 years of communication geopolitics: actors and flows, structures and divides*. (ECREA series, Bristol: Intellect, 2012), f. 11.

²⁷ Movious, L. B., "Global Debates on the Right to Communicate", *Global Media Journal*, Vol. 7, No. 13, (2008), f. 1-6.

²⁸ Mansell, R. & Wehn, U., (Eds.), *Knowledge Societies: Information Technology For Sustainable Development*, (Oxford: Oxford University Press, Oxford, 1998).

dhe të parashikuar të ICT-së në shoqërinë e informacionit dhe dijes i referohen mundësisë në rritje për thyerjen e privatësisë personale, ndërhyrjen evazive të ICT-së në shtëpi, punë, arsim dhe aktiviteteve të kohës së lirë si dhe rritjes së krimeve kibernetike²⁹. Prandaj, një nga sfidat thelbësore të sigurisë njerëzore është trajtimi i rreziqeve që ndikojnë individin në shoqërinë bashkëkohore. Këto rreziqe mund të shihen me anë të lenteve të lirive dhe të drejtave të njeriut si e drejta për privatësi, e drejta për të qenë i lirë nga frika, e drejta për t'u shprehur lirshëm dhe ajo për akses në informacion. Një tjetër sfidë e sigurisë njerëzore është fuqizimi i qytetarisë për t'u përballur me rreziqet që dalin në pah nga ICT-ja. Potenciali i ICT-së për të forcuar modelet me pjesëmarrje të demokracisë siguron mundësi për qasje të decentralizuara dhe më demokratike ndaj sfidave të sigurisë njerëzore³⁰. Në këtë kuadër, Hamelink e lidh ICT-në me shqetësimet rreth kushteve njerëzore dhe zhvillimit kur argumenton se të gjithë aktorët duhet të planifikojnë se si të përballen me skenarët që *zgjerojnë varësinë, rrisin thyeshmërinë dhe zgjerojnë pasigurinë ose reduktojnë këto tipare njerëzore dhe forcojnë autonominë njerëzore, integritetin dhe sigurinë*³¹. Kjo qasje do të thotë se kur analizohen ndikimet e ICT-së dhe boshllëku teknologjik duhet të përqendrohemi te njeriu dhe jo te teknologjia dhe se duhen theksuar proceset me pjesëmarrje dhe konteksti lokal³². ICT-të prekin individët dhe shoqëritë në mënyra komplekse dhe marrëdhënia ndërmjet ICT-së dhe zhvillimit njerëzor është dinamike dhe në zhvillim. Prandaj sfida për të pajtuar të drejtat e njeriut si e drejta për privatësi dhe ajo për të komunikuar me siguri njerëzore është edhe më relevante në kontekstin e shoqërisë së informacionit që udhëhiqet nga dija.

²⁹ Pace, C., "Balancing Rights in the Information Society: Human Rights and the Protection of Public Security", *Human Security Perspectives*, Vol. 8, No. 1, (2012), f. 69.

³⁰ Howard-Hassmann, R., E., "Human Security: Undermining Human Rights?", *Human Rights Quarterly*, Vol. 34, No. 1, (2012), f. 103.

³¹ Hamelink, C., "Rethinking ICTs: ICT's on a Human Scale", *European Journal of Communication*, Vol. 21, No. 3, (2006), f. 394.

³² Mansell, R., "ICT's, discourse and knowledge societies: implications for policy and practice", in Frau-Meigs, Divina and Nicey, Jérémie and Palmer, Michael and Tupper, Patricio, (Eds.) *From NWICO to WSIS: 30 years of communication geopolitics: actors and flows, structures and divides*. (ECREA series, Bristol: Intellect, 2012)

Siguria njerëzore dhe privatësia në shoqërinë e informacionit që udhëhiqet nga dija

Që prej publikimit të Raportit të OKB-së të vitit 1994, koncepti i sigurisë njerëzore është diskutuar gjerësisht në qarqet politikëbërëse, akademike dhe publike. Koncepti i sigurisë njerëzore ka përfshirë jo vetëm një qasje ushtarake dhe që orientohet nga shteti-komb, por një konceptualizim më “human” të sigurisë, me fjalë të tjera, balancimin e konceptit të sovranitetit dhe sigurisë me *shqetësimet në rritje rreth të drejtave individuale të njeriut dhe zhvillimin njerëzor*³³. Prandaj sugjerohet masivizimi i sigurisë njerëzore nëpërmjet një qasjeje me shumë aktorë dhe që përqendrohet tek individit ku aksi qendror është zhvillimi dhe mbrojtja e të drejtave të njeriut të individit. Ky studim adreson marrëdhënien ndërmjet sigurisë njerëzore dhe dy shtyllave kryesore të të drejtave të njeriut (të drejtën për privatësi dhe të drejtën për të komunikuar) në kontekstin e transformimeve kryesore në një shoqëri informacioni që udhëhiqet nga dija. Siç analizohet më poshtë, me zhvillimin e medias dhe më vonë me avancimin e ICT-ve dalin në pah tensionet potenciale ndërmjet sigurisë dhe privatësisë ku informacioni dhe komunikimi luajnë një rol kryesor

Avancimet në masmedia kanë çuar në zhvillimin e konceptit të privatësisë, i cili fillimisht përkufizohej si “*e drejta e njerëzve për t’u lënë rehat*”³⁴. Ky koncept u përcaktua më vonë në mënyrë më të detajuar, si: “*Dëshira e secilit prej nesh për hapësirë fizike ku ne mund të jemi të çliruar nga ndërprerjet, ndërhyrjet, sikleti ose llogaridhënia dhe nga përpjekja për kontrollin e kohës dhe mënyrës së shpërndarjes të informacionit personal rreth vetes sonë*”³⁵. Ky përkufizim përfshin mundësinë që të tjerët të shkelin privatësinë tonë dhe atë që një individ të mund të shkelë privatësinë personale të dikujt tjetër. Prandaj mënyrat si informacioni komunikohet dhe mjeti për këtë komunikim kanë rëndësi kryesore. Në këtë kuptim,

³³ Pace, C., “Balancing Rights in the Information Society: Human Rights and the Protection of Public Security”, *Human Security Perspectives*, Vol. 8, No. 1, (2012), f. 80.

³⁴ Cooper, G., & Whittle, S., “Privacy, probity and public interest”, *RISJ Challenges*, Reuters Institute for the Study of Journalism, Department of Politics and International Relations, (University of Oxford, Oxford, UK, 2009), f. 19.

³⁵ Cooper, G., & Whittle, S., “Privacy, probity and public interest”, *RISJ Challenges*, Reuters Institute for the Study of Journalism, Department of Politics and International Relations, (University of Oxford, Oxford, UK, 2009), f. 11.

në një shoqëri thellësisht të mediatizuar, privatësia i bëhet një çështje thelbësore jo vetëm për jetën e përditshme, por edhe në diskursin politik, zhvillimin dhe kuadrin ligjor. Lindja dhe përhapja e shpejtë e ICT-së ka ndikuar fort në mënyrat se si privatësia perceptohet nga qeveria, aktorët privatë, media, individët dhe publiku në tërësi. Mundësitë që ofrohen nga vlerësime të ndryshme të ICT-së, si interneti, media sociale dhe rrjetëzimi *online*, *smart phones* etj., për të shpërndarë dhe ndarë informacionin në një mënyrë të paprecedent dhe pavarësisht shqetësimeve të kohës dhe vendit kanë krijuar një *kulturë shpalljeje*³⁶. Për shembull në Mbretërinë e Bashkuar kjo kulturë shpalljeje arriti kulmin në vitin 2009 kur Jade Goody, një pjesëmarrës në *Big Brother*, lejoi që media të mbulonte me detaje fazat e fundit të jetës së saj derisa vdiq nga kanceri. Ndërsa disa individë janë komodë me nxjerrjen në pah të çështjeve intime dhe private, të tjerë mendojnë se ekspozimi në media është një thyerje e jetës së tyre private. Një rast i tillë ndodhi me disa figura publike dhe personazhe të famshëm të cilët paditën gazetën *News of the World* në Britaninë e Madhe. Rastet të tilla shtrojnë çështje të rëndësishme rreth ndërveprimit ndërmjet sigurisë njerëzore dhe privatësisë, të drejtave të njeriut si e drejta për lirinë e shprehjes, e drejta për informacion, e drejta për komunikim dhe hapësirë në media si dhe dinamikat si etika në media; kultura e gazetarisë, gazetaria investigative, ICT-ja dhe media e re.

Në shoqërinë e informacionit që udhëhiqet nga dija, fokusi i diskutimeve mbi fushën publike që lidhet me privatësinë nuk është vetëm për median, por edhe për median e re, rrjetet sociale *online*, gazetarinë qytetare dhe format e tjera të medias alternative që mundësohen nga avancimet inovative në ICT. Sfidat perceptohen aktualisht si të udhëhequra nga teknologjia, sepse teknologjitë e avancuara dhe ato inovative kanë bërë që informacioni të jetë më i aksesueshëm, pavarësisht kohës dhe vendit; kanë ndryshuar mënyrat se si ne mund të ndërhyjmë në privatësinë tonë dhe atë të të tjerëve. Ekziston një interes në rritje ndërmjet studiuesve dhe akademikëve për sa i përket *pikës në të cilën liria e informacionit dhe shprehjes përputhet me mbrojtjen e jetës private*³⁷. Kjo pikë po bëhet gjithnjë e më shumë pjesë e proceseve të zhvillimeve politike: domethënë

³⁶ Ibid, f. 3.

³⁷ Mansell, R., "ICTs, discourse and knowledge societies: implications for policy and practice", in Frau-Meigs, Divina and Nicey, Jérémie and Palmer, Michael and Tupper, Patricio, (Eds.) *From NWICO to WSIS: 30 years of communication geopolitics: actors and flows, structures and divides*. (ECREA series, Bristol: Intellect, 2012), f.13.

një përpjekje në sferën publike për t'u përfshirë në një diskutim të thelluar dhe analizë të ndërveprimit ndërmjet sigurisë njerëzore, privatësisë dhe medias në kuadër të teknologjive të reja të komunikimit dhe informacionit. Parimisht, sugjerohet se ndërsa funksioni mbikëqyrës i medias për të mbajtur qeverinë dhe aktorët e tjerë të fuqishëm nën mbikëqyrje është një nga standardet normative thelbësore të medias, në një shoqëri demokratike, nëse media ndërhyr në privatësi atëherë nevojitet të konsiderohet se sa dhe si kjo ndërhyrje i shërben interesave publike dhe se cilat janë mjetet e përdorura për të hetuar dhe mënyra sipas së cilës zhvillohet hetimi. Zhvillimi i kuadrit të duhur normativ dhe rregullator për median e re dhe ICT-në, lidhur me çështjet e sigurisë, privatësisë dhe lirisë, është mjaft komplekse.

Avancimet në ICT i kanë ndryshuar dukshëm mënyrat e aksesit tek të dhënat personale, përpunimi i tyre, procedimi dhe shkëmbimi. Edhe pse format e ndryshme të medias sociale, rrjeteve *online* dhe gazetarisë qytetare kanë krijuar mundësi për ekspozimin publik të informacionit personal, qytetarët janë gjithnjë e më pak të informuar mbi rreziqet që bashkohen me mbledhjen masive, depozitimin dhe shkëmbimin e të dhënave personale në kuadër të zhvillimeve të fundit të shoqërisë së informacionit që bazohet në dije³⁸. Rreziqet potenciale përfshijnë vjedhjen e identitetit, krimin kibernetik, diskriminimin, tregtimin e padëshirueshëm, mosbesimin dhe pakënaqësinë me institucionet publike dhe ato private. Në këtë kuptim, mbrojtja e të dhënave personale është një kusht për sigurinë njerëzore në shoqëritë bashkëkohore dhe është shumë e ndërlidhur me nocionet e privatësisë, lirisë dhe komunikimit. Sfida për pajtimin e çështjeve që lidhen me sigurinë, privatësinë dhe lirinë në kuadër të shoqërisë së informacionit dhe që udhëhiqet nga dija ka dy plane: së pari, ka interesa konfliktuale dhe përplasje vlerash ndërmjet aktorëve publikë dhe privatë për sa i përket mënyrave se si menaxhohet mbrojtja e të dhënave personale: të parët kërkojnë mbledhje të pakufizuar të të dhënave, grumbullim dhe shkëmbim të tyre, ndërsa të dytët përpriqen që të mbrojnë të drejtat për privatësi. Së dyti, siguri më e madhe do të thotë më pak privatësi, sepse të drejtat për privatësi dhe për të komunikuar cenohen kësisoj³⁹. Është përtej qëllimit të

³⁸ Gonçalves, M. E., & Jesus, A. I., "Security and Personal Data Protection in the European Union: Challenging Trends from a Human Rights' Perspective", *Human Security Perspectives*, Vol. 8, No. 1, (2012), f. 118-144.

këtij studimi që të përfshihet në një debat teorik rreth konfliktit ndërmjet sigurisë kundrejt lirisë i cili do të ndihmonte për të kuptuar qartë sfidat për bashkimin e tyre në princip dhe në praktikë.

E drejta për privatësi (e drejta për respektimin e jetës familjare dhe private njihet si një nga të drejtat thelbësore politike të njeriut në Deklaratën e Universale të të Drejtave të Njeriut, në Konventën Europiane për të Drejtat e Njeriut dhe në Kartën e Bashkimit Europian të të Drejtave të Njeriut. Një dimension thelbësor që lidhet me privatësinë është mbrojtja e të dhënave personale që garantohet nga Konventa e Këshillit të Europës për Mbrojtjen e Individëve lidhur me Procedimin Automatik të të Dhënave Personale. Konventa në fjalë fillimisht u hartua në përgjigje të perceptimit të rrezikut për përhapjen e ICT-së dhe ka kaluar në një rishikim të pjesshëm në vitin 2011 për të reflektuar shqetësimet në zhvillim lidhur me shoqërinë e informacionit⁴⁰. Kjo përbën një reflektim të debatit mbi konceptualizimin e ndryshëm të privatësisë dhe kufijve të tij si edhe në ndërlidhjen e tij me sigurinë publike dhe lirinë e shprehjes dhe komunikimit. Çështja e privatësisë është gjithashtu kulturore dhe varet ngushtësisht nga kontekstet politike, shoqërore dhe kulturore. Pra, në kontekstin e shoqërisë së informacionit që bazohet në dije, një sërë konceptualizimesh të sigurisë njerëzore, privatësisë dhe lirisë që janë të ndjeshëm kulturalisht dalin në pah.

Në qarqet politikëbërëse, akademike dhe publike mbrojtja e të dhënave personale dhe garantimi i të drejtës për privatësi konsiderohen në parim si një çështje ligjore kryesore në shoqërinë bashkëkohore të informacionit që udhëhiqet nga dija. Në këtë kuadër, Bashkimi Europian ka përmirësuar të drejtën për mbrojtjen e të dhënave personale duke i dhënë statusin e një të drejte themelore të njeriut në nenin 8 të Kartës Europiane të të Drejtave të Njeriut. Bashkimi Europian ka ndërmarrë një diskurs paqeje dhe pajtimi lidhur me lirinë, privatësinë dhe sigurinë, duke prezantuar sigurinë njerëzore dhe të drejtat e njeriut si ajo për privatësi dhe komunikim si plotësuese të njëra-tjetrës. Diskursi i BE-së bazohet te hipoteza se masa më të forta

³⁹ Pace, C., "Balancing Rights in the Information Society: Human Rights and the Protection of Public Security", *Human Security Perspectives*, Vol. 8, No. 1, (2012), f. 67-97.

⁴⁰ "Convention for the Protection of Individuals with regard to the Automatic Processing of Personal Data", Council of Europe, (1981, 1985, 1999) available at <http://conventions.coe.int/Treaty/en/Treaties/Html/108.htm>, accessed on 12th November 2012.

sigurie dhe një sistem informacioni i përforcuar mund të qëndrojnë mirë së bashku⁴¹. Për shembull, Komisioni European njih se ICT-të *mund të shërbejnë për mbrojtjen dhe amplifikimin e të drejtave të njeriut*⁴². Kjo bazohet në paradigmen se të drejtat dhe politikat, ose ndryshe individualja dhe e përbashkëta, në shoqëri nuk janë ekskluzive ndaj njëra-tjetrës, por mund të qëndrojnë në harmoni. Pavarësisht diskursit të paqes dhe pajtues të BE-së, masat rritëse të politikave të sigurisë dhe zgjerimi i sistemit të informacionit dhe databazave që mbledhin dhe grumbullojnë informacion dhe të dhëna personale kanë qenë shkak për shqetësimin në rritjen nga perspektiva e të drejtave të njeriut. Studiuesit argumentojnë se BE-ja po përpiket të përdorë të dhënat personale për qëllime sigurie çka ka efekte thelbësore mbi sigurinë njerëzore dhe të drejtat e njeriut si ato për privatësi dhe për komunikim⁴³. Sfida për pajtimin e sigurisë njerëzore me të drejtat e njeriut si ajo për privatësi dhe për komunikim janë një tregues i kompleksitetit të ndërveprimit ndërmjet ICT-së dhe të drejtave të njeriut dhe, pjesërisht të tilla, për të drejtat e komunikimit.

Konkluzione

Avancimet në ICT kanë ndikim të dukshëm për organizmin socio-kulturor, politik dhe ekonomik, praktikat dhe strukturat në shoqërinë bashkëkohore si edhe tek ndërveprimet njerëzore dhe marrëdhëniet e përditshme. Sikundër prodhimi dhe shpërndarja e informacionit janë transformuar në çështje thelbësore ekonomike, politike, shoqërore dhe kulturore, qeveritë, organizatat ndërkombëtare, shoqëria civile dhe aktorët e tjerë në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar kanë filluar të vendosin një kuadër normativ për funksionimin e shoqërisë së informacionit duke përfshirë zhvillimin e një sërë principesh bazë dhe vendosjen e kodeve të sjelljes për rregullimin e rreziqeve, përfitimeve dhe sfidave të reja të shoqërisë së informacionit. Shqetësimet rreth sigurisë njerëzore, privatësisë dhe të drejtave të komunikimit ndërlidhen me këto zhvillime. Shpërndarja e ICT-

⁴¹ Goold, B., & Lazarus, L., *Introduction: Security And Human Rights*, in Goold, Ben and Liora Lazarus (eds.), *Security And Human Rights*, (Oxford: Hart Publishing, 2007), f. 1-24.

⁴² *European Commission Communication*, 2010, f. 2.

⁴³ Gonçalves, M. E., & Jesus, A. I., "Security and Personal Data Protection in the European Union: Challenging Trends from a Human Rights' Perspective", *Human Security Perspectives*, Vol. 8, No. 1, (2012), f. 131.

ve dhe zhvillimet në median e re vendosin sfida dhe mundësi për konceptet tradicionale të sigurisë njerëzore, privatësisë dhe të drejtave të komunikimit. Ky studim adresoi disa prej çështjeve mbi natyrën e ndryshueshme të konceptit të sigurisë njerëzore në kuadër të daljes në pah dhe shpërndarjes së ICT-së duke u përqendruar veçanërisht te privatësia dhe e drejta për komunikim. U argumentua se e drejta për komunikim mund të perceptohet si një kuadër konceptual për adresimin e disa prej shqetësimeve në zhvillim në shoqërinë aktuale si siguria njerëzore dhe privatësia.

ABSTRACTS

From “Balkanization” to “Europeanization” of the Western Balkan countries

Tamara Radovanovic, MsC

From '90s onwards the region had undergone through a number of important transformative processes, moving from a Balkanization paradigm towards an Europeanization one. The paper focuses on the major processes and trying to analytically distinguishing among them. Although it acknowledge that the transformations have been sometimes running in parallel and that there is no clear-cut of when a process ends and when the other starts, i will propose - for analytical reasons - three main distinguishable stages to look at the Western Balkans; that of nation - and state-building (the “last Balkanization”), the (delay) transition and the (pre-) Europeanization process, conceptualizing so the many and complex transformations in the region as “multiple stages”. What it is argued here is that “the Western Balkans can be Europeanized”. The problems with the Europeanization of the Western Balkans do not rest only on the formal compliance to the EU requirements. Their greatest challenge will be to abandon practices of the past, so become “behaviorally Europeanized”. The success of the Balkans is tied to the integration of all states from the region into the EU and NATO structures. The disintegration in the past must be substituted with the integration into Europe based on values and interests in common.

The Balkans as a European question

Jacques Rupnik

Today, a decade after the end of the wars of Yugoslavia's dissolution, the “Balkan question” remains more than ever a “European question”. Bosnia was in the eyes of many Europeans in

the 1990s, the symbol of a collective failure, while Kosovo later became a catalyst for an emerging Common Foreign and Security Policy. In the last decade, with the completion of the process of redrawing the map of the region, the overall thrust of the EU's Balkans policy has moved from an agenda dominated by security issues related to the war and its legacies to an agenda focused on the perspective of the Western Balkan states' accession to the European Union, to which there has been a formal political commitment on the part of all EU member states since the Thessaloniki Summit in June 2003. The framework was set, the political elites in the region were – at least verbally - making Europe a priority and everyone was supposedly familiar with the policy tools thanks to the previous wave of eastwards enlargement. With the region's most contentious issues apparently having been defused, the EU could move from stability through containment towards European integration. What then is the difference between Central Europe and the Balkans? The answer is ten or fifteen years, the lost decade of the

Balkans wars of the 1990s. Before endorsing such a reassuring presentation about the Western Balkans, the paper examines the favourable regional developments and international trends, but also the contentious issues and obstacles to the process. Some have to do with the uneven pace of reform and democratic change in the region, others with doubts about the existence of sufficient political will and momentum within the EU to support a renewed and sustained enlargement process.

The Role of Euro-Atlantic Integration on Future Relations between Macedonia and Kosovo

Agon Demjaha, PhD

The main purpose of this paper is to explore the role of Euro-Atlantic Integration on future relations between Macedonia and Kosovo. In this context, the paper also analyses the role of other relevant factors, i.e. ethnic, economic and policy of equidistance, on future relations between these two neighbouring countries. Macedonia and Kosovo have in general shared relatively similar fate throughout the history. As a result, one would believe that the relations between Macedonia and Kosovo would be one of collaboration in achieving the same ultimate goal of liberation and independence. However, except few sporadic episodes of collaboration, in the recent history relations between the two have been mainly strained.

Until recently, the relations between the two countries were dominated by fears of the past rather than by the prospects of the future. It was the introduction of Euro-Atlantic perspective that paved the way for increased tolerance and cooperation. By

promoting the unreserved respect of all communities and commitment to traditional European values, the Euro-Atlantic integration has helped in transforming the relations between these two countries from relatively hostile into one of mutual cooperation.

Today, in principle there are no open questions between the two countries and this represents a significant starting point for developing prosperous overall bilateral relations. However, despite plentiful opportunities for such collaboration, these relations have not reached the desired level, yet. The paper explores perspectives of future relations between the two countries by taking into account the role of different relevant factors as well as different synergies that might be created among them. The paper shows that the role of Euro-Atlantic integrations on future relations between Macedonia and Kosovo will greatly depend on the progress that the two countries will make towards NATO and EU.

Mutual legal assistance, European arrest warrant Elvana Çiçolli

Albania has always put a lot of efforts into the acknowledgement and implementation of international conventions, instruments and other important international acts in the field of judicial cooperation and mutual legal assistance in penal matters. For this purpose, many cooperation mechanisms have been established between Albania and other countries.

The Albanian legislation has been thoroughly amended and harmonized with contemporary standards, in terms of fighting organized crime, terrorism and terrorism financing, sequestration and confiscation of assets deriving from criminal acts, infiltration of police officers, structures and other specialized procedural mechanisms.

The approximation and harmonization process of the Albanian legislation is the first step towards establishing of sustainable mechanisms for the implementation of the mutual legal assistance. One of the forms of cooperation in this regard is the European arrest warrant, which may be considered as the one crossing the boundaries of the European space.

EU Promoting Security and Peace in the Backyard: The Case of Western Balkan Gentjan Skara

The need to secure stability and to spread peace in the neighborhood countries has been a core motivation of the EU

after the fall of the Berlin wall in the Western Balkan. The promised membership based on conditionality has been to some extent successful but regarding the security still this region suffered by “weak states” and “protectorate” states which may destabilize it.

The proliferation of the civilian and military operations reshaped the foreign policy of the EU being challenged by the dissolution of the Yugoslavia. In this context, the failure of EU to bring to the end to the Bosnian war and the hesitation to stop the Kosovo conflict in 1999 showed the incapacity of the EU to act as an international player. Therefore, EU introduced military and civilian operation to deal with the post conflict countries as key priorities of the EU, by presenting an essential aspect of the EU’s external action. Also, the EU action on international scene are guided by the principles of democracy, rule of law, human rights as a complementary and necessary action to achieve security and peace in and beyond the borders.

This paper attempt to analyze how successful have been military and civilian operation to secure stability and establish rule of law in the post conflict country with specific reference to Western Balkan. Author hypothesis is that through deployment of these operations in the Western Balkan countries, EU promotes to maintain security and to establish rule of law in order to help these countries to realize their journey toward European future.

The New Perspective for the Western Balkans within the Danube Region Strategy

Tatjana Slijepèeviæ

Regional cooperation lies at the very foundation of the whole structure of the European Union and is a model that has proved itself exceptionally successful, particularly in such a diversified milieu as Europe is. In the case of the Western Balkans, regional cooperation stands as an indispensable prerequisite for the future of the region as a whole; as well as for each individual state, foremostly when it comes to their European perspective.

However, regional cooperation primarily implies cooperation among the Western Balkans countries, which might not be enough as the countries face the same challenges, lack experience and resources for resolving problematic issues and not infrequently cannot be of much help to one other. Closer cooperation, partnership and contacts with more advanced, experienced EU member states would provide the Western Balkan countries with opportunities for direct learning, adopting best practices and

translating them to the Western Balkan context which would ultimately enhance resolution of the present issues and challenges in the region. The Danube Region Strategy opens precisely these opportunities to the Western Balkans as it affects not just the member states, but the neighbouring countries as well.

Along with being a unique way for direct and close cooperation among member and non-member states, it creates space for active involvement and contribution of the Western Balkans to the common interest areas foreseen by the Danube Strategy. If fully embraced and used at its best by the Western Balkan countries this opportunity will, undoubtedly, result in many positive developments and pave the way to new ones.

Human security, the right to communicate and privacy in the context of the information and knowledge driven society

Blerjana Bino, PhD Candidate

The emergence, advancements and the rapid proliferation of information and communication technologies (ICTs) have significantly transformed almost all dimensions of our contemporary society leading to the development of information and knowledge-driven society. It is argued that science, innovation and ICTs could positively impact human development and social progress. Despite the positive transformations and developments in lieu of the information and knowledge-driven society, the progress in science, technology and innovation poses compelling challenges to the protection of human rights and fundamental freedoms vis a vis human security concerns. This paper is interested in the challenges that arise when trying to reconcile the countervailing aspects of security, privacy and freedom in lieu of the information and knowledge-driven society. The protection of human rights such as the right to privacy and the right to communicate in lieu of the information and knowledge-driven society seems to be diminished by human security concerns and in the name of public security. This paper seeks to address some of the questions over the changing nature of the concept of human security in lieu of the emergence and proliferation of ICTs, with a particular focus on the issues of privacy and right to communicate. The paper argues that the right to communicate can be conceived as a conceptual framework within which to address some of the emerging concerns in contemporary society such as human security and privacy.

INSTITUTI PËR DEMOKRACI DHE NDËRMJETËSIM
ÇËSHITJE EUROPIANE DHE TË SIGURISË - 23

Formati: 15.5x24 cm
Shtypur në Shtypshkronjën TOENA
Tel: + 355 4 22 40 116
Tiranë, 2012